



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORATI**

**RAPORT VJETOR I VEPRIMTARISË NË UNIVERSITETIN
E ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022**

A. SENATI AKADEMIK

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (UE), veprimtarinë e vet për vitin akademik 2021-2022, e trajton sipas udhëzimit nr. 5, datë 19.2.2018 të MASR (MAS) “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”.

Për vitin akademik 2021-2022, raportimi vjetor bazohet kryesisht në realizimin e misionit dhe detyrave të përcaktuara, arritjeve, vështirësive si dhe të objektivave e synimeve që ka për të ardhmen institucioni lidhur me veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare

Raportimi vjetor bazohet në analizat dhe vlerësimet për veprimtarinë e kryer nga organet drejtuese si Senati Akademik, Bordi i Administrimit si dhe nga të gjitha njësitë përbërëse pranë Rektoratit, analizat dhe vlerësimet për veprimtarinë e kryer prej njërive bazë dhe njërive kryesore të pesë fakulteteve si dhe raportin financiar të UE-së.

Veprimtaria e UE-së, është rezultat i bashkëpunimit të njërive dhe strukturave drejtuese me personelin akademik dhe ndihmësakademik si dhe përshtatjes me drejtimit e përgjithshme të zhvillimit rajonal e më gjerë, zbatimit të politikave mbi arsimin e lartë sipas legjislacionit në fuqi, me vendimet e Qeverisë, udhëzimet dhe urdhrat nga MAS etj.

Nga analizat e kryera rezulton se në vijimësi drejtimit kryesore të punës në UE, janë:

- Programet e studimit të përshtaten me kërkesat e tregut;
- Pranimet e reja të jenë sa më cilësore dhe me kuota sa më reale;
- Veprimtaria e personelit të UE-së të kryhet sipas nevojave dhe udhëzimeve përkatëse;
- Realizimi në vijimësi i gjurmimit të studentëve që kanë përfunduar studimet;
- Rishikim i tarifave të shkollimit;
- Përmirësim i shërbimeve që UE ofron për studentët dhe të diplomuarit;
- Përmirësimi dhe paraqitja e detajuar e gjendjes financiare të institucionit.

Nga organet drejtuese të UE-së, realizohet raportimi nëpërmjet një materiali të përgatitur dhe të strukturuar sipas fushës së tyre të kompetencës, ku trajtohen çështjet dhe problematikat në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.2.2018 të MASR (MAS) “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, si vijon:

a) Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të UE-së.

Veprimtaria mësimore e kërkimore të UE-së, është realizuar duke patur për bazë raportet për veprimtarinë e njërive bazë dhe ato kryesore, sipas analizave, kontroleve, vlerësimit dhe zbatimit të legjislacionit, lidhur me realizimin e procesit mësimor e kërkimor.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka disa struktura pranë Rektoratit (drejtoritë) si dhe 5 (pesë) njësi kryesore (fakultete) dhe 25 (njëzet e pesë) njësi bazë (departamente dhe qendra kërkimore):

1. Fakulteti i Shkencave të Edukimit, me 5 (pesë) njësi bazë;
2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, me 5 (pesë) njësi bazë;
3. Fakulteti i Shkencave Humane, me 5 (pesë) njësi bazë;
4. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, me 4 (katër) njësi bazë;
5. Fakulteti Ekonomik, me 6 (gjashtë) njësi bazë.



Njësitë kryesore dhe njësitë bazë, kanë përcaktuar dhe realizuar objektivat e tyre, duke e orientuar punën mësimore e shkencore në disa drejtime gjatë vitit 2021-2022, si vijon:

- Në vijimësi në përputhje me standardet akademike dhe gjithë dokumentacionit universitar, është synuar ristrukturimi, përmirësimi dhe hapja e programeve të studimit.
- Për procesin mësimor është synuar rritja cilësore, duke e shoqëruar me përditësimin dhe pasurimin e përmbajtjes së ligjëratave dhe seancave praktike me të reja bashkëkohore; si dhe zbatimin e modeleve dhe teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies.
- Për të realizuar praktikat mësimore dhe profesionale të studentëve në mënyrë sa më cilësore.
- Të sigurohet mbarëvajtja e procesit mësimor dhe shkencor nëpërmjet përgatitjes dhe ruajtjes së dokumentacionit të domosdoshëm.
- Të sigurohet rritja në vijimësi e cilësisë së shërbimit të ofruar nga personeli.
- Ditët e informimit me maturanët të organizohen dhe realizohen sa më të detajuara në lidhje me programet e studimit të ofruara nga institucioni ynë.
- Personeli i UE-së të nxitet dhe mbështetet për kualifikim dhe pjesëmarrje në veprimtari shkencore, në procese kërkimi dhe botimi brenda dhe jashtë vendit.

Universitetin e Elbasanit, në nivele gjithëpërfshirëse për zhvillimin e rajonit dhe më gjerë, e ka vendosur veprimtaria mësimore dhe ajo kërkimore-shkencore e personelit akademik dhe kualifikimi i tij.

Studimet e ndryshme të konkretizuara përmes artikujve, kumtesave, referateve, botimeve etj., kanë ndikuar në drejtim të përmirësimit cilësor të mësimdhënies.

Veprimtaria mësimore e universitetit në tërësi është karakterizuar nga përpjekje intensive e të vazhdueshme të personelit akademik, duke synuar që studentët të zhvillojnë ato shprehje e kompetenca që ju duhen për të ardhmen, duke instaluar metoda e forma bashkëkohore për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve.

Treguesit pasqyrohen jo vetëm në raportet e analizave të realizuara në nivel njësie bazë dhe kryesore, por edhe nga monitorimet e strukturave drejtuese të universitetit.

Në departamentet dhe fakultetet e universitetit, veprimtaritë kryesore të realizuara për procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.2.2018 të MASR (MAS) *“Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”*, janë si vijon:

- Realizimi i veprimtarisë mësimore sipas detyrave dhe udhëzimeve përkatëse.
- Në vijimësi sipas afateve të përcaktuara, janë rishikuar dhe përmirësuar planet, programet lëndore, struktura e vitit akademik, oraret mësimore për leksionet, labororet etj.
- Janë përgatitur kurrikula në vijimësi për hapjen e programeve të reja të studimit, konkretisht në të tre ciklet e studimeve dhe programe me karakter profesional dyvjeçar.
- Për programet e ciklit të dytë “Master Profesional” (kryesisht drejtimi mësuesi), vijon riorganizimi në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, udhëzimeve dhe vendimeve përkatëse.
- Në vijimësi janë realizuar dhe përmirësuar leksione, cikël leksionesh, botime të teksteve mësimore dhe laboratorike etj.
- Në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet e MAS, statutin dhe rregulloret e universitetit, fakulteteve dhe programeve të studimit etj., është pasqyruar dokumentacioni përkatës dhe në vijim është kryer përmirësimi i rregullores së studimeve, zhvillimit të provimeve dhe formave të tjera të kontrollit, përmirësim në vijimësi i procedurave për udhëheqje të tezave të diplomës në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, rishikimi i procedurave për praktikat profesionale dhe mësimore etj.



- Për rekrutimin i personelit akademik të nevojshëm, respektohen procedurat ligjore dhe transparente, sipas statutit të universitetit dhe modaliteteve të miratuara nga Senati. Sipas nevojave të departamenteve, për të zhvilluar kryesisht orët e seminareve apo ndjekje të praktikave profesionale të studentëve, aktivizohet personel akademik me kohë të pjesshme.

Nga Rektorati, fakultetet dhe departamentet janë organizuar kontrole të vazhdueshme lidhur me dokumentacionin e secilit nga personeli akademik, sidomos për programet përkatëse të disiplinave mësimore, për një ecuri sa më normale të procesit mësimor. Gjithashtu në departamente, në zbatim të rregullores dhe udhëzimeve, janë zhvilluar mbledhje për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor dhe punës shkencore si dhe për të siguruar një disiplinë të lartë në punë nga ana e të gjithë personelit akademik.

Nga ana e personelit akademik në përgjithësi ka pasur angazhim serioz në procesin e mësimdhënies, por në disa raste të veçanta janë vërejtur edhe probleme, prandaj është tërhequr vëmendja në funksion të përmirësimit të situatës.

Për mbarëvajtjen e procesit mësimor, vlerësohet kapaciteti intelektual e profesional i personelit akademik, përgatitja për orën e mësimin, niveli i përgatitjes së studentëve dhe përgatitja e tyre sistematike dhe e vazhdueshme, nga baza materiale e didaktike, kushtet e mjedisit mësimor etj. Me personelin akademik dhe studentët, kontrollet, vëzhgimet, kontrolli i dokumentacionit etj., në vijimësi kanë mundur ecurinë normale të këtij procesi, si në aspektin sasior (realizimin e orëve të programit) ashtu edhe në aspektin cilësor.

Para përfundimit të çdo semestri në vijimësi është bërë ballafaqimi i planeve kalendare me orët e realizuara nga personeli akademik, si dhe janë hartuar planet për plotësimin e orëve të porealizuara për arsye të ndryshme (raportet mjekësore, festa zyrtare etj).

Në zhvillimin e procesit mësimor janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve dhe praktikave laboratorike, për pajisjen e studentëve me shprehitë e përgjithshme dhe të transferueshme, duke synuar:

- Përcaktimin e objektivave për procesin e mësimdhënies e mësimnxënies.
- Ngritjen e rolit të studentit duke e shndërruar atë nga një subjekt pasiv në aktiv, kërkues dhe pjesëmarrës, pra të realizohet një mësimdhënie ndërvepruese.
- Angazhimin dhe përfshirjen e studentëve në veprimtari kërkimore dhe krijuese.
- Për kontrollin e dijeve të aplikohen metoda më rezultative.

Në vijimësi janë bërë përpjekje për plotësimin e kërkesave të departamenteve për bazë materiale si nga ana sasimore ashtu edhe cilësore.

Një rol të rëndësishëm në drejtim të rritjes së cilësisë të procesit mësimor dhe rritjes së nivelit mësimor e shkencor në të gjitha programet e studimit të universitetit, kanë luajtur investimet duke plotësuar të gjitha kërkesat.

Një aspekt i rëndësishëm i procesit mësimor në të gjitha programet e studimit në universitetin tonë, është zhvillimi i praktikave profesionale dhe praktikave në terren. Për vitin akademik 2021-2022 nga departamentet dhe strukturat përkatëse janë marrë të gjitha masat, pra është krijuar infrastruktura e duhur për realizimin e këtij procesi të rëndësishëm të mësimdhënies. Janë hartuar programet e praktikave, janë nënshkruar aktmarrëveshjet me subjektet e ndryshme private apo shtetërore.

(për më shumë shih: *i -Vlerësime të IAL-së dhe rekomandime të mundshme për ministrinë, si dhe një përshkrim të ndërveprimit të IAL-së me strukturat e varësisë të ministrisë; pika 8. Shpenzimet për praktikat mësimore në terren me studentët*).



Procesi i provimeve në UE, si pjesë e veprimtarisë mësimore, është vlerësuar dhe përmirësuar, por ka ende vend dhe mundësi për përmirësime të mëtejshme sasiore dhe cilësore. Në të gjitha sezonet e provimeve të vitit 2021-2022, ky proces përgjithësisht është zhvilluar normalisht me përgjegjësi dhe korrektësi, duke bërë kujdesin e duhur për disa momente kryesore të këtij procesi:

1. Për zhvillimin e provimeve; është hartuar në kohë kalendari i provimeve, ku janë përcaktuar datat, ora, mjedisi i zhvillimit të provimit; janë ngritur komisionet për çdo provim; është kontrolluar plotësimi i dokumentacionit; është ndjekur procesi i sekretimit; afati i vlerësimit të provimeve me shkrim; dhënia dhe pasqyrimi i rezultateve etj.
2. Janë njohur në vijimësi studentët dhe personeli akademik me përmbajtjen e neneve të Rregullores së Universitetit, Fakultetit dhe programeve të studimit, me kërkesat e udhëzimeve për plotësimin e dokumentacionit etj.
3. Nga departamentet një kujdes i veçantë është treguar për hartimin e tezave të provimeve me shkrim e me gojë, që bëjnë të mundur një kontroll dhe vlerësim sa më objektiv dhe cilësor.

Ka patur raste të mbingarkesës për sezonin e vjeshtës duke zhvilluar përditë provime, kjo si pasojë e mosfrekuentimit të studentëve në seminare, ushtrime e laboratore, një pjesë e tyre nuk janë futur në sezonin e radhës, duke u dhënë mundësinë e shlyerjes së detyrimeve në vjeshtë.

Janë mbikëqyrur dhe minimizuar disa momente të procesit të provimeve, siç është fillimi ende me vonesë në ndonjë rast i provimeve dhe jo në orarin e përcaktuar, sidomos nga personel akademik me kohë të pjesshme dhe në ndonjë rast edhe nga personel akademik me kohë të plotë, apo si pasojë e mbingarkesës së anëtarëve të komisionit që marrin pjesë në shumë komisione, duke e bërë këtë pjesëmarrje ndonjëherë formale.

Rezultatet e vlerësimeve janë pasqyruar në procesverbalet e provimit nëpërmjet sistemit EMS.

Veprimtaria e CleanScore në mbështetje të veprimtarisë së UE-së.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 janë zhvilluar takime informuese për projektin CleanScore në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, lidhur me :

- Korrigjimin e automatizuar të provimeve.
- Përkthimin e teksteve akademike ndërkombëtare në fushën e ekonomisë dhe edukimit.

Projekti CleanScore gjithashtu mundësoi aksesimin e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” në një nga libraritë digjitale më prestigjioze në botë JSTOR. Tani i gjithë personeli akademik dhe të gjithë studentët kanë mundësinë e aksesimit në librarinë digjitale nga mjediset e Universitetit të Elbasanit, por edhe me anë të aksesimit në platformën e universitetit EMS.

Gjatë periudhës janar-qershor 2022 është vërejtur aksesimi në librarinë dixhitale JSTOR si më poshtë:

Libraria dixhitale JSTOR - UNIEL	Muajt						Totali
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	
Search platforms	185	216	142	309	358	409	1619
Total Item Requests	84	122	163	206	274	284	1133
Unique Item Requests	63	92	142	164	198	211	870
Unique Title Requests	2	1	10	7	5	9	34

Gjatë vitit akademik 2021-2022 u zhvilluan disa provime me anë të komponentit të korrigjimit të automatizuar, ku pedagogët që zhvilluan provimet shprehën vlerësimet maksimale mbi implementimin e projektit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Në Fakultetin Ekonomik në total janë zhvilluar 74 provime në auditor, në provime të ndërmjetme dhe



përfundimtare me anë të korigjimit të automatizuar të provimeve dhe 1 provim në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, ku kanë marrë pjesë gjithsej 1192 studentë.

Në Fakultetin Ekonomik aktualisht përdoren të gjithë tekstet e përkthyer nga AADF, si tekste bazë dhe tekste plotësuese.

Më konkretisht:

- *Biznesi ndërkombëtar*, përdoret nga një pedagog si tekst bazë.
- *Kontabiliteti financiar*, përdoret nga tre pedagogë si tekst bazë.
- *Sipërmarrja*, përdoret nga një pedagog si tekst bazë.
- *Bazat e menaxhimit*, përdoret nga dy pedagogë si tekst bazë.
- *Financat personale*, përdoret nga një pedagog si tekst bazë.

Veprimtaria mësimore si përfundim mund të thuhet se gjatë vitit akademik 2021-2022 është realizuar në nivelin e duhur dhe me një punë serioze, duke angazhuar të gjithë personelin akademik të departamenteve, për përmirësimin dhe ristrukturimin e planeve dhe programeve mësimore dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të gjitha programet e studimit.

Për organizimin dhe realizimin e procesit mësimor, numri i studentëve të regjistruar sipas programeve të ndryshme të studimit, padyshim ka ndikimin e vet.

Për vitin akademik 2021-2022 është krijuar tabloja e studentëve, që ndjekin studimet në vitet e para, në të gjitha programet e studimit me kohë të plotë dhe informacionet përkatëse janë në tabelat e mëposhtme për çdo fakultet (sipas pikës j të udhëzimit nr. 5 dt. 19.02.2018).

Në universitetin tonë numri i përgjithshëm i studentëve për vitin akademik 2021-2022 është **8746** nga të cilët studentë të rinj që vijuan studimet në vitet e para për vitin akademik 2021-2022, në të gjitha programet dhe format e studimit, është **4235** studentë si më poshtë:

- Regjistrime të reja në programe studimi me karakter profesional dhe bachelor, 2102 studentë.
- Regjistrime të reja në programe studimi master profesional, 1079 studentë.
- Regjistrime të reja në programe studimi master i shkencave, 982 studentë.
- Regjistrime të reja në program studimi i integruar, 72 studentë.

Edhe për këtë vit akademik nisur nga vlerësimi i shifrave mbi regjistrimet në vitet e para për programet e studimit me kohë të plotë, vihen re dukuritë e mëposhtme:

Së pari, vijon të jetë në rënie numri i studentëve krahasuar me regjistrimin e studentëve të ciklit të parë në raport me vitin paraardhës, sidomos në programet e studimit me orientim mësuesi.

Ndërkohë, disa programe studimi në këtë vit akademik kanë qenë të pezulluara:

1. Bachelor në gjuhë shqipe dhe rome.
2. Bachelor gjuhë shqipe dhe frënge.
3. Bachelor histori dhe gjuhë gjermane.
4. Bachelor gjeografi dhe gjuhë italiane.
5. Bachelor gjuhë frënge.
6. Bachelor gjuhë italiane.
7. Bachelor në fizikë kompjuterike.
8. Bachelor në matematikë informatikë.
9. Bachelor në edukim qytetar.
10. Bachelor në filozofi sociologji.
11. Master profesional në gazetari sportive.
12. Master profesional gazetar reporter.
13. Master profesional në redaktim.



14. Master profesional në analist prodhimi.
15. Master profesional në analizë të dhënash.
16. Master profesional në mësuesi në arsimin e mesëm të ulët për edukatë qytetare gjeografi me profil minor në histori.
17. Master profesional në mësuesi në arsimin e mesëm të ulët për edukatë qytetare histori me profil minor në gjeografi.
18. Master profesional në mësuesi në arsimin e mesëm të ulët për gjuhë të huaj gjermanisht me profil minor në gjuhë shqipe.
19. Master profesional në mësuesi në arsimin e mesëm të ulët për gjuhë të huaj italisht me profil minor në gjuhë shqipe.
20. Master profesional në mësuesi në arsimin e mesëm të ulët për gjuhë të huaj frëngjisht me profil minor në gjuhë shqipe.
21. Master i shkencave në studime letrare.
22. Master i shkencave në studime gjeografike.
23. Master i shkencave në trashëgimi kulturore.

Së dyti, për cilësinë është tregues nota mesatare e shkollës së mesme e studentëve të regjistruar në vitet e para në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë. Për vitin akademik 2020-2021 vihet re në tërësi një përmirësim i rritjes së cilësisë të studentëve të regjistruar në ciklin e parë të studimeve, e ndikuar kjo edhe nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave, i cili përcakton vendosjen e notës mesatare mbi 6,5 dhe 7,5 të pranimit të maturantëve në universitet.

Së treti, për Universitetin e Elbasanit është ruajtur hapësira gjeografike e rajoneve nga vijnë studentët, ku mund të përmendim Elbasanin, Librazhdin, Gramshin, Peqinin, Lushnjën, Kavajën, Pogradecin, Tiranën, Fierin, Kukësin, Peshkopinë etj.

Në drejtim të pranimit të studentëve të rinj, Universiteti i Elbasanit ka kapacitete edhe më të mëdha, por për të realizuar këtë objektiv, mendojmë se mosrealizimi kushtëzohet nga faktet e mëposhtme:

- Planifikimi i kuotave shumë të larta në programet e studimit në institucionet publike të Tiranës, e lidhur kjo me prirjen, gjithmonë në rritje, që kanë shumica e maturantëve të rajonit tonë për të studiuar në universitetet e kryeqytetit apo edhe jashtë shtetit, pavarësisht se cilin program studimi do të ndjekin.
- Duhet të punohet më shumë në të ardhmen me maturantët, të qartësohen kriteret e pranimit dhe nota mesatare për programet e studimit dhe veçanërisht në programet e mësuesisë etj.

b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë UE, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.

Në mënyrë të përmblëdhur, gjatë vitit akademik 2021-2022, në UE veprimtaritë janë:

- 11 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare,
- 7 takime dhe tryeza të rumbullakta ose tryeza diskutimi,
- 5 trajnime,
- 9 vizita institucionale, delegacione dhe nënshkrimi i marrëveshjeve,
- 3 ekspozita dhe promovime,
- 3 aktivitete Erasmus+,
- 9 aktivitete të Bordit Këshillimor të Biznesit,
- 15 aktivitete të tjera.



Në mënyrë të detajur, aktivitetet dhe organizimi i tyre, gjendet në vijim.

• **Konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare:**

1. 5.11.2021. Në kuadër të “Ditës ndërkombëtare të gjuhës rome”, është organizuar konferenca dedikuar vështirësive dhe sfidave të ruajtjes së gjuhës rome, ku ka kontribut edhe Universiteti i Elbasanit, si i pari dhe i vetmi universitet në Shqipëri që ofron program studimi bachelor në "Gjuhë shqipe dhe rome".
2. 13.11.2021. Në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvillua Konferenca ndërkombëtare “Përparimet në biznes, financë dhe drejtësi”. Në konferencë u trajtuan një gamë e gjerë disiplinash duke përfshirë ekonominë, biznesin, financat, drejtësinë, turizmin, inxhinierinë.
3. 3.12.2021. Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Albanologjike, organizoi simpoziumin shkencor “Aleksandër Xhuvani në leksikologjinë shqiptare”.
4. 5.12.2021. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në bashkëpunim me Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan, Universiteti i L’Aquila-s, Department of Life, Health and Environmental Sciences dhe Universiteti i Barit, Itali, organizon Konferencën e II-të ndërkombëtare në logopedi dhe fizioterapi.
5. 17.12.2021. Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi Konferencën Shkencore "Qendrat e banuara të Shqipërisë, gjendja dhe e ardhmja", me një pjesëmarrje të theksuar të personaliteteve, studiuesve, pedagogëve dhe studentëve.
6. 28.04.2022. Universiteti i Elbasanit, organizon Konferencën e parë ndërkombëtare studentore “Shkenca e hapur dhe ndërkombëtarizimi”. Kjo konferencë synon të nxisë studentët të shkëmbejnë idetë dhe kërkimet e tyre, për të diskutuar çështje aktuale si dhe për të nxitur bashkëpunimin mes studentëve.
7. 12.05.2022. Organizohet Konferenca shkencore ndërkombëtare me temë “Kujtesa kolektive në letërsi dhe media”, me këndvështrime të reja mbi dilemat tradicionale që lidhen me kujtesa kolektive, veçanërisht në fushën e letërsisë dhe medias.
8. 19.05.2022. Organizohet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, KNIS 2022-Konferenca e VI-të ndërkombëtare infermierore në specialitete”, për të paraqitur dhe diskutuar risitë dhe shqetësimet më të fundit, sfidat praktike të hasura dhe zgjidhjet e mundshme.
9. 14/15.06.2022. Universiteti i Elbasanit organizon për herë të parë forumin me temë "Toleranca përtej kulturës". Ky forum, vjen si rezultat i bashkëpunimit midis Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Fondacionit Ndërkombëtar për Tolerancën dhe Research Dialogue Cooperation.
10. 24.06.2022. Zhvillohet Konferenca e 2-të ndërkombëtare me temë "Globalizimi dhe integrimi në edukimin bashkëkohor". Kjo konferencë e organizuar nga Fakulteti i Shkencave të Edukimit është kthyer në një traditë, ku mbledhen studiues nga fusha e arsimit, akademikë, drejtues dhe mësues të sistemit arsimor parauniversitar, specialistë dhe studentë.
11. 12.09.2022. Zhvillohet në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Konferenca shkencore kombëtare "Tradita arsimore e Elbasanit nga mesi i shek.XIX deri në vitet '30 të shek XX". Kjo konferencë, synon evidentimin, zbulimin dhe vlerësimin e traditës arsimore të qytetit të Elbasanit dhe më gjerë.



- **Takime, tryeza të rrumbullakta, tryeza diskutimi:**
 1. 1.11.2021. Në kuadër të luftës kundër COVID-19, organizohet në Universitetin e Elbasanit aktiviteti “Vaksinimi, sfida për të shpëtuar jetë”, një takim informues mbi sfidat, përpjekjet për të kapërcyer dhe rëndësinë e vaksinimit për t’ju rikthyer jetës normale.
 2. 22.11.2021. Universiteti i Elbasanit organizoi workshopin “Kërkimi shkencor mes ndërkombëtarizimit dhe sfidave”,
 3. 21.02.2022. Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit është zhvilluar aktiviteti “Forcimi i edukimit për qytetari demokratike”, organizuar nga Këshilli Evropian. Në fokus të këtij takimi ishte angazhimi për rritjen e projekteve dhe aktiviteteve për rritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe përgatitjen e mësuesve të ardhshëm.
 4. 28.02.2022. Në kuadër të 12 vjetorit të miratimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, Avokaten e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Autoritetin e Mediave Vizive, zhvilluan aktivitetin me temë "Aleanca kundër gjuhës së urrejtjes një diskutim gjithëpërfshirës".
 5. 10.03.2022. Zhvillohet në Universitetin e Elbasanit, tryeza e shtatë e rrumbullakët e çështjeve të barazisë gjinore me temë "Zëri i grave dhe vajzave", ku u trajtua mbrojtja e grave dhe vajzave, fuqizimi i zërit të tyre në shoqëri, garantimi i pjesëmarrjes së barabartë në vendimarrje.
 6. 16.02.2022. Mbahet në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, seanca dëgjimore dhe konsultimi, nga Komisioni Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.
 7. 14.04.2022. Në Universitetin e Elbasanit u organizua sesioni informues mbi Sondazhin Kombëtar të Studentëve 2022 nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Ky proces ka si qëllim kryesor vlerësimin dhe matjen e cilësisë në arsimin e lartë.
- **Trajnime:**
 1. 4.11.2021. Zhvillohet për studentët e programit të studimit të gazetarisë trajnimi “Si të luftojmë dezinformimin”, mundësuar nga Fakteje.al. Studentët u njohën me konceptin e dezinformimit dhe metodologjinë e Fact Checking.
 2. 17.12.2021. Studentë të programit të gazetarisë në Universitetin e Elbasanit, marrin pjesë në Akademinë e Medias, organizuar nga Instituti Yunus Emre në Tiranë. Studentët në përfundim të trajnimeve teorike dhe praktike mbi përdorimin e aplikacioneve e mediave sociale, fazat e prodhimit të lajmit etj., u pajisën me certifikatat përkatëse.
 3. 23.02.2022. Organizohet në Fakultetin Ekonomik programi “Klubi i Debatit”. Ky program realizohet në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes Universitetit të Elbasanit dhe Junior Achievement Albania, i financuar nga Fondi Amerikan i Zhvillimit.
 4. 31.05.2022. Në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" organizohet seminari informues në lidhje me praktikën e përpunimit dhe dorëzimit të dokumentave në DPA, për punonjësit e sekretari-arkivave.
 5. 06.06.2022. Në kuadër të projektit “3E-English-Entrepreneurship–Employability”, mundësuar nga mbështetja e Ambasadës Amerikane, JAA (Junior Achievement Albania), zhvillohet në Universitetin e Elbasanit tryeza me temë “Integrimi i studentëve në tregun e punës”.
- **Vizita institucionale, delegacione dhe nënshkrimi i marrëveshjeve:**
 1. 9.02.2022. Universiteti i Elbasanit u vizitua nga Ambasadori i Arabisë Saudite Faisal Ghazi Ismail Hifzi.



2. 14.02.2022. Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit midis Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe SWISSCONTACT. Qëllimi i këtij memorandumi, është të krijojë një marrëdhënie reciproke të dobishme, të ndërtuar mbi bashkëpunimin akademik, shkencor dhe kulturor, si dhe të përcaktojë fushat për kërkimin shkencor e akademik, në të cilin palët dëshirojnë të punojnë së bashku në të ardhmen.
 3. 25.03.2022. Universiteti i Elbasanit, finalizon me sukses nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Institutin Konfuci, në prani të Ambasadorit të Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri, Zhou Ding.
 4. 13.04.2022. Universiteti i Elbasanit, nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi me Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, që ka për qëllim vendosjen e themeleve të bashkëpunimit reciprok në interes të dy institucioneve.
 5. 20.04.2022. Universiteti i Elbasanit nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Trakia në Stara Zagora, Bullgari. Marrëveshja ka në qendër të saj mobilitetin e personeleve akademike, studentëve si dhe bashkëorganizmin e aktiviteteve dhe sipërmarrjeve kërkimore shkencore me interes të përbashkët.
 6. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Marrëveshja ka për qëllim realizimin e projekteve të përbashkëta, hulumtimeve, ngritjen e kapaciteteve të ekipeve profesionale të palëve, si edhe për mbështetje të ndërsjellë gjatë realizimit të aktiviteteve të përbashkëta.
 7. Universiteti i Elbasanit nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me AADF në Programin Research Expertise from the Academic Diaspora READ. Synimi i AADF është sjellja e 100 studiuesve nga Diaspora Shqiptare për të punuar me institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, në projekte kërkimore bashkëpunuese, doktoratë, supervizim, zhvillim i kurrikulës dhe mësimdhënie.
 8. 30.05.2022. Rektori i universitetit Prof.dr. Skender Topi, zhvilloi një takim zyrtar të frytshëm me Rektoren e Universitetit të Firenzës, Prof. Alessandra Petrucci për zgjerimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve.
 9. 21.06.2022. Rektori i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani, Prof.dr. Skender Topi, mirëpriti në një takim ambasadorin e Greqisë në Shqipëri, Znj.Sophia Philippidou. Në fokus të këtij takimi ishte krijimi i bashkëpunimeve me në qendër zhvillimin akademik, programet e përbashkëta, projekte në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor.
- **Ekspozita dhe promovime:**
 1. 4.03.2022. Në kuadër të festimeve për “Ditën e Verës”, Departamenti i Gjuhësisë në Universitetin e Elbasanit në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan, ka organizuar ekspozitën "Elbasani i viteve 1916-1918". Studentë, profesorë, studiues dhe qytetarë të Elbasanit, janë njohur nga afër me foto të rralla nga Arkivi i Vjenës.
 2. 16.02.2022. Prof.as. dr. Ardjan Turku, ka prezantuar librin e ri të tij “Formësimi i kompetencave të mësuesve të rinj, përmes praktikave profesionale”. Ky prezantim vjen si pjesë e aktivitete që Fakulteti i Shkencave të Edukimit, organizon "në kuadër të nismës “Muaji Mars, muaji i mësuesisë në FSHE”.
 3. 23.03.2022. Qendra kërkimore e studimeve albanologjike dhe ballkanologjike “Aleks Buda” (QSAB), organizoi në Universitetin e Elbasanit, ceremoninë e promovimit të dy librave "Dukuri dhe personalitete në albanologji", me autorë Prof.dr. Liman Varoshi dhe bashkautor



Dr. Mustafa Kadzadej dhe "Elbasani, personalitete, ngjarje e dukuri historike", me autor Prof.dr. Roland Gjini.

- **Aktivitetet Erasmus+:**

1. 15.10.2021. Zhvillohet në Fakultetin Ekonomik aktiviteti "Erasmus+ Days 2021", ku në fokus të këtij takimi dhe të programit Erasmus+, janë mobiliteti ndërkombëtar, ngritja e kapaciteteve akademike dhe infrastrukture.
2. 4.11.2021. Universiteti i Elbasanit, merr pjesë në Panairin EU4Education, ku në stendën e dedikuar prezantoi programin e mobiliteteve Erasmus +, projektet si ENTRAL, VALEU-X, BKSTONE si dhe e vetmja katetër e Jean Monnet, EU Enlargement and Acquis Adoption Burden: Albanian Challenges / EEAABAC.
3. 23.09.2022. Universiteti i Elbasanit, organizon për herë të parë takimin "Erasmus+ Mobility Caffe", në kuadër të takimeve pas mobilitetit për studentët e universitetit. Studentët mundën të ndajnë eksperiencat e tyre dhe rëndësinë e mobiliteteve në zhvillimin e tyre social, intelektual dhe akademik.

- **Aktivitetet të Bordit Këshillimor të Biznesit:**

1. 27.10.2021. Organizohet leksioni i hapur: Elbasani Digjital 2025, aktiviteti i parë i organizuar nga Bordi i Këshillimor i Biznesit, një risi e Universitetit të Elbasanit, për t'u ardhur në ndihmë studentëve me workshop, trajnime, projekte apo mundësi punësimi.
2. 11.11.2021. Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit dhe Raiffeisen Bank, organizoi workshopin "Format e kredidhënies", ku në fokus ishin njohja e studentëve me funksionet, detyrat dhe praktikat e sistemit bankar.
3. 2.12.2021. Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit, organizoi workshopin "Perspektivat globale të prodhimit bujqësor", ku u trajtua rëndësia, nevoja, përfitimet dhe teknologjia e përdorur të biosimulantëve.
4. 12.01.2022. Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit, organizoi workshopin "Via Egnatia-potencial zhvillimi ekonomik, i parë si aset turistik". Studentët u njohën me llojet e ndryshme të turizmit, gastronominë, duke u ndalur në një vështrim historik të rrugës Egnatia dhe njëkohësisht parë si një potencial zhvillimi ekonomik.
5. Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit, organizoi workshopin "Bankat dhe Pandemia". Gjatë këtij takimi, për studentët u trajtua impakti i krijuar përgjatë pandemisë në ecurinë e ekonomisë dhe roli i sektorit bankar në mbështetjen e konsumatorit.
6. 23.03.2022. Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit, organizoi workshopin "Marketingu dhe komunikimi", ku studentët u prezantuan me rëndësinë që ka komunikimi, jo vetëm në marrëdhëniet shoqërore, ndërpersonale, por edhe në fushën e marketingut.
7. 12.04.2022. Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit, organizoi workshopin "Industria e turizmit dhe profesionet e së ardhmes", prezantuar nga Adriana Dodbiba Kotherja, Drejtore e Departamentit të kontratave Elite Travel Group. Studentët u prezantuan me historikun, zhvillimin, arritjet, misionin dhe vizionin e agjencisë Elite Travel Group.
8. 25.05.2022. Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit, organizoi workshopin "Të jesh bankier i suksesshëm", prezantuar nga Erion Qosja,



Këshillues Bankar pranë Credins Bank, i cili u ndal në sistemin bankar, shërbimet, roli dhe funksioni i bankierit, cilësitë dhe aftësitë në punën e tij.

9. 1.06.2022. Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit organizoi në Fakultetin Ekonomik prezantuar nga Denis Gafuri, folës ndërkombëtar, autor i librit të suksesshëm “Suksesi në Shitje”, sipërmarrës dhe gjithashtu themelues i Konventës Internacionale të Biznesit dhe Sipërmarrësve.

- **Aktivitete të tjera:**

1. 4.11.2021. Fondi Amerikano Shqiptar për Zhvillim në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit për projektin Clean Score, i dhuron Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Elbasanit, libra akademike të përkthyer nga shtëpitë më prestigjioze në të gjithë botën.
2. 25.11.2021. Studentët e Universitetit të Elbasanit zhvillojnë një bashkëbisedim me Ministren për Rininë dhe Fëmijët Znj. Bora Muzhaqi, mbi programet e nxitjes së punësimit, organizimi i aktiviteteve për të rinjtë, sfidat e digjitalizimit etj.
3. Në Universitetin e Elbasanit është prezantuar nisma "Make it Visible", një bashkëpunim midis rrjetit "Barazi në Vendimarrje" dhe Era Film, me mbështetjen dhe të Bashkimit Evropian. Studentët u prezantuan me serialin televiziv "Katrori i pushtetit", i frymëzuar nga realiteti i gazetarisë investigative në Shqipëri.
4. 20.01.2022. Shkrimtari dhe publicisti Fatmir Toçi, zgjedh Universitetin e Elbasanit për promovimin e librit “Arbëreshët midis realitetit dhe mitit”, një monografi historike-kulturore e arbëreshëve, e cila u vlerësua edhe nga pjesëmarrësit.
5. 26.01.2022. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, organizoi në ambjentet e Universitetit të Elbasanit, sesionin informues për prezantimin e thirrjes "Punime kërkimore në kuadër të programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar", midis Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.
6. 31.01.2022. Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Shoqata “Tjetër Vizion”, kanë lançuar në Universitetin e Elbasanit projektin "Ringjallja e Zanateve tradicionale përmes brezit të ri". Ky projekt ka si qëllim edukimin jo-formal të të rinjve në Bashkinë Elbasan, ofrimin e zhvillimit të aftësive të të rinjve nëpërmjet këshillimit dhe orientimi i tyre drejt sipërmarrjes artizanale.
7. 1.02.2022. Në Universitetin e Elbasanit, u organizua sesioni i leximit me studentët e gjermanistikës mbi librin historik "Roli i marinës gjermane në luftën e Kosovës 1998/99, të historianit Dr.phil. Heiko Herold.
8. 2.02.2022. Fondi Shqiptar-Amerikan për Zhvillim (AADF), zhvilloi në Universitetin e Elbasanit, sesionin informues për projektet CleanScore, Master & Internship në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe fillimin e bashkëpunimit për projektin READ (Research Expertise from Academic Diaspora).
9. 3.02.2022. Në kuadër të "Ditët e informimit të maturantëve", është zhvilluar në Universitetin e Elbasanit takimi me personelin e Zyrës Vendore Arsimore Elbasan dhe drejtorët e shkollave të mesme.
10. 3.03.2022. Në kuadër të "Ditët e informimit të maturantëve", në Universitetin e Elbasanit, janë organizuar një sërë takimesh me qëllim njohjen dhe informimin e maturantëve me universitetin, programet e studimit, personelin akademik, ndërkombëtarizimin dhe mundësitë e tjera të pafundme për ta.
11. 22.04.2022. Universiteti i Elbasanit, bëhet pjesëmarrës për herë të parë në Panairin Mbarëkombëtar të Librit Akademik dhe Shkencor. Në stendën e dedikuar, universiteti



prezantoi një gamë të gjerë librash të cilët tërhoqën vëmendjen e qytetarëve, akademikëve dhe studiuesve të ndryshëm.


12. 6.05.2022. Profesori i njohur i historisë së letërsisë në Universitetin Hebraik të Jeruzalemit, Z. Yitzchak Kerem, zhvilloi në Universitetin e Elbasanit një ligjeratë me temë “Hebrenjtë dhe shpëtimi i tyre nga shqiptarët”. Z. Kerem, ndau me studentët, fakte historike dhe eksperiencë personale.

13. 6.05.2022. Shoqata “Për Gratë dhe Fëmijët”, në bashkëpunim me AKKSHI, prezantoi në Universitetin e Elbasanit, projektin “Equality Network-Fuqizimi i grave dhe vajzave në STEM dhe kërkimi shkencor”. Përmes rritjes së prezencës së vajzave dhe grave, rritet edhe përfshirja e tyre në fusha të ndryshme, sidomos atë të kërkimit shkencor.

14. 15.09.2022. Prezantohet në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, programi i Masterit të Shkencave në “Drejtësi Transitore”.

Në lidhje me mobilitetet Erasmus+, për vitin akademik 2021-2022 Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka realizuar:

- 91 mobilitete staf Akademik/Administrativ OUTGOING gjatë vitit akademik 2021-2022. Tabela e detajuar e mobiliteteve, gjendet në vijim:



- 27 mobilitete janë të karakterit mësimdhënës (teaching mobility) dhe 64 të karakterit trajnues (training mobility).




Tabela me emrat e stafit që kanë qenë në mobilitet me Erasmus+ për vitin akademik 2021-2022

Nr.	Emër, mbiemër	Fakulteti	Teaching/ Training	Universiteti pritës
1	Lindita Durmishi	FSHE	Teaching	South West University “Neofit Rilski”
2	Elisabeta Osmanaj	FSHE	Teaching	Complutense University of Madrid
3	Erjona Hasaj	FSHE	Teaching	Complutense University of Madrid
4	Arjan Hyka	FSHE	Teaching	University of Veliko Tarnovo, Bulgaria
5	Ardian Shingjergji	FSHE	Training	University of Veliko Tarnovo, Bulgaria
6	Muzi Gjergji	FSHE	Training	University of Veliko Tarnovo, Bulgaria
7	Edmond Biçoku	FSHE	Teaching	University of Veliko Tarnovo, Bulgaria
8	Edmond Biçoku	FSHE	Teaching	University of Veliko Tarnovo, Bulgaria
9	Mikel Cenaj	FSHE	Teaching	University of Veliko Tarnovo, Bulgaria
10	Arjan Hyka	FSHE	Teaching	University of Veliko Tarnovo, Bulgaria
11	Ortenca Kotherja	FSHE	Teaching	USB Dabrova Gornica, Poland
12	Altin Idrizi	FE	Teaching	Sofia University, Kliment Ohridski
13	Ardian Durmishi	FE	Teaching	Sofia University, Kliment Ohridski
14	Miresi Çela	FE	Training	IES Ribiera do Louro
15	Kladiola Gjini	FE	Training	IES Ribiera do Louro
16	Marsida Ashiku	FE	Training	IES Ribiera do Louro
17	Anila Cekrezi	FE	Training	IES Ribiera do Louro
18	Megi Marku	FE	Training	IES Ribiera do Louro
19	Rezarta Tahiraj	FE	Teaching	West University of Timisoara, Rumani
20	Elvira Fetahu	FE	Teaching	University of National and World Economy
21	Anxhelina Zhidro	FE	Teaching	Istanbul Teknik University, Turqi
22	Ardian Durmishi	FE	Training	Tsenov Academy of Economics, Bulgaria
23	Alketa Vangjeli	FE	Training	Alexandru Ioan Cuza University of Iasi
24	Ardita Todri	FE	Teaching	University of Jaen, Spain
25	Shqiponje Leksi	FE	Training	University of Jaen, Spain
26	Artan Spahiu	FE	Teaching	University of Florence
27	Arnaldo Biçoku	FE	Training	Cracow University of Economics, Poland
28	Blendi Himci	FE	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
29	Marsida Morina	FE	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
30	Eliona Gremi	FE	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
31	Jonid Hatellari	FE	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
32	Orgen Bardhi	FE	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
33	Florenca Stafa	FSHH	Teaching	West University of Timisoara, Rumani
34	Eriada Çela	FSHH	Teaching	University of Florence
35	Anila Shehu	FSHH	Training	University of Florence
36	Merita Hoxha	FSHH	Teaching	University of Florence
37	Nirvana Meçe	FSHH	Teaching	University of Florence
38	Lenida Lekli	FSHH	Teaching	University of Florence
39	Ardita Dylgjeri	FSHH	Teaching	Alexandru Ioan Cuza University of Iasi
40	Ymer Leksi	FSHH	Teaching	WSB University Dabrova Gornicza, Poland
41	Denis Himçi	FSHH	Training	University of Florence




Nr.	Emër, mbiemër	Fakulteti	Teaching/ Training	Universiteti pritës
42	Fatos Gjata	FSHH	Training	University of Florence
43	Eva Papamihali	FSHH	Training	University Cote D'AZUR, Nice, France
44	Ardian Lami	FSHH	Training	University Cote D'AZUR, Nice, France
45	Aurela Basha	FSHH	Training	University Cote D'AZUR, Nice, France
46	Albana Pango	FSHH	Training	University Cote D'AZUR, Nice, France
47	Artan Lila	FSHH	Training	University Cote D'AZUR, Nice, France
48	Valbona Kalo	FSHH	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
49	Rudina Mita	FSHH	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
50	Meleq Shopi	FSHH	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
51	Erind Bedalli	FSHN	Teaching	WSB University Dabrova Gornicza, Poland
52	Naxhije Lami	FSHN	Teaching	University of Florence
53	Zamir Selko	FSHN	Training	University of Mendel in Brno, Czech Repub.
54	Julian Xheka	FSHN	Training	University of Mendel in Brno, Czech Repub
55	Sotir Mali	FSHN	Training	University of Mendel in Brno, Czech Repub
56	Elior Vila	FSHN	Training	University of Mendel in Brno, Czech Repub
57	Adisa Daberdini	FSHN	Training	University of Mendel in Brno, Czech Repub
58	Evald Serreqi	FSHN	Training	University of Mendel in Brno, Czech Repub
59	Silvana Turku	FSHN	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
60	Nikoleta Kallajxhiu	FSHN	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
61	Elior Vila	FSHN	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
62	Adisa Daberdini	FSHN	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
63	Erind Bedalli	FSHN	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
64	Shkelqim Hidri	FSHMT	Training	University of Foggia, Italy
65	Gjergji Koja	FSHMT	Training	University of Foggia, Italy
66	Irfan Topi	FSHMT	Training	University of Veliko Tarnovo, Bulgaria
67	Elona Gaxhja	FSHMT	Training	Kirklareli University, Turkey
68	Armela Kapaj	FSHMT	Training	Kirklareli University, Turkey
69	Blerina Bani	FSHMT	Training	Kirklareli University, Turkey
70	Etleva Sejдини	FSHMT	Training	Cracoë University of Economics, Poland
71	Blerina Hyra	FSHMT	Training	Cracoë University of Economics, Poland
72	Lutfi Vishkulli	FSHMT	Training	Cracoë University of Economics, Poland
73	Eda Çela	REKTORATI	Training	Complutense University of Madrid
74	Artan Teri	REKTORATI	Training	University of Veliko Tarnovo, Bulgaria
75	Skender Topi	REKTORATI	Training	University of Foggia, Italy
76	Hasan Topi	REKTORATI	Training	Tsenov Academy of Economics, Bulgaria
77	Eda Çela	REKTORATI	Training	Tsenov Academy of Economics, Bulgaria
78	Skender Topi	REKTORATI	Training	Tsenov Academy of Economics, Bulgaria
79	Eljan Hoxha	REKTORATI	Training	University of Florence
80	Dritan Konica	REKTORATI	Training	University of Florence
81	Skender Topi	REKTORATI	Teaching	University of Florence
82	Eda Çela	REKTORATI	Training	University of Florence
83	Skender Topi	REKTORATI	Teaching	University of Veliko Tarnovo, Bulgaria



Nr.	Emër, mbiemër	Fakulteti	Teaching/ Training	Universiteti pritës
84	Ervis Sanço	REKTORATI	Training	Cracoë University of Economics, Poland
85	Elvis Dhono	REKTORATI	Training	Cracoë University of Economics, Poland
86	Eda Çela	REKTORATI	Training	University Cote D'AZUR, Nice, France
87	Indrit Shkupi	REKTORATI	Training	University of Mendel in Brno, Czech Rep
88	Blerim Lushi	REKTORATI	Training	University of Mendel in Brno, Czech Rep
89	Hasan Topi	REKTORATI	Training	University of Mendel in Brno, Czech Rep
90	Indrit Shkupi	REKTORATI	Training	IES de Teis, Vigo, Spain
91	Xhino Çela	REKTORATI	Training	IES de Teis, Vigo, Spain

- 52 INCOMING staf nga Erasmus+, të cilat janë kryer gjatë vitit akademik 2021-2022, në UE.

Mobilitetet e personelit akademik dhe jo akademik nga universitetet partnere janë të përhapura në të gjitha njësitë e UNIEL. Tabela e detajuar e mobiliteteve gjendet bashkëlidhur. Fluksi i mobiliteteve paraqitet në vijim:



- 25 mobilitete kanë janë të karakterit mësimdhënës (teaching mobility) dhe 27 të karakterit trajnues (training mobility).




Tabela me emrat e Incoming Staff, që kanë qenë në mobilitet me Erasmus+ për vitin akademik 2021-2022

Nr.	Emër, mbiemër	Fakulteti pritës	Teaching/ Training	Universiteti dërgues
1	Cevher Altug	FSHN	Teaching	Bolu Abant Izzet Baysal University, Turkey
2	Senol Kaya	FSHN	Teaching	Bolu Abant Izzet Baysal University, Turkey
3	Cevdet Tunç	FE	Teaching	Bolu Abant Izzet Baysal University, Turkey
4	Harun Karsli	FSHN	Teaching	Bolu Abant Izzet Baysal University, Turkey
5	Umid Karli	FSHE	Teaching	Bolu Abant Izzet Baysal University, Turkey
6	Joanna Konecka	FE	Teaching	The John Paul II Cath. Univ. of Lublin, Poland
7	Magdalena Kiczuk	REKTORAT	Training	The John Paul II Cath. Univ. of Lublin, Poland
8	Tomasz Kostecki	REKTORAT	Training	The John Paul II Cath. Univ. of Lublin, Poland
9	Ünal ÇAĞLAR	FE	Teaching	Kirklareli University, Turkey
10	Abdüselam SAĞIN	FE	Teaching	Kirklareli University, Turkey
11	İbrahim KİYAT	FSHMT	Training	Kirklareli University, Turkey
12	Zeliha Elkan KİYAT	FSHMT	Training	Kirklareli University, Turkey
13	Jerzy Szakiel	FE	Teaching	Cracow University of Economics, Poland
14	Dominika Lemler	REKTORAT	Training	Cracow University of Economics, Poland
15	Joanna Jackowska	REKTORAT	Training	Cracow University of Economics, Poland
16	Alina Hagi	REKTORAT	Training	University of Pitesti, Romania
17	Adriana Pantoiu	REKTORAT	Training	University of Pitesti, Romania
18	Andra Puran	REKTORAT	Training	University of Pitesti, Romania
19	Damian Dzieëa	REKTORAT	Training	Cracow University of Economics, Poland
20	Pawel Wójcik	REKTORAT	Training	Cracow University of Economics, Poland
21	Ventsislav Vasilev	FE	Teaching	D. A. Tsenov Academy of Economics, Bulgar
22	Dimitar Kostov	FE	Teaching	D. A. Tsenov Academy of Economics, Bulgaria
23	Wojchic Lis	FE	Teaching	The John Paul II Cath. Univ. of Lublin, Poland
24	Silvia Pezzoli	REKTORAT	Training	University of Florence
25	Kamila Hercova	REKTORAT	Training	Mendel University in Brno
26	Tomàs Sochor	FSHN	Teaching	Mendel University in Brno
27	Marzena Dyjakoëska	FE	Teaching	The John Paul II Cath. Univ. of Lublin, Poland
28	Marcellin Yovogan	FE	Teaching	Sofia University “St. Kliment Ohridski” Bulgaria
29	Kamen Spassov	FE	Teaching	Sofia University “St. Kliment Ohridski” Bulgaria
30	Aneta Bialy	FE	Teaching	The John Paul II Cath. Univ. of Lublin, Poland



Nr.	Emër, mbiemër	Fakulteti pritës	Teaching/ Training	Universiteti dërgues
31	Sheyla Moroni	FSHH	Teaching	University of Florence, Italy
32	Biljana Radic- Bojanic	FSHE	Teaching	CEEPUS
33	Laura Pitulice	FSHN	Teaching	West University Of Timisoara, Rumania
34	Mihaela Balilescu	FSHN	Teaching	University of Pitesti, Romania
35	Maria Miroiu	REKTORAT	Training	University of Pitesti, Romania
36	Elena Stavrova	FE	Teaching	South-West University “Neofit Rilski”, Bulgaria
37	Gancho Ganchev	FE	Teaching	South- West University “Neofit Rilski”, Bulgaria
38	Natasha Angelova	REKTORAT	Training	South- West University “Neofit Rilski”, Bulgaria
39	Boris Manov	REKTORAT	Training	South- West University “Neofit Rilski”, Bulgaria
40	Buliga Iuliana	FSHH	Teaching	Alexandru Ioan Cuza University of Iasi
41	Elena Karashtranova	REKTORAT	Training	South- West University “Neofit Rilski”, Bulgaria
42	Sidzhimkov Veselin	REKTORAT	Training	South- West University “Neofit Rilski”, Bulgaria
43	Nadezhda Borisova	REKTORAT	Training	South- West University “Neofit Rilski”, Bulgaria
44	Popkochev Aleksandar	REKTORAT	Training	South- West University “Neofit Rilski”, Bulgaria
45	Giuseppina Zago	REKTORAT	Training	University of Florence, Italy
46	Albana Dedja	REKTORAT	Training	University of Florence, Italy
47	Sandro Landucci	FSHE	Teaching	University of Florence, Italy
48	Dancho Pandulchev	FSHE	Teaching	St. Cyril and Methodius Univ. of Veliko Tarnovo
49	Daniela Pandulcheva	REKTORAT	Training	St. Cyril and Methodius Univ. of Veliko Tarnovo
50	Giorgia Bulli	FSHH	Teaching	University of Florence
51	Krasimir Stefanov	REKTORAT	Training	St. Cyril and Meth. University of Veliko Tarnovo
52	Vyte Kontautiene	FSHE	Teaching	Klaipeda University, Lithuania

Konfirmime diplomimi për ish studentë të UE-së:

Gjatë vitit akademik 2021-2022 janë bërë 69 konfirmime diplomash, lista notash dhe plotësime formularësh të studentëve të cilët kanë mbaruar studimet në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe 2 konfirmime për personel akademik të angazhuar më parë në UE. Këto konfirmime janë bërë nga individë, kompani, universitete dhe institucione të shteteve të huaja, ku ish studentët kanë aplikuar për arsye nga më të ndryshmet, si njohjen e diplomave, regjistrime për studime, regjistrime punësimi etj. Kërkesat më shumë janë nga SHBA, Kanada, Gjermani, Britania e Madhe



dhe shumë shtete të tjera evropiane dhe shtete jashtë Evropës. Studentët janë nga të gjitha fakultetet e UE-së, ku në formën e të dhënave statistikore mund të përmendim:

- 19 studentë të diplomuar në FE,
- 11 studentë të diplomuar në FSHE,
- 11 studentë të diplomuar në FSHH,
- 1 student master i FSHE me diplomë bachelor nga FSHH,
- 13 studentë të diplomuar në FSHMT,
- 14 studentë të diplomuar në FSHN,
- 2 persona janë personel akademik i punësuar më parë në UE.

Në mënyrë të përmbledhur, grafiku në vijim paraqet të dhënat në lidhje me kompanitë apo institucionet që kanë drejtuar kërkesat.




Tabela me të dhënat mbi verifikimet (konfirmimet) gjatë vitit akademik 2021-2022

Nr.	Emër	Mbiemër	Fakulteti	Data	Dërguar
Në tabelën e mësipërme janë të listuara 10 projekte të huaja, nga i cili projekti i parë kanë përfunduar në afatet kohore të financimit të tij. Projekti “Profesionet e sportit – Shkollimi, Punësimi, Zhvillimi në Rajonin e Ballkanit” ka përfunduar dhe është me gjendje fonde në bankë, për të cilat nuk është shprehur donatori, në zbatimin të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 35 datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ndryshuar. Projekti “T@SK” ka përfunduar. Për këtë projekt janë kryer procedurat rikthimit të financimit, bazuar në shkresën e Donatorit për fondet e disbursuara. Projektet: “e-VIVA”, “BEKSTONE”, “VALEU-X”, “EEAABAC”, “NEET HORIZONS” janë në proces. Projektet: “HEI4FUTURE”, pritet të disbursohen së shpejti, jemi në proces të hapjes së llogarisë speciale. Personeli akademik ka aplikuar në disa projekte të huaja. Sipas të dhënave të paraqitura është 1 projekt i cili është reflektuar në pasqyrën e mësipërme: “FARINA”.

c) **Realizimi faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifrat e shkollimit për vitin akademik në vijim.**

1. Realizimi i plan buxhetit të vitit 2021

Për vitin 2021 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën **1,536,605** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2021-Fakti				000/lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2020	Financimi viti 2021	Buxheti viti 2021
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfertat)	168,500	914,814	1,083,314
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	11,359	6,256	17,615
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	288,585	147,091	435,675
TOTALI		468,444	1,068,161	1,536,605

- Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfertat), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) **1,083,314** mijë lekë.
- Projekte të huaja **17,615** mijë lekë,
- Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vitet e mëparëshme) **435,675** mijë lekë.

1.1. Hyrjet e fondeve për vitin 2021. Hyrjet e fondeve për Universitetin për vitin 2021 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën **1,536,605** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

- Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) në vlerën **36,017** mijë lekë, ose 97.⁷² %, nga i cili kërkimi shkencor nga Buxheti është çelur 100 % e fondit të planifikuar nga Bordi i AKKSHI-it, ndërsa TVSH për projekte të huaja 47.⁸⁷ %.
- Grant mësimdhënie e bursat e studentëve në vlerën **1,047,297** mijë lekë, ose 100.⁰⁰ %,



- Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga vitet e mëparëshme) në vlerën **435,675** mijë lekë, ose 89.¹⁷ %
- Projekte të huaja **17,615** mijë lekë, ose 75.⁶³ %

Fonde të hyra "Buxheti viti 2021" fakti				000/lekë
Nr	Emërtimi i programit	Buxheti vjetor	Akorduar	në %
1	Grant konkurrues	0	0	0.00
2	Grant kërkimi shkencor	35,246	35,246	100.00
3	Buxhet -TVSH projekte të huaja	1,611	771	47.87
I	Buxheti i brendshëm	36,857	36,017	97.72
1	Grant mësimdhënie	1,047,297	1,047,297	100.00
II	Grant	1,047,297	1,047,297	100.00
1	Të ardhurat e trashëguara viti 2019	288,585	288,585	100.00
2	Të ardhura jashtë limiti viti 2020	200,000	147,091	73.55
III	Të ardhura	488,585	435,675	89.17
1	Projekti të huaja	23,290	17,615	75.63
IV	Projekti të huaja	23,290	17,615	75.63
	Totali	1,596,029	1,536,605	96.28

Ndarë në artikuj dhe sipas realizimeve përkatëse treguesit e këtij buxheti janë në pasqyrat: "Të Ardhurat për viti 2021 - fakti", "Realizimi i Buxhetit për vitin 2021 - Fakti "

Të Ardhurat për 12- mujorin viti 2021 - fakti				
Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	%
A	Të ardhura të vitit	200,000	147,091	73.5
1	Qera	520	123	23.7
2	Programe profesionale	16,200	6,836	42.2
3	Bachelor	57,997	42,766	73.7
4	DIND	1,013	688	67.9
5	Master profesional	57,770	47,818	82.8
6	Master i Shkencave	47,252	34,204	72.4
7	Trajnim Mësues	400	49	12.3
8	Doktoraturë	0	625	0.0
9	Libreza Diploma etj.	4,173	2,639	63.2
10	Lëshim dokumenti	5,000	3,748	75.0
11	Taksë regjstrimi	5,075	5,107	100.6
12	Tarifa konkurrimi	500	550	110.0
13	Tjera - shërbime	3,102	1,424	45.9
14	Pjesm. konferenca	1,000	130	13.0
15	Sponsorizime	0	386	0.0
B	Të ardhura të trashguara	288,585	288,585	100.00
1	Trashëguar nga viti 2020	288,585	288,585	100.00
	Totali	488,585	435,675	89.2

Fondet e kushtëzuara – të ardhurat e UE - së: Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën 435,675 mijë lekë ose 89.¹⁷ % të krahasuara me planin vjetor të tyre, ndërsa të ardhurat për tu grumbulluar në vitin 2021 janë realizuar në vlerën 147,091 mijë lekë ose 73.⁵⁵ % të krahasuara me planin vjetor të tyre.


Realizimi prej 73.⁵⁰ % është rezultat i grumbullimit i një pjese të tarifave të shkollimit të planifikuara për vitin 2021 në tetor–dhjetor 2020. Një pjesë e këtyre të ardhurave janë përdorur për shpenzimet e planifikuara për tu realizuar në vitin 2020. Pjesa e papërdorur ka kaluar si të ardhura të trashëguara për vitin 2021.

Grumbullimi i të ardhurave gjatë periudhës janar – dhjetor 2021 është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria ekonomike dhe fakultetet.

Grupimet më kryesore të të ardhurave janë realizuar:

- Tarifa shkollimi 90.⁶⁰ %
- Tarifa rregjistrimi 3.⁵⁰ %
- Tarifa konkurrimi 0.⁴⁰ %
- Të ardhura Qira 0.¹⁰ %
- Të tjera 5.⁴⁰ %





Në zërat e të ardhurave peshën kryesore e zënë:

- Tarifat e shkollimit nga trajnimi i mësuesve 0.⁰⁴ % e tarifave ose 12.³ % e planifikimit.

- Tarifat e shkollimit nga doktorigjiturat 0.⁴⁷ % e tarifave.


- Libreza e diploma me rreth 1.⁷⁹ % e të ardhurave ose 63.²⁰ % e planifikimit,

- Lëshim dokumenti me rreth 2.⁵⁵ % e të ardhurave ose

- Tarifat e shkollimit nga programet profesionale 5.¹⁴ % e tarifave ose 42.² % e planifikimit.
- Tarifat e shkollimit nga programet bachelor 32.¹⁶ % e tarifave ose 73.⁷ % e planifikimit.
- Tarifat e shkollimit nga programet e integruara – DIND 0.⁵² % e tarifave ose 67.² % e planifikimit.
- Tarifat e shkollimit nga programet master profesionale 35.⁹⁶ % e tarifave ose 82.⁸ % e planifikimit.
- Tarifat e shkollimit nga programet master i shkencave 25.⁷² % e tarifave ose 82.⁴ % e planifikimit.

75.⁰⁰ % e planifikimit,

- Tarifa rregjistrimi me rreth 3.⁴⁷ % e të ardhurave ose 100.⁶⁰ % e planifikimit,
- Tarifa konkurrimi me rreth 0.³⁷ % e të ardhurave ose 110.⁰⁰ % e planifikimit,
- Shërbime të ndryshme ndaj studentëve dhe të tretëve rreth 0.⁹⁷ % e të ardhurave ose 45.² % e planifikimit,
- Pjesmarrje në konferenca rreth 0.⁰⁹ % e të ardhurave ose 13.⁰ % e planifikimit,
- Sponsorizime janë trajtuar financimet e Universiteteve të huaja për shpenzime operative në kudër të bashkëpunimit rreth 0.²⁶ % e të ardhurave,



Efektet që kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave:

- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit për Ciklin e parë të studimeve dhe ulja e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, në zbatim të VKM s dhe Vendimeve të BA – së. Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës të plotë të tarifës së shkollimit.
- Sipas aplikimeve të kryera nga studentët për këtë qëllim përfitimi i tyre është 75,759 mijë lekë sipas tabelës së mëposhtme
- Mosshlyerja në kohë e detyrimeve të tarifave të shkollimit nga një pjesë e konsiderueshme e studentëve.
- Moshapja e disa programeve në MP e MSH për vitin e parë si rezultat i mos plotësimit të numrit minimal të regjistrimeve. Për këto programe është planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.
- Moshapja e disa programeve në Bachelor me kohë të plotë për vitin e parë për shkak të numrit minimal të regjistrimeve.
- Numri i ulët i regjistrimeve në disa programe studimi. Për këto programe ishte planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.
- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit për Ciklin e parë të studimeve dhe ulja e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, në zbatim të VKM – s dhe Vendimeve të BA – së. Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës të plotë të tarifës së shkollimit.

Efektet e VKM-ve - Për studentë që përfitojnë përjashtim apo reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2020-2021								
DEGA	I parë		I dytë		I tretë		Total	
	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera
Reduktim tarife me 50% Viti I-Bach, 2v	1,428	17,850	0	0	0	0	1,428	17,850
Reduktim tarife me 50% Viti I-DIND	61	915	0	0	0	0	61	915
Reduktim tarife me 50% mesatare mbi 6 Viti II + III	0	0	369	4,613	266	3,325	635	7,938
Përjashtimet nga tarifat e shkollimit me rezultate	47	1,175	29	725	47	1,175	123	3,075
Përjashtimet nga tarifat e shkollimit kritere tjera -DIND	20	600	0	0	0	0	20	600
Përjashtimet nga tarifat e shkollimit kritere tjera -Bach+2vj	388	9,700	552	13,800	413	10,325	1,353	33,825
Cikli parë i studimeve + DIND Totali	1,944	30,240	950	19,138	726	14,825	3,620	64,203
Reduktim tarife me 50% me rezultate	15	450	14	420	0	0	29	870
Reduktim tarife me 50% me kritere tjera	111	3,330	58	1,740	0	0	169	5,070
Total MP	126	3,780	72	2,160	0	0	198	5,940
Reduktim tarife me 50% me rezultate	12	432	46	1,656	0	0	58	2,088
Reduktim tarife me 50% me kritere tjera	55	1,980	43	1,548	0	0	98	3,528
Total MSH	67	2,412	89	3,204	0	0	156	5,616
Cikli dytë i studimeve Totali	193	6,192	161	5,364	0	0	354	11,556
Total UE	2,137	36,432	1,111	24,502	726	14,825	3,974	75,759

Të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2021 janë 147,091 mijë lekë, nga të cilat janë çelur për përdorim 6,500 mijë lekë. Nga të ardhurat e çelura në vitin 2020 por të papërdorura, që janë transferuar për përdorim për vitin 2021, si dhe ato të çelura për përdorim janë përdorur 72,326 mijë lekë, sipas ndarjeve në tabelë, ose grafikisht:

- Softe, liçenca, patenta laboratorit i gjuhëve të huaja vlera 1,680 mijë lekë ose 2.30 % e të ardhurave të përdorura,
- Kërkim shkencor – 602 vlera 10,475 mijë lekë ose 14.50 % e të ardhurave të përdorura,
- Kërkim shkencor – 606 vlera 1,351 mijë lekë ose 1.90 % e të ardhurave të përdorura,
- Investime vlera 46,016 mijë lekë ose 63.60 % e të ardhurave të përdorura,
- Shpenzime operative vlera 1,593 mijë lekë ose 2.20 % e të ardhurave të përdorura
- Transferta me jashtë vlera 166 mijë lekë ose 0.20 % e të ardhurave të përdorura,




- Transferta tek individë (kryesisht rimbursim i tarifave të shkollimit) vlera 7,046 mijë lekë ose 9.70 % e të ardhurave të përdorura,
- Transferim tek projekte të huaja vlera 4,000 mijë lekë ose 5.50 % e të ardhurave të përdorura (të disbursuara gabimisht në Bankën e nivelit të dytë)
- Derdhen në Buxhet 12 mijë lekë (10 % e të ardhurave nga qiratë).

Të ardhurat e çelura në fillim dhe gjatë vitit 2021, por të papërdorura janë 231,793 mijë lekë që transferohen për përdorim për vitin 2022. Të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2021 të paçelura për përdorim janë 140,579 mijë lekë, që transferohen për përdorim për vitin 2022.

Përdorimi i të ardhurave viti 2021			
Nr.	Emërtimi	000/lekë	%
1	Softe, liçenca, patenta	1,680	2.3%
2	Kërkim shkencor - 602	10,475	14.5%
3	Kërkim shkencor - 606	1,351	1.9%
4	Investime	46,016	63.6%
5	Shpenzime operative	1,593	2.2%
6	Transferta me jashtë	166	0.2%
7	Transferta tek individë	7,046	9.7%
8	Transferim tek projekte të huaja	4,000	5.5%
Totali		72,326	100.0%

Të ardhurat janë çelur për përdorim sipas ndarjeve në planbuxhetin e vitit 2021 për Universitetin, mbështetur në domosdoshmërinë për shpenzim për çdo artikull dhe kontratave të lidhura e të realizuara në investime e shpenzime operative, si dhe për shpenzime të tjera korente. Të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2021 të paçelura për përdorim gjatë këtij viti janë transferuar për përdorim për vitin 2022 për investime dhe kërkim shkencor sipas listës së projekteve në PBA-në e viteve 2022-2024.



Përdorimi i të ardhurave, viti 2021

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" ka arkëtuar të ardhura për periudhën 2016-2021 sipas disa grup zërave të mëposhtme:

Të Ardhurat për vitet 2016-2021							
Nr	Emërtimi	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Qera	502	520	486	377	124	123
2	Bachelor, programe prof	139,035	164,038	139,822	62,722	66,414	50,289
3	Master profesional	56,922	61,363	57,921	47,953	40,710	47,818
4	Master i Shkencave	37,281	44,611	46,428	41,349	29,014	34,204
5	Trajnim Mësues	0	0	0	0	0	49



Nr	Emërtimi	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
6	Doktoraturë	139	486	347	108	0	625
7	Bach. koha pjessh.	36,997	18,852	1,696	0	0	0
8	Libreza diploma etj.	11,153	14,333	10,849	4,171	2,909	2,639
9	Lëshim dokumenti	2,718	4,187	4,379	3,714	2,599	3,748
10	Taksë regjstrimi	7,698	6,888	5,786	5,272	5,155	5,107
11	Tarifa konkurrimi	511	414	420	415	485	550
12	Tjera – shërbime analiza lab	590	995	744	1,747	1,889	1,424
13	Pjesm. konferenca	2,984	1,353	948	0	5	130
14	Sponsorizime	0	176	285	632	185	386
15	Të ndryshme	0	0	0	0	4,000	16
	Të ardhura të vitit	296,530	318,216	270,109	168,461	153,488	147,107

Nga njëri vit në tjetrin arkëtimi i tyre nga parashikimi ka pësuar luhate si rezultat:

- Nuk është realizuar regjistrimi i numrit të studentëve të parashikuar në çdo program studimi
- Efektet financiare në arkëtimin e tarifave të shkollimit në zbatim të VKM –ve sipas të cilëve:
 - përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët e ciklit të parë, që plotësojnë kriteret e përcaktuara.
 - reduktohet me 50% tarifa vjetore e shkollimit për studentët e ciklit të dytë, që plotësojnë kriteret e përcaktuara

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka arkëtuar të ardhura për periudhën 2016-2021 për shërbime ndaj të tretëve kryesisht; shërbime të analizave të materialeve të ngurta ose të lëngëta të bizneseve ndërtuese ose importuese për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të cilat kryhen në Laboratorin kërkimor eksperimental (i akredituar), Lëshim dokumentacioni për të diplomuarit në vitet e mëparshme në këtë institucion.

Të Ardhurat nga shërbimet ndaj të tretëve për vitet 2016-2021

Nr	Emërtimi	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Lëshim dokumenti	2,718	4,187	4,379	3,714	2,599	3,748
2	Shërbime analiza	590	995	744	1,747	1,889	1,424
	Totali	3,308	5,182	5,122	5,461	4,487	5,172

1.2 . Shpenzimet për vitin 2021. Gjatë të vitit 2021 shpenzimet gjithsej janë realizuar 47.69 % e financimit vjetor.

Nr	Shpenzime të fondeve të çelura (akorduar)			000/lekë
	Emërtimi i programit	Çelur për përdorim	fakt	në %
1	Grant konkurrues	0	0	0.00
2	Grant kërkimi shkencor	35,246	4,800	13.62
3	Buxheti -TVSH projektsh të huaja	771	771	100.00
I	Buxheti i brendshëm	36,017	5,571	15.47
1	Grant mësimdhënie dhe bursat e studentëve	1,047,297	734,605	70.14
II	Grante	1,047,297	734,605	70.14
1	Të ardhura jashtë limiti viti 2021	305,763	72,326	23.65
III	Të ardhura	305,763	72,326	23.65
1	Projekti të huaja	17,615	8,400	47.69
IV	Projekti të huaja	17,615	8,400	47.69
	Totali plan buxheti i çelur	1,406,692	820,902	58.36



Planbuxheti i çelur për përdorim (Plan Thesari) në vlerën **1,406,692 mijë** lekë është realizuar në vlerën **820,902 mijë** lekë , ose 58.³⁶ %

- Sipas formave të financimit
 - Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues, TVSH projekte, kërkimi shkencor nga buxheti) është realizuar 15.⁴⁷ % e fondit të çelur.
 - Granti për mësimdhënie për shpenzime korente dhe bursat e studentëve është realizuar 70.¹⁴ %.
 - Shpenzimet nga të ardhurat e institucionit janë realizuar 23.⁶⁵ %.
 - Projekte të huaja gjithësej 47.⁶⁹ %
- Sipas zërave të shpenzimit:
 - Shpenzimet për Paga e shpërblime 61.⁴ %
 - Shpenzimet për Sigurime shoqërore 84.² %
 - Shpenzimet për Shpenzime operative 60.² %
 - Transferta me jashtë 18.⁵ %
 - Transferta tek individët 70.⁵ %
 - Bursat për studentët 97.⁴ %
 - Shpenzimet për kërkimin shkencor 31.⁸% nga të cilat: Buxheti i çelur 13.⁶ %, Të ardhurat 69.¹ %
 - Shpenzimet për investimet 21.⁹ %
 - Projektet e huaja 47.⁷ %

Më i detajuar realizimi i buxhetit sipas formave të financimit dhe ndarjes së zërave të shpenzimeve paraqitet në tabelën “Realizimi i planbuxhetit për vitin 2021”

- **Paga e shpërblime – Artikulli 600.** Pagat për vitin 2021 janë mbuluar kryesisht me fondet nga Granti për shpenzime korente në masën 63.⁶ % të planit vjetor, ose 61.⁴ % të parashikimit duke përfshirë dhe të ardhurat. Plani vjetor i pagave përfshin edhe mbulimin nga të ardhurat të çelura për përdorim në vlerën 25,078 mijë lekë.

Me këtë fond page janë përballuar ndryshimet e pagës sipas kualifikimit të personelit akademik, pagesa për orët mësimore të personelit akademik efektiv dhe të ftuar. Pjesën më të madhe në zërin paga e shpërblime e zënë pagat mujore me vlerë 354,819 mijë lekë në masën 59.⁸% të realizimit të fondit të pagave. Me zërin e shpenzimit paga honorare përfshihet pagesa për orët mësimore të zhvilluara në vitin 2020 – 2021, e cila përbëhet:

- Pagesa për orët mbi normë të personelit akademik efektiv për 54,941 orë mësimore të pagueshme me vlerë 53,193 mijë lekë.
- Pagesa e personelit akademik i ftuar (pedagogë të jashtëm)për 37,599 orë mësimore të pagueshme me vlerë 30,479 mijë lekë. dhe pagesa e personelit akademik i ftuar (pedagogë të jashtëm). në masën 1.3% të fondit të realizuar. Të dhënat më të detajuara rezultojnë si në tabelën “Pagesa e orëve mësimore për vitin 2020 – 2021”.

Pagesa e orëve mësimore për vitin 2020 – 2021							
Nr	Lloji shpenzimit	Plan		Realizuar		Paguar	
		Orë	Lekë	Orë	Lekë	Orë	Lekë
1	Orë mësimore për punonjës të brendshëm	78,000	75,547	57,706	55,653,364	57,706	55,653,364
2	Orë mësimore për punonjës të jashtëm	29,092	23,593	29,933	29,871,743	29,933	29,871,743
	Fondi gjithësej	107,092	99,140	87,639	85,525,107	87,639	85,525,107

- **Fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601.** Fondi për sigurime shoqërore është shpenzuar për likuidimin e detyrimeve që institucioni ka ndaj Degës së Sigurimeve Shoqërore,



si kontribut për punonjësit e vet. Ky zë është realizuar në masën 63,530 mijë lekë e shprehur me 90.¹% e fondit të planifikuar nga Granti i mësimdhënies, ose 84.² % për fondin e planifikuar vjetor. Niveli i realizimit të fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore të lidhura me pagat është rezultat i mosrealizimit të numrit mesatar të punonjësve akademikë gjatë vitit 2021. Ky fenomen ka sjellë mbulimin e procesit mësimor akademik me mbingarkesë të personelit akademik efektiv (ngarkesë e cila nuk mund të paguhet në masën 100% të realizimit), mbulimin e procesit mësimor akademik me personel akademik të ftuar mbi parashikimin në fillim të vitit, e për pasojë me një efikasitet akademik të mbingarkuar.

- **Shpenzime operative – Artikulli 602.** Për vitin 2021 shpenzimet operative janë parashikuar të përballohen nga granti për shpenzime korente dhe nga të ardhurat. Këto shpenzime janë realizuar në masën 60.⁹ % e fondit të çelur për këtë qëllim: nga granti 68.² % dhe nga të ardhurat 7.⁴ % e planit vjetor. Shpenzimet operative për vitin 2021, janë realizuar kryesisht për: ujë, energji, telefon, karburant, buletini shkencor, kancelari, furnizime të ndryshme materiale, rojet e godinave, riparime të ndryshme pajisjesh, udhëtim e hotel për ekspeditat etje. Rritje të ndjeshme në shpenzimet operative kanë disa zëra të domosdoshëm që i shërbejnë procesit mësimor. Krahas kësaj, rritje të ndjeshme kanë pagesat për rojet (ruajtjen e sigurimin e objekteve), uji, energjia elektrike, karburanti për ngrohje etje. Në formë të përmbledhur jepen në tabelën “Shpenzime për mallra dhe shërbime (602) viti 2021”. Mosrealizimi i shpenzimeve operative të planifikuara ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të disa prokurimeve për shkak të anulimit të procedurave, ndërkohë që procedurat e prokurimit janë filluar në afatet e kërkuara, por nuk janë përfunduar në afat. Vlen të theksojmë mosrealizimin e procedurës së prokurimit për objektin “Mirëmbajte objekte ndërtimore dhe mjedise të jashtme”, që është anuluar nga KPP në fund të dhjetorit 2021 dhe që zë 8.² % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative.

<i>Shpenzime për mallra dhe shërbime (602) viti 2021</i>										
Kodi llog	Grup shpenzimi	Grant			Të ardhura			Totali		
		Plan vjetor	Fakt	%	Plan vjetor	Fakt	%	Plan vjetor	Fakt	%
6020	Materiale zyre dhe te pergjithshme	7,320	1,041	14.2	4,400	1,046	23.8	11,720	2,088	17.8
6021	Materiale dhe shërbime speciale	12,380	2,545	20.6	1,560	126	8.1	13,940	2,670	19.2
6022	Shërbime nga te trete	82,770	70,004	84.6	6,280	131	2.1	89,050	70,135	78.8
6023	Shpenzime transporti + lëndë djegëse	6,000	2,924	48.7	240	0	0.0	6,240	2,924	46.9
6024	Shpenzime udhëtimi	8,600	3,654	42.5	300	0	0.0	8,900	3,654	41.1
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	18,800	8,261	43.9	940	0	0.0	19,740	8,261	41.9
6026	Shpenzime per qiramarrje	3,000	3,224	107.5	480	0	0.0	3,480	3,224	92.6
6027	Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale	1,645	1,645	100.0	0	0	0.0	1,645	1,645	100.0
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0.0
6029	Shpenzime te tjera operative	17,002	14,153	83.2	7,326	290	4.0	24,329	14,443	59.4
	Totali	157,518	107,452	68.2	21,526	1,593	7.4	179,044	109,044	60.9

Në shpenzimet për ekspeditat e studentëve në vitin 2021 reflektohet ulje e tyre. Për periudhën e analizuar ky zë është realizuar 50.²⁵ % e vlerës së planifikuar, ose 80.¹⁹% e numrit të studentëve të planifikuar. Kjo për kufizimin e lëvizjeve dhe fjetjeve në hotele, pasi pjesërisht mësimi u zhvillua online për shkak të pandemisë së Covid19. Ekspedita është realizuar në fillim në mesin e dhjetorit 2021 nga programi i studimit të Ciklit të parë “Bachelor në edukim fizik dhe sporte”, viti i parë



2020-2021, për praktikimin e sportit të skive, pasi nuk ishte e mundur zhvillimi në janar 2021. Shtyerja e praktikës së skive u krye me vendim të Senatit Akademik

FAKTI-EKSPEDITAVE VITI SHKOLLOR 2020 - 2021										
	Cikli	Prog rami	Stud.	Pedag +Lab.	Stude. Pedag +Lab.	Lëvizizja Km	Vlera Udhëtimit lekë	Netë	Vlera Fjetjes lekë	Total lekë
Totali Plan	I+II	7	429	55	484	7,066	848,840	50	4,860,000	5,708,840
Totali Fakt	I+II	3	344	45	389	4138	708,503	10	2,160,000	2,868,503
Përqindja e realiz			80.19%	81.82%	80.37%	58.56%	83.47%	20.00%	44.44%	50.25%

- **Shpenzime operative për transferta me jashtë – Artikulli 605.** Transferta me jashtë është realizuar 18.5 % e fondit vjetor të planifikuar. Ky shpenzim është planifikuar për pagesën e pjesëmarrjes në institucione apo organizata ndërkombëtar. Është kryer vetëm një pagesë për Laboratorin kërkimor të FSHN për kryerjen e testeve të analizave në Institucione të akredituara ndërkombëtare, për procesin e akreditimit të këtij laborator
- **Transferta tek individët bursat e studentëve– Artikulli 606. Bursat e studentëve.** Për vitin 2021 fondi i bursave të studentëve është realizuar 97.4 % e fondit vjetor të planifikuar. Në këtë artikull përfshihen bursat financiare të studentëve (transferta tek individët) për Ciklin e parë të studimeve. Fondi është akorduar në Grantin për bursat e studentëve në fillim të vitit gjithsej **126,605 mijë** lekë. Sipas procedurës së përcaktuar nga BA në zbatim të VKM-ve për këtë qëllim, kanë paraqitur kërkesat për bursë financiare e përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 1,675 studentë. Nga kërkesat e paraqitura janë miratuar me vendim BA-së të trajtohen me bursë financiare 1,419 studentë me fond 127,710 mijë lekë

Miratuar me Vendim Bordi Administrimi për vitin akademik 2020-2021									000/lekë
Emërtimi	Viti i parë		Viti i dytë		Viti i tretë		Totali		
	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	
Trajtohen me rezultate	47	4,230	29	2,610	47	4,230	123	11,070	
Trajtohen kritere tjera	388	34,920	532	47,880	376	33,840	1,296	116,640	
Shuma	435	39,150	561	50,490	423	38,070	1,419	127,710	

Në zbatim të vendimeve për bursat janë kaluar në bankë në llogaritë e 1,419 studentëve vlera 123,210 mijë lekë nga fondet e vitit 2021.

Bursa të paguar në bankë për vitin akademik 2020-2021									000/lekë
Emërtimi	Viti i parë		Viti i dytë		Viti i tretë		Totali		
	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	
Transferuar studentëve me rezultate	47	4,230	29	2,610	47	4,230	123	11,070	
Transferuar studentëve kritere tjera	388	32,740	532	46,410	376	32,990	1,296	112,140	
Shuma	435	36,970	561	49,020	423	37,220	1,419	123,210	
Transferuar studentëve në vitin 2020	0	0	0	0	0	0	0	0	
Transferuar studentëve në vitin 2021	435	36,970	561	49,020	423	37,220	1,419	123,210	

Studentët që përfitojnë bursë vitet 2016-2021

Nr	Kriteri	2016-2017		2017-2018		2018-2019		2019-2020		2020-2021	
		Nr.st	Fonde	Nr.st	Fonde	Nr.st	Fonde	Nr.st	Fonde	Nr.st	Fonde
1	Transferuar studentëve me rezultate	0	0	3	220	95	7,236	103	8,831	123	11,070
2	Transferuar studentëve kritere tjera	1,102	51,081	1,196	52,399	1,471	92,988	1,390	114,772	1,296	112,140
	Total	1,102	51,081	1,199	52,619	1,566	100,224	1,493	123,603	1,419	123,210

Transfertat e tjera tek individët . Për vitin 2021 janë planifikuar rimbursimi i tarifave vjetore të shkollimit që i kanë paguar studentët, ndërkohë që përfitojnë sipas vendimarrjes së Bordit të



Administrimit në zbatim të VKM-s për këtë qëllim. Fondi i transfertave i çelur plan thesari është 10,000 mijë lekë. Ky zë shpenzimi është realizuar 70.5%. Janë paguar kryesisht: Rimbursim tarifa shkollimi, raste fatkeqësie familjare, dalje në pension të punonjësve, sëmundje të rënda, pagesa të komisioneve add-hoc, rimbursim telefoni për titullarët (Rektor dhe Administrator), sipas VBA nr. 05, datë 21.02.2018 “Për shpenzimet e telefonisë celulare”.

Transferta tek individët deri 31.12.2021			
Nr.	Lloji i transfertës	Nr rasteve	Fondi 000 lekë
1	Rimbursim tarifa shkollimi	42	668
2	Fatkeqësi familjare	12	560
3	Sëmundje të rënda	1	50
4	Dalje në pension	11	1,045
5	Tjera transfertë	63	4,423
6	Rimbursim tel titullar	2	300
	TOTALI	131	7,046

➤ **Shpenzime për investime - artikulli 230/231.** Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen në formën e:

○ Grant konkurrues që janë fondet që përballohen nga buxheti i shtetit. Deri në këto momente nuk janë akorduar fonde. Nga Universiteti është dërguar për konkurrim 1 objekt, vlera totale e të cilit është **699,455** mijë lekë me bashkëfinancim në vlerën 210,000 mijë lekë nga të ardhurat e Universitetit, ndërsa për vitin 2021 fondi i planifikuar për konkurrim 173,272 mijë lekë nga të ardhurat. Për këtë objekt nuk është paraqitur plan thesari.

Është realizuar TVSH për projekte të huaja në vlerën 771 mijë lekë ose 100% të fondeve të parashikuara për financim, ndërsa është realizuar 100% të fondeve të akorduara (çelura në Degën e Thesarit)

○ Investimeve nga të ardhurat e vetë institucionit janë parashikuar në plan buxhetin e vitit 2021 me fond 363,921 mijë lekë dhe të çelura planthesari 220,637 mijë lekë. Këto investime ndahen në:

- **Studime e projektme, patenta, liçenca, softte kompjuterike – artikulli 230**

- Në studime e projektme për vitin 2021 janë parashikuar 2 objekt me vlerë 16,000 mijë lekë. Deri në periudhën e analizuar nuk është realizuar procedura e prokurimit dhe për këtë objekt shpenzimi nuk janë çelur fonde në degën e Thesarit.

- Në patenta, liçenca, softte kompjuterike gjatë vitit 2020 në preventivimin e parashikuar me objekt “Laboratorin i fonetikës së gjuhëve të huaja në FSHH” doli e nevojshme fondi me vlerë 2,000 mijë lekë. Deri në fund të vitit 2020 është realizuar procedura e prokurimit është faza e lidhjes së kontratës, për të cilën në fillim të vitit është depozituar në Degën e Thesarit obligimi në SIFQ me fond 1,680 mijë lekë e cila u përfshi në planbuxhetin e vitit 2021. Ky fond është realizuar 100% e parashikimit.

- **Investimet - Artikulli 231: Ndërtime të reja, rikonstruksion objekte ndërtimore, pajisje të ndryshme**

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për investime për: ndërtime e rikonstruksione objektivësh, blerje pajisje për auditorët e zyrat, blerje pajisje laboratorike për laboratorët mësimorë e shkencorë, krijim i fondit të librit në bibliotekë etje.

Projektet e investimeve të financuara paraqiten në tabelën “Investime viti 2021 - të ardhurat e institucionit” dhe janë realizuar 13.2% e planit të buxhetit vjetor ose 21% e planit të çelur për përdorim në degën e Thesarit.



Treguesit e realizimit të investimeve janë në nivele të ulëta pasi në investimet e planifikuara vetëm një objekt zë 46 % të investimeve. Objekti "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane - ish materniteti" nuk është realizuar, pasi nuk është konfirmuar miratimi i financimit të këtij objekti nga KZHR, si rezultat nuk janë realizuar procedurat e prokurimit për këtë objekt, për faktin se objekti dërgohet për prokurim për vlerën e plotë të preventivimit.

Investimet të planifikuara për vitin 2021 janë realizuar:

- Ndërtimet e reja janë realizuar 3.⁷⁷ %

Në grupin e ndërtimeve të reja është realizuar procedura me objekt "Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT" për të cilën është realizuar kontrata me subjektin fitues për vlerën 829 mijë lekë, si dhe kontrata me subjektin për "Mbikqyerje – Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT" për vlerën 15 mijë lekë. Objekti është përfunduar dhe financuar, ndërsa kontrata e kolaudimit nr. 788 prot datë 29.03.2021 me subjektin "DEA-N CONSULTING STUDIO" nuk është realizuar pasi nuk është prerë fatura me vlerë 1,920 lekë.

Objektet e tjera:

- Objekti "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti, nuk është realizuar, i planifikuar me bashkëfinancim nuk është realizuar, pasi nuk është miratuar.
- Objekti "Ndërtim – 'Shkallë emergjence godinat e UE'" është lidhur kontrata me subjektin fitues për vlerën 7,076 mijë lekë, "Mbikqyerje - Ndërtim – 'Shkallë emergjence godinat e UE'" është lidhur kontrata për vlerën 137 mijë lekë. Kontratat janë regjistruar në degën e Thesarit si obligime në SIFQ për vitin 2022.
- Objekti "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjekësore teknike - FSHMT" nuk është nisur procedura e prokurimit, pasi nuk është realizuar studim projekti, pasi procedura është në proces.

- Rikonstruksione janë realizuar 11.⁷¹ %

Në grupin e rikonstruksioneve të objekteve ndërtimore është realizuar procedura me objekt "Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT" , i cili është financuar për vlerën 7,125 mijë lekë, është financuar kontrata për "Mbikqyerje – 'Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT'" për vlerën 122 mijë lekë. Objekti është përfunduar dhe financuar, ndërsa kontrata e kolaudimit nr. 789 prot datë 29.03.2021 me subjektin "DEA-N CONSULTING STUDIO" nuk është realizuar pasi nuk është prerë fatura me vlerë 16,780 lekë.

Objektet e tjera janë në proces prokurimi ose ponedurë saktësimi të dhënave të preventivuar.

- Pajisjet profesionale (laboratorike) janë realizuar 25.⁰⁹ %

Në grupin e pajisjeve profesionale (laboratorike) për vitin 2021 u planifikuan tre laboratorë; Laboratorin i fonetikës së gjuhëve të huaja në FSHH, Laboratori i mamisë në FSHMT, Laboratori infermierisë së përgjithshme në FSHMT. Laboratorin i fonetikës së gjuhëve të huaja në FSHH u realizua gjatë vitit 2020. Një pjesë e pajisjeve është realizuar gjatë vitit 2020, ndërsa për pajisjet kompjuterike dhe soffte-t u realizuan në vitin 2021.

- Pajisjet (inventar ekonomik) janë realizuar 69.⁹⁵ %.

Në grupin e pajisjeve (inventar ekonomik) janë ; Pajisje kompjuterike e fotokopje me vlerë 25,100 mijë lekë, Pajisje e orendi për auditore laboratore e zyra me vlerë 5,837 mijë lekë, Pajisje pune me vlerë 62 mijë lekë.



Pajisjeve kompjuterike që i përkasin projektit të huaj "VALEU-X,-Shkëmbimi Virtual i Universiteteve Evropiane dhe Shqiptare" që u realizua me vlerë 5,042 mijë lekë dhe likuiduar në vitin 2020, u rimbursua gjatë vitit 2021, pasi u disbursua nga donatori.

Fond libri biblioteka është lidhur kontrata gjatë vitit 2020 me vlerë 1,101 mijë lekë e regjistruar në Degën e Thesarit si obligime në SIFQ u realizua vitin 2021

Objektet e tjera janë në proces prokurimi, ose realizimi të kontratave të lidhura. Më e detajuar paraqiten të dhënat në tabelën: "Investime viti 2021 - të ardhurat e institucionit"

➤ **Fondi për kërkimin shkencor.**Në Buxhetin e Univesitetit për kërkimin shkencor për vitin 2021 janë parashikuar në Planbuxhetin e ndryshuar 80,468 mijë lekë dhe është çelur fondi prej 52,348 mijë lekë nga:

- Granti konkurrues për kërkim shkencor nga Buxheti i Shtetit në vlerën 35,246 mijë lekë.
- Fondet për kërkimin shkencor nga të ardhurat e institucionit 17,102 mijë lekë.

✓ Projektet e kërkimit shkencor nga Buxheti i Shtetit. Nga AKKSHI me Vendim të Bordit të tij në vitin 2019 është miratuar projekti "Krijimi i Labororit Digital të Anatomisë" me vlerë 14,850 mijë lekë, i cili u financua pjesërisht në vitin 2020 në vlerën 10,576 mijë lekë dhe vlera 4,274 mijë lekë ose 27.8 % e vleres së projektit të miratuar u financua në vitin 2021.

Projekte Kërkimi shkencor - UE Buxheti						
Nr.	Emërtimi i projektit	Financimi 000/ lekë				
		AKKSHI	Viti 2020	Viti 2021	Realizimi	Artik
1	Krijimi i Labororit Digital të Anatomisë	14,850	10,576	4,274	100.00	231
	Shuma	14,850	10,576	4,274	100.00	

Në AKKSHI (Granti konkurrues i kërkimit shkencor - Buxheti i Shtetit) janë dërguar 10 projekte të ndryshme me vlerë gjithësej 73,354 mijë lekë, nga e cila: Buxheti i shtetit (AKKSHI) vlera 58,116 mijë lekë; të ardhurat e Universitetit vlera 15,238 mijë lekë.

Projekte Kërkimi shkencor viti 2021 - për konkurrim 000/Lekë					
Nr	Emërtimi i projektit	Gjithsej	AKKSHI	UE	Njesia
1	"Mësimdhënia në periudhë pandemie: Zhvillimi i Kapaciteteve Studentore (cikli i dytë i studimeve, Master) gjatë një procesi arsimor të alternuar fizik e në distancë" - Dr. Lenida Lekli	1,264	1,264	0	FSHH
2	"Hulumtimi i ndryshimit të modeleve të punësimit (fuqisë punëtore) gjatë dhe pas pandemisë së COVID 19 në qarkun Elbasan" - Prof.As. Imelda Sejdini	1,933	1,875	58	FE
3	"Oferta aktuale akademike përkunder kërkesave të bizneseve mbi aftësitë dhe kompetencat e burimeve njerëzore." - Prof.As. Elvira Fetahu	985	985	0	FE
Nr	Emërtimi i projektit	Gjithsej	AKKSHI	UE	Njesia
4	"Ndikimi i COVID-19 në organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor; implementimi i një modeli epidemiologjik-matematikor" - Dr. Elona Gaxhja	1,790	1,790	0	FHMT
5	"Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" - Prof. as. Dr. Peçi naqellari	47,892	32,841	15,052	UE
6	"Një Vlerësim Numerik i Bashkëjetesës Fetare dhe Veprimtarisë së Komuniteteve Fetare në Biznes : Rasti studimor i Shqipërisë" - Dr. Ardita Todri	1,901	1,832	69	FE
7	"Veprat Penale lidhur me Covid-19" - Prof. as. Dr. Rezarta Tahiraj	1,754	1,694	60	FE
8	"Studimi i aktivitetit anti-tumor të ekstrakteve të bimëve mjekësore në Shqipëri dhe në Rajonin e Pulias, Itali." - Prof.As.Dr. Peçi Naqellari	3,625	3,625	0	UE
9	"Matja e temperaturës së trupit: krahasimi i teknikave më të përdorura në moshat pediatrike në Shqipëri dhe Itali" - Prof.As.Dr. Shkëlqim Hidri	2,210	2,210	0	FSHMT
10	"Studimi mbi të miturit në vështirësi - migrimi dhe emigrimi i tyre." - Prof.As.Dr. Elisabeta Osmanaj	10,000	10,000	0	FSHMT
	Shuma	73,354	58,116	15,238	

AKKSHI për vitin 2021 ka miratuar 4 projekte për mbështetjen kërkimore me vlerë 5,914 mijë lekë dhe 1 projekt për zhvillimin e infrastrukturës kërkimore me vlerë 25, 000 mijë lekë (Vendim të bordit të tij nr. 1, datë 01.10.2021 "Për miratimin e financimit të projekteve



fituese të infrastrukturës së kërkimit shkencor për vitin 2021”); Gjithsej vlera 30,914 mijë lekë, si më poshtë.

Projekte Kërkimi shkencor viti 2021 - ndryshim 14.10.2021- Buxheti 000/Lekë							
Nr.	Emërtimi i projektit	Gjithsej	Artikulli financiar				Njësia
			230	231	602	606	
1	"Mësimdhënia në periudhë pandemie: Zhvillimi i Kapaciteteve Studentore (cikli i dytë i studimeve, Master) gjatë një procesi arsimor të alternuar fizik e në distancë" - Dr. Lenida Lekli	1,264	0	0	228	1,036	FSHH
2	"Hulumtimi i ndryshimit të modeleve të punësimit (fuqisë punëtore) gjatë dhe pas pandemisë së COVID 19 në qarkun Elbasan" - Prof.As. Imelda Sejdi	1,875	0	0	411	1,464	FE
3	"Oferta aktuale akademike përkunder kërkesave të bizneseve mbi aftësitë dhe kompetencat e burimeve njerëzore." - Prof.As. Elvira Fetahu	985	0	0	120	865	FE
4	"Ndikimi i COVID-19 në organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor; implementimi i një modeli epidemiologjik-matematikor" - Dr. Elona Gaxhja	1,790	0	0	250	1,540	FHMT
5	"Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" - Prof. as. Dr. Peçi Naqellari	25,000	25,000	0	0	0	UE
		0	0	0		0	
	Shuma	30,914	25,000	0	1,009	4,905	

Fondi për kërkimin shkencor nga AKKSHI është çelur planthesari vlera 30,914 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 526 mijë lekë ose 1.7%. Realizimi është në këto shifra pasi projektet janë miratuar dhe fondi për këto projekte është çelur në fund të tetorit 2021, ndërkohë që sipas grafikut të paraqitur është punuar në katër projekte për mbështetjen kërkimore. Projekti për zhvillimin e infrastrukturës kërkimore, nuk u mundësua lidhja e kontratës për shkak të anulimit të procedurës së prokurimit të pajisjeve të projektit.

Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani" më datë 16.11.2021 ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik për të realizuar projektin me objekt: "Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare ne Universiteti e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Për arsye të moslidhjes së kontratës me asnjë operator ekonomik pjesëmarrës në tender pasi nuk rezultuan fitues, Universiteti i Elbasanit bëri anulimin e procedurës së prokurimit me datë 26.11.2021. Rishpallja e procedurës për prokurim nga Universiteti, bazuar në procedurat e prokurimit publik kërkon afat ligjor nga 45 deri në 60 ditë për zhvillimin dhe realizimin e saj. Gjithashtu Dega e Thesarit nuk konfirmonte hedhjen e procedurës gjatë kësaj periudhe.

Për këtë shkak të moslidhjes së kontratës me asnjë operator ekonomik ky projekt nuk mund të zhvillojë dhe realizohet brenda viti 2021.

- ✓ Projektet e kërkimit shkencor me të ardhurat e institucionit. Fondi për kërkimin shkencor me të ardhurat e institucionit është planifikuar në vlerën 49,554 mijë lekë, është çelur planthesari vlera 17,102 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 10,475 mijë lekë ose 21.1% e plan buxhetit të vitit 2021 ose 66.5% e fondeve të çelura në Degën e Thesarit. Në planbuxhetin fillestar të vitit 2021 u paraqitën 53 draftprojekte kërkimore e konferenca. Me rialokimin e buxhetit në tetor 2021 u miratuan në projekte të konsoliduara për tu realizuar. Nga këto projekte gjatë kësaj periudhe u realizuan 6 prej tyre, të cilët janë përfunduar ose janë në vijimësi për vitin 2022.



➤ **Projektet e Huaja.** Universiteti për vitin 2021 ka 8 projekte të huaja. Nga projektet e huaja në bankën e nivelit të dytë janë gjendje 9,215 mijë lekë. Për periudhën Janar-Dhjetor 2021 janë disbursuar 50,731 Euro ose 6,256 mijë lekë. Gjatë kësaj periudhe janë shpenzuar 8,400 mijë lekë ose 47.7 % të fondeve: për investime vlera 3,857 mijë lekë dhe shpenzime korente vlera 4,544 mijë lekë. Situata e projekteve:

- Projekti “Profesionet e sportit – Shkollimi, Punësimi, Zhvillimi në Rajonin e Ballkanit” ka përfunduar, është me gjendje monetare në bankë me 7,345 Euro ose 668 mijë lekë. Për gjendjen e mbetur, pritet konfirmim nga donatori për të vepruar. Ky fond mund të rikthehet tek donatori.
- Projekti “TEA VET-Zhvillimi kompetencave të mësimdhënies në Shqipëri” ka përfunduar në vitin 2020. Gjatë vitit 2021 janë disbursuar 2,439 Euro ose 296 mijë lekë. Janë kryer shpenzime korente 423 mijë lekë. Ky projekt ka në fund të periudhës vlerën 0 lekë .
- Projekti “T@SK - Drejt ngritjes së ndërgjegjësimit, përgjegjësisë dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale” ka përfunduar në vitin 2020. Gjatë kësaj periudhe janë kryer shpenzime korente në vlerën 552 mijë lekë. Ky projekt ka në fund të periudhës vlerën 2,530 mijë lekë, të cilat duhet t’i kthehen donatorit.
- Projekti “E-VIVA-Përmirësimi dhe vlerësimi i kompetencave të lidhura me shërbime në mjedis të ndryshme të të mësuarit në Universitetet e Ballkanit Perëndimor” përfundon në vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe janë kryer shpenzime korente në vlerën 769 mijë lekë. Ky projekt ka në fund të periudhës vlerën 1,321 mijë lekë .
- Projekti “BEKSTONE-Platforma e sipërmarrjeve të Arsimit të lartë për nxitjen, modernizimin dhe rritjen e qëndrueshme në industrinë e gurit natyror në vendet e Ballkanit Perëndimor” ka filluar në vitin 2020 dhe përfundon në vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe janë kryer shpenzime për investime 3,856 mijë lekë dhe shpenzime korente 534 mijë lekë. Ky projekt ka në fund të periudhës vlerën 128 mijë lekë .
- Projekti “VALEU-X,-Shkëmbimi Virtual i Universiteteve Evropiane dhe Shqiptare” ka filluar në vitin 2020 dhe përfundon në vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe janë kryer shpenzime operative në vlerën 812 mijë lekë. Ky projekt ka në fund të periudhës vlerën 52 mijë lekë .
- Projekti “EEAABAC - Zgjerimi i BE-së dhe sfidat e përafrimit të legjislacionit, sfidat e Shqipërisë” ka filluar në vitin 2021 dhe përfundon në vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe janë disbursuar 32,334 mijë lekë ose 4,000 mijë lekë, të cilat ishin gjendje në degën e Thesarit, pasi disbursimi i tyre u krye nëpërmjet bankës së nivelit të dytë nga donatori në fund të dhjetorit të vitit 2020. Nuk janë kryer shpenzime gjatë vitit 2021. Ky projekt ka në fund të periudhës vlerën 4,000 mijë lekë.
- Projekti “EntrAL - Aftësitë sipërmarrëse për një edukim modern në Shqipëri” ka filluar në vitin 2021 dhe përfundon në vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe janë disbursuar 15,958 Euro ose 1,960 mijë lekë dhe janë kryer shpenzime korente në vlerën 1,445 mijë lekë. Ky projekt ka në fund të periudhës vlerën 515 mijë lekë.

		Projektet me financim të huaj vitet 2016-2021				000/lekë		
Nr.	Emërtimi i projektit	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Shuma
		Vlera	Vlera	Vlera	Vlera	Vlera	Vlera	Vlera
1	Shpenzime korente	8,487	2,970	6,107	5,947	4,728	4,544	32,783
2	shpenzime Pajisje	5,643	0	0	8,329	6,885	3,856	24,713
	Shuma	14,130	2,970	6,107	14,276	11,613	8,400	57,497



Realizimi i planbuxhetit për vitin 2021

000/Lekë

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Financim i brendshëm			Granti			Të ardhura				Total Buxheti		
			Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%	Plan Buxheti	Plani Thesari	Fakt	%	Plani	Fakt	%
1	Paga e shperblime	600	0	0	0.0	692,626	440,344	63.6	25,078	25,078	0	0.0	717,703	440,344	61.4
-	Pagat	600	0	0	0.0	593,485	354,819	59.8	25,078	25,078	0	0.0	618,563	354,819	57.4
-	Honorare - oret	600	0	0	0.0	99,140	85,525	86.3	0	0	0	0.0	99,140	85,525	86.3
2	Sig. Shoqërore	601	0	0	0.0	70,549	63,530	90.1	4,876	4,876	0	0.0	75,426	63,530	84.2
3	Shpenzime operative	602	0	0	0.0	157,518	107,452	68.2	21,526	21,526	1,593	7.4	179,044	109,044	60.9
4	Transf. me jashtë	605	0	0	0.0	0	0	0.0	900	900	166	18.5	900	166	18.5
5	Transf. individet	606	0	0	0.0	0	0	0.0	18,750	10,000	7,046	70.5	10,000	7,046	70.5
6	Bursa	606	0	0	0.0	126,605	123,280	97.4	0	0	0	0.0	126,605	123,280	97.4
7	Kërkimi shkencor	0	35,188	4,800	13.6	0	0	0.0	49,554	15,751	10,475	66.5	50,940	15,275	30.0
-	Kërkimi shkencor	230	0	0	0.0	0	0	0.0	7,841	0	0	0.0	0	0	0.0
-	Kërkimi shkencor	231	35,188	4,800	13.6	0	0	0.0	15,262	0	0	0.0	35,188	4,800	13.6
-	Kërkimi shkencor	602	0	0	0.0	0	0	0.0	21,350	12,000	10,475	87.3	12,000	10,475	87.3
-	Kërkimi shkencor	606	0	0	0.0	0	0	0.0	5,102	3,751	0	0.0	3,751	0	0.0
8	Investime	0	771	771	100.0	0	0	0.0	363,901	220,637	47,696	21.6	221,408	48,467	21.9
a	Stud. Projekt.	230	0	0	0.0	0	0	0.0	17,680	1,680	1,680	100.0	1,680	1,680	100.0
b	Investime trupëz.	231	771	771	100.0	0	0	0.0	346,221	218,957	46,016	21.0	219,728	46,787	21.3
-	Ndërtime të reja	231	0	0	0.0	0	0	0.0	215,330	98,287	0	0.0	98,287	0	0.0
-	Rikonstruksione	231	0	0	0.0	0	0	0.0	62,001	62,001	8,146	13.1	62,001	8,146	13.1
-	Instalime rrjete	231	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0	0.0	0	0	0.0
-	Makineri teknologjike	231	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0	0.0	0	0	0.0
-	Paisje profesionale	231	0	0	0.0	0	0	0.0	23,000	23,000	5,770	25.1	23,000	5,770	25.1
-	Paisje inventari	231	0	0	0.0	0	0	0.0	45,890	35,670	32,100	90.0	35,670	32,100	90.0
-	TVSH projekte pajisje	231	771	771	100.0	0	0	0.0	0	0	0	0.0	771	771	100.0
-	Mjete transporti	231	0	0	0.0	0	0	0.0	0	0	0	0.0	0	0	0.0
9	Projekti huaja	0	17,615	8,400	47.7	0	0	0.0	4,000	1,351	1,351	100.0	18,966	9,751	51.4
-	Grante korente	604	11,074	4,544	41.0	0	0	0.0	4,000	1,351	1,351	100.0	12,425	5,894	47.4
-	Investime	231	6,541	3,856	59.0	0	0	0.0	0	0	0	0.0	6,541	3,856	59.0
	Totali		53,575	13,971	26.1	1,047,297	734,605	70.1	488,585	300,119	68,326	22.8	1,400,991	816,903	58.3



Projekte huaja UE viti 2021 - Realizimi

Nr.	Emërtimi i projektit	Viti i		Statusi	Financimi lekë							
		Fillimi t	Mbarimi t		Gjendja në bankë 01.01.2021	Disbursuar		Total në Lekë	Shpenzimet e realizuara (në lekë)			Gjendje në bankë 31.12.2021
						EURO	Lekë		Shpenzime korente	Shpenzime kapitale	Total	
1	Profesionet e sportit – Shkollimi, Punësimi, Zhvillimi në Rajonin e Ballkanit	2013	2016	Ka përfunduar , nuk është mbyllur	676	0	0	676	7	0	7	668
2	TEA VET-Zhvillimi kompetencave të mësimdhënies në Shqipëri	2017	2020	Në vazhdim	127	2,439	296	423	423	0	423	0
3	T@SK - Drejt ngritjes së ndërgjegjësimit, përgjegjësive dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale	2017	2020	Në vazhdim	3,082	0	0	3,082	552	0	552	2,530
4	E-VIVA-Përmirësimi dhe vlerësimi i kompetencave të lidhura me shërbime në mjedise të ndryshme të të mësuarit në Universitetet e Ballkanit Perëndimor	2019	2021	Në vazhdim	2,090	0	0	2,090	769	0	769	1,321
5	BEKSTONE-Platforma e sipërmarrjeve të Arsimit të lartë për nxitjen, modernizimin dhe rritjen e qëndrueshme në industrinë e gurit natyror në vendet e Ballkanit Perëndimor	2020	2022	Në vazhdim	4,519	0	0	4,519	534	3,856	4,391	128
6	VALEU-X,-Shkëmbimi Virtual i Universiteteve Evropiane dhe Shqiptare	2020	2022	Fillon	865	0	0	865	812	0	812	52
7	EAAABAC - Zgjerimi i BE-së dhe sfidat e përafritimit të legjislacionit, sfidat e Shqipërisë	2021	2022	Fillon	0	32,334	4,000	4,000	0	0	0	4,000
8	EntrAL - Aftësitë sipërmarrëse për një edukim modern në Shqipëri	2021	2023	Fillon	0	15,958	1,960	1,960	1,445	0	1,445	515
	Shuma				11,359	50,731	6,256	17,615	4,544	3,856	8,400	9,215



Projekte Kërkimi shkencor viti 2021 - Realizimi

000/Lekë

Nr	Emërtimi i projektit	Gjithsej			AKKSHI			UE			Njesia
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Njesia
1	"Mësimdhënia në periudhë pandemie: Zhvillimi i Kapaciteteve Studentore (cikli i dytë i studimeve, Master) gjatë një procesi arsimor të alternuar fizik e në distancë" - Dr. Lenida Lekli	1,264	88	6.9	1,264	88	6.9	0	0	0.0	FSHH
2	"Hulumtimi i ndryshimit të modeleve të punësimit (fuqisë punëtore) gjatë dhe pas pandemisë së COVID 19 në qarkun Elbasan" - Prof.As. Imelda Sejdini	1,933	141	7.3	1,875	141	7.5	58	0	0.0	FE
3	"Oferta aktuale akademike përkunder kërkesave të bizneseve mbi aftësitë dhe kompetencat e burimeve njerëzore." - Prof.As. Elvira Fetahu	985	89	9.1	985	89	9.1	0	0	0.0	FE
4	"Ndikimi i COVID-19 në organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor; implementimi i një modeli epidemiologjik-matematikor" - Dr. Elona Gaxhja	1,790	208	11.6	1,790	208	11.6	0	0	0.0	FHM T
5	"Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"" - Prof. as. Dr. Peçi naqellari	47,892	0	0.0	25,000	0	0.0	22,892	0	0.0	UE
6	"Thellime në biznes financë dhe ligj" - Konferenca e 9-të Ndërkombëtare - Prof. As. Dr. Imelda Sejdini	600	314	52.3	0	0	0.0	600	314	52.3	FE
7	"Veprat penale lidhur me COVID-19" - Prof.As. Rezarta Tahiraj	250	0	0.0	0	0	0.0	250	0	0.0	FE
8	"Musa Vyshka-një zë i spikatur në poezinë e sotme shqipe" - Prof. As. Dr. Teuta Toska	354	0	0.0	0	0	0.0	354	0	0.0	FSHH
9	"Matja e temperaturës së trupit: krahasimi i teknikave më të përdorura në moshat pediatrike në Shqipëri dhe Itali"- Prof.As.Dr. Shkëlqim Hidri	2,210	0	0.0	0	0	0.0	2,210	0	0.0	FSH MT
10	"Konferenca e II-të ndërkombëtare në Logopedi dhe Fizioterapi" - Dr. Jonida Mustafaraj	700	561	80.1	0	0	0.0	700	561	80.1	FSH MT
11	Ndërtimi i Database-s së Universitetit për menaxhimin e të dhënave - mirembajtje	12,000	9,034	75.3	0	0	0.0	12,000	9,034	75.3	UE
12	"Konferencë Ndërkombëtare studentore për shkencën e hapur dhe ndërkombëtarizimin." - Prof.As. Elvira Fetahu	1,200	163	13.6	0	0	0.0	1,200	163	13.6	UE
13	Konferenca Ndërkombëtare mbi "Shkencën dhe Edukimin Sportiv; Roli i tyre në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mirëqenies sociale" - Prof. As. Dr. Edmond Biçoku	300	146	48.7	0	0	0.0	300	146	48.7	FSHE
14	Konferenca Ndërkombëtare mbi "Arsimi në përballjen gjatë dhe pas pandemisë" - Prof. As. Dr. Elisabeta Osmanaj	480	258	53.7	0	0	0.0	480	258	53.7	FSHE
15	Kërkim shkencor - projekte te ndryshme	8,510	0	0.0	0	0	0.0	8,510	0	0.0	UE
	Shuma projekteve 2021	80,468	11,001	13.7	30,914	526	1.7	49,554	10,475	21.1	
1	Krijimi i Laboratorit Digital të Anatomisë	4,274	4,274	100.0	4,274	4,274	100.0	0	0	0.0	FSH MT
	Shuma projekteve nga 2020	4,274	4,274	100.0	4,274	4,274	100.0	0	0	0.0	
	Shuma projekteve	84,742	15,275	18.0	35,188	4,800	13.6	49,554	10,475	21.1	



Investime viti 2021 - të ardhurat e institucionit						
Nr.	Emërtimi i projektit	Fondi 000/ lekë				
		Plani	Fakti	%	Financuar 2021	Obligim 2022
I	Studime e projekte, patenta, liçenca, softte kompjuterike	17,680	1,680	9.50	1,680	0
a	Studime e projekte	16,000	0	0.00	0	0
1	Projekt + preventiv "Ndertim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti" - ndryshim projekti	4,000	0	0.00	0	0
2	Projekt + preventiv "Ndertim i godinës së Fakultetit të shkencave mjekësore teknike - FSHMT"	12,000	0	0.00	0	0
b	Patenta, liçenca, softte kompjuterike	1,680	1,680	100.00	1,680	0
1	Softte kompjuterike laboratorit	1,680	1,680	100.00	1,680	0
II	Ndërtime të reja	215,330	8,114	3.77	899	7,214
1	"Ndertim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti	167,275	0	0.00	0	0
2	Mbikqyrje "Ndertim i godinës së Fakultetit të shkencave humane" - ish materniteti	5,998	0	0.00	0	0
3	Kolaudim "Ndertim i godinës së Fakultetit të shkencave humane" - ish materniteti	0	0	0.00	0	0
4	"Ndertim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	885	885	100.00	885	0
5	Mbikqyrje - "Ndertim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	15	15	100.00	15	0
6	Kolaudim - "Ndertim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	2	2	94.81	0	2
7	Ndërtim - "Shkallë emergjence godinat e UE"	10,149	7,075	69.72	0	7,075
8	Mbikqyrje - "Shkallë emergjence godinat e UE"	186	137	73.77	0	137
9	Kolaudim - "Shkallë emergjence godinat e UE"	21	0	0.00	0	0
10	"Ndertim i godinës së Fakultetit të shkencave mjekësore teknike - FSHMT"	30,000	0	0.00	0	0
11	Mbikqyrje - "Ndertim i godinës së Fakultetit të shkencave mjekësore teknike - FSHMT"	800	0	0.00	0	0
12	Kolaudim - "Ndertim i godinës së Fakultetit të shkencave mjekësore teknike - FSHMT"	0	0	0.00	0	0
III	Rikonstruksione	62,001	7,263	11.71	7,247	17
1	Rikonstruksion - "Aspirim kondicionim Godina A , Korpusi Kryesor - fasada xhamit"	12,866	0	0.00	0	0
2	Mbikqyrje - "Aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor- fasada xhamit"	258	0	0.00	0	0
3	Kolaudim - "Aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor- fasada xhamit"	31	0	0.00	0	0
4	"Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	7,125	7,125	99.99	7,125	0
5	Mbikqyrje - "Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	122	122	100.00	122	0
6	Kolaudim - "Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	17	17	97.76	0	17
7	"Rikonstruksion laboratorit Kërkimor FSHN"	19,125	0	0.00	0	0
8	Mbikqyrje - "Rikonstruksion laboratorit Kërkimor FSHN"	330	0	0.00	0	0
9	Kolaudim - "Rikonstruksion laboratorit Kërkimor FSHN"	40	0	0.00	0	0
10	Rikonstruksion - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	21,648	0	0.00	0	0
11	Mbikqyrje - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	393	0	0.00	0	0
12	Kolaudim - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	47	0	0.00	0	0
IV	Pajisje inventar ekonomik	45,890	32,100	69.95	32,100	0
1	Pajisje kompjuterike/Software e fotokopje	35,670	25,100	70.37	25,100	0
2	Pajisje e orendi për auditore laboratore e zyra	7,000	5,837	83.38	5,837	0
3	Fond libri biblioteka	3,101	1,101	35.49	1,101	0
4	Pajisje pune	120	62	52.00	62	0
V	Pajisje profesionale	23,000	5,770	25.09	5,770	0
1	Pajisje laboratorike	23,000	5,770	25.09	5,770	0
2	Pajisje e audiovizive	0	0	0.00	0	0
	Shuma	363,901	54,927	15.09	47,696	7,231



2. Plan buxheti i vitit 2022

Hartimi i buxhetit të vitit 2022 është bazuar në projektet e paraqitura në periudhën e hartimit të p/buxhetit 2022-2024, në ndryshimet e ndodhura pas miratimit të tij; strukturën organizative, programet e studimit, numrin e studentëve të regjistruar në vijimësi, numrin e studentëve të padiplomuar, realizimit të planbuxhetit të mëparshëm, fondeve të trashëguara të papërdorura nga viti 2021, niveli i financimit nga Buxheti i Shtetit (Granti i mësimdhënies).

MASR me (Email), datë 05.01.2022 ka dërguar “Fondet e miratuara për vitin 2022” në vlerën **898,204 mijë lekë**, fonde të cilat janë detajuar për përdorim (për shlyerjen e detyrimeve: paga e detyrime tatimore të muajit dhjetor 2021) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (në Degën e Thesarit Elbasan), sipas VBA nr. 1, datë 05.01.2022 “Për detajimin e fondeve të miratuara për vitin 2022”. Në zbatim të akteve ligjore e n/ligjore për Buxhetin e Arsimit të Lartë Publik, janë organet drejtuese të tyre që ndajnë këto fonde të ngurtësuar për përdorim, për mësimdhënie e për bursa financiare. Këto grante nuk mund të përdoren për investime. Udhëzimi i përbashkët i MFE-së dhe MASR-s nr. 20, datë 20.09.2019 ”Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor”, përcakton se fondi i grantit të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, i papërdorur gjatë vitit buxhetor, mbartet në vitin buxhetor pasardhës. Sipas aktrakordimit me Degën e Thesarit Elbasan ky fond i papërdorur në vitin 2021 është në vlerën **318,137 mijë lekë** dhe është proceduar, sipas përcaktimeve në udhëzim për përdorimin e tij në vitin 2022. Sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit Elbasan fondi i papërdorur nga të ardhurat e çelura për përdorim në vitin 2021 dhe grumbullimi i tyre gjatë këtij viti por i trashëguar është në vlerën **231,793 mijë lekë** dhe është proceduar, sipas përcaktimeve në udhëzim për përdorimin e tyre në vitin 2022. Gjatë vitit 2022 është parashikuar të grumbullohen të ardhura në vlerën **180,000 mijë lekë**. Projektet e huaja janë me gjendje bankare në bankën e nivelit të dytë në vlerën **9,215 mijë lekë** dhe parashikohet të disbursohen gjatë vitit në vlerën **14,845 mijë lekë**. Tërësia e financimeve dhe përdorimi i tyre për mbarëvajtjen e aktivitetit për të cilin funksionon Universiteti, përbën buxhetin e vitit 2022 në vlerën **1,652,540 mijë lekë**. Buxheti paraqetet në mënyrë analitike si më poshtë:

Fonde të mbartura, financimet, Granti dhe të ardhurat për vitin 2022 – Plani				000/lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2021	Financimi i vitit 2022	Buxheti viti 2022
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	318,137	898,548	1,216,686
1.1	Granti mësimdhënies	309,367	756,454	1,065,821
1.2	Granti i bursave të studentëve cikli parë	3,325	141,750	145,075
1.3	Granti Konkurrues	0	0	0
1.4	Granti Kërkimit shkencor	5,446	0	5,446
1.5	TVSH- Projekte të huaja	0	344	344
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	9,215	14,845	24,060
2.1	Disbursime të huaja për shpenzime korente	9,215	13,123	22,338
2.2	Disbursime të huaja për investime	0	1,722	1,722
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	231,793	180,000	411,793
3.1	Të ardhura për shpenzime korente	53,576	15,962	69,538
3.2	Të ardhura për investime	172,941	76,722	249,663
3.3	Të ardhura për kërkim shkencor	5,276	87,316	92,593
TOTALI		559,146	1,093,394	1,652,540

Ky buxhet përbëhet nga:

- ◇ Fonde të mbartura nga viti 2021 prej **559,146** mijë lekë, të disponueshme në Degën e Thesarit dhe në Bankën e Nivelit të Dytë (projektet me financim të huaj), të cilat përfshijnë:

- fondin e mbartur të financuar nga Buxheti i Shtetit prej 318,137 mijë lekë;
 - të ardhurat e trashëguara të institucionit prej 231,793 mijë lekë; të autorizuar për përdorim gjatë vitit në artikuj të ndryshëm buxhetor e të papërdorura prej 91,214 mijë lekë, të grumbulluara gjatë vitit 2021 dhe të paautorizuara për përdorim prej 140,579 mijë lekë;
 - gjendjen në fund të vitit në bankën e nivelit të dytë të disbursimit nga projektet me financim prej 9,215 mijë lekë (*mbartja e fondeve nga viti paraadhës në vitin korent, bazohet në aktet e cituara më lart*).
- ◇ Fonde të vitit 2022 prej 1,093,394 mijë lekë, të cilat përfshijnë
- financimin nga Buxheti i Shtetit i fondeve të miratuara dhe financimeve për vitin 2022 prej 898,548 mijë lekë; fondet e miratuara në vlerën 898,204 mijë lekë, financimi i TVSH-së projekteve me financim të huaj në vlerën 344 mijë lekë.
 - parashikimin e disbursimit nga projektet me financim të huaj prej 14,845 mijë lekë;
 - të ardhurat e parashikuara për tu grumbulluar të institucionit prej 180,000 mijë lekë.

2.1. Hyrjet e planifikuara të fondeve për vitin 2022. Në hyrjet e fondeve për Universitetin bëjnë pjesë:

- **Financimi nga Buxheti i Shtetit.** Financimi nga Buxheti i Shtetit, bazuar në aktet për financimin e Arsimit të Lartë është 1,216,686 mijë lekë :
 - ◇ Granti për mësimdhënie në ciklin e parë të studimeve, në fillim të vitit në vlerë totale 1,065,821 mijë lekë, përbën fondet e vitit 2022
 - ◇ Granti i bursave të studentëve cikli parë në vlerën 145,075 mijë lekë
 - ◇ Granti Konkurrues nuk ka financime.
 - ◇ Granti nga Buxheti i Shtetit për kërkimin shkencor në vlerën 5,446 mijë lekë.
 - ◇ TVSH projekte me financim të huaj në vlerën 344 mijë lekë.
- **Disbursimet nga projektet me financim të huaj.** Financimi i projekteve të huaja në formën e disbursimeve kryhet në bazë të ratifikimit të marrëveshjeve nga Parlamenti apo Qeveria Shqiptare me institucionet Ndërkombëtare e kryesisht Bashkimin Evropian. Për IAL në Republikën e Shqipërisë, këto projekte janë kryesisht kërkimore shkencore apo bashkëpunimi akademik me universitetet e huaja. Aplikimet për projekte, në kuadër të këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit me donatorë të huaj, kryhet nga njësitë bazë (departamentet) të Universitetit dhe koordinimi me donatorin është i drejtpërdrejtë. Ky aspekt monitorohet dhe ndiqet nga MFE nëpërmjet njësisë kryesore të Universitetit, në zbatim ta akteve nënligjore për këtë qëllim. Disbursimi i fondeve bëhet në formë direkte në një llogari speciale në Bankën e Shqipërisë, e cila të autorizon kryerjen e veprimeve në një bankë të nivelit të dytë, ose të disbursimit indirekt duke mbuluar shpenzime të ndryshme për investime në pajisje, të mbulimit të shpenzimeve të mobiliteteve të stafit akademik apo studentëve. Financimi i disbursimeve të huaja për vitin 2022 është në vlerën **24,060 mijë lekë** gjithsej, i përbërë nga fonde të mbartura gjendje në bankë nga viti 2021 në vlerën 9,215 mijë lekë si edhe disbursimet e parashikuara gjatë vitit 2022 në vlerën 14,845 mijë lekë për këto forma shpenzimi:
 - ◇ Disbursimi për shpenzime korente për të mbuluar pagat e stafit trajnues, shpenzime operative për kosto udhëtimi e qëndrimi jashtë vendit, bursat për studentët në universitete të huaja etje, me vlerë 22,338 mijë lekë
 - ◇ Disbursimi për investime në pajisje të ndryshme të planifikuara në kuadër të misionit të projektit me vlerë 1,722 mijë lekë
- **Të ardhura të institucionit.** Fondet të kushtëzuar - të ardhurat e institucionit arkëtohen në bazë të akteve ligjore mbi të cilat është marrë vendim nga Bordi i Administrimit për tarifatat e shkollimit dhe tarifave të tjera që arkëtohen nga studentët e shërbime ndaj të tretëve. Këto të

ardhura përdoren për financime të aktivitetit akademik, kërkimor e zhvillimin infrastrukturës së universitetit . Të ardhurat e institucionit për vitin 2022 janë 411,793 mijë lekë lekë, nga të cilat, sipas kohës së arkëtimit janë:

- Të ardhurat e grumbulluara e të papërdorura për vitin 2021 në vlerën 231,793mijë lekë
- Të ardhurat e parashikuara për vitin 2022 në vlerën 180,000 mijë lekë

Të ardhurat e institucionit për vitin 2022, sipas përdorimit në aktivitetin akademik janë:

- Të ardhura për shpenzime korente prej 69,538 mijë lekë, përbëhen nga; fondi i mbartur nga viti 2021 në vlerën 53,576 mijë lekë, financimi nga të ardhurat e vitit 2022 në vlerën 15,962 mijë lekë.
- Të ardhura për investime prej 249,663 mijë lekë, përbëhen nga; fondi i mbartur nga viti 2021 në vlerën 172,941 mijë lekë, financimi nga të ardhurat e vitit 2022 në vlerën 76,722 mijë lekë.
- Të ardhura për kërkim shkencor prej 92,593 mijë lekë, përbëhen nga; fondi i mbartur nga viti 2021 në vlerën 5,276 mijë lekë, financimi nga të ardhurat e vitit 2022 në vlerën 87,316 mijë lekë.

Në tabelë paraqiten më të detajuara të ardhurat, sipas burimeve të krijimit dhe detajimit të përdorimit të tyre me grupime të formës së shpenzimeve.


Të ardhurat e vetë institucionit për vitin 2022 - Plani			000/lekë		
Krijimi			Shpërndarja		
Nr.	Emërtimi	Lekë	Emërtimi	Lekë	
1	Qira	350	A. Përdorimi	Studime e projekte-230	16,000
2	Programe profesionale	10,649		Patenta, softte kompjuterike-230	2,000
3	Bachelor	47,454		Investime trupëzuara-231	231,663
4	DIND	2,520		Paga e shperblime-600	25,078
5	Master profesional	47,929		Sig. Shoqërore-601	4,876
6	Master i shkencave	54,046		Shpenzime operative-602	19,933
7	Trajnim mësuës	500		Transf. me jashtë-605	900
8	Doktoraturë	0		Transf. individet-606	18,750
9	Libreza Diploma etj.	3,721		Kërkimi shkencor-230	19,251
10	Lëshim dokumenti	4,000		Kërkimi shkencor-231	15,672
11	Taksë regjistrimi	4,831		Kërkimi shkencor-602	53,918
12	Tarifa konkurrimi	500		Kërkimi shkencor-606	3,751
13	Tjera - shërbime	2,000			
14	Pjesm. konferenca	1,000			
15	Sponsorizime	500			
a-	Të ardhurat e vitit 2021	180,000	Totali		411,793
b-	Trashëguar nga viti 2020	231,793	B. Pa përdorur	0	
			C. Trashëgohen	0	
	TOTALI	411,793	D. Nga totali, derdhen në Buxhet	35	

Në planifikimin e grumbullimit të ardhurave janë marrë; të dhënat mbi numrin e studentëve, tarifat e shkollimit, sipas niveleve të studimit për vitin akademik 2021-2022. Gjithashtu ndikojnë:

- ◇ Paga për kreditet e mbartura të studentëve që kanë përfunduar vitet e përcaktuara të programit të studimit, por nuk janë diplomuar, kryesisht studentët që kanë përfunduar; vitin e dytë në programet profesionale dy-vjeçare, vitin e tretë në programet e Ciklit të parë Bachelor, vitet përkatëse të studimit në Ciklit të dytë.
- ◇ Shpërndarja librezave e diplomave.
- ◇ Tarifa e regjistrimit të studentëve të parashikuar për regjistrim në vitin akademik 2021 – 2022



- ◇ Tarifa konkurrimi të parashikuar për vitin akademik 2021 – 2022
- ◇ Të ardhurat nga dhënia me qira e objekteve (janë parashikuar për 2 mjedise, një Bar kafe, pa tregtim pije alkoolike dhe një Librari Universitare, si dhe pagesat për mjediset që përdoren për kurset e gjuhëve të huaja, të cilat kryhen nga shoqata të licensuara.)
- ◇ Të tjera të ardhura (shërbime laboratorit, vërtetime diplomimi, certifikatë notash etj.)





Sipas peshën kryesore të të ardhurave të institucionit e zënë të ardhurat nga:

- Tarifat e shkollimit 90.2 %,
- Të ardhura nga shërbimet 6.0 %,
- Tarifa regjistrimi 2.7 %
- Tarifa konkurrimi 0.3 %
- Qira 0.2 %

Përdorimi i të ardhurave është detajuar në total me grup shpenzimesh:

- Investime në infrastrukturë e pajisje në masën 56.3 %
- Studime e projektme në masën 3.9 %
- Patenta, softte kompjuterik në masën 0.5 %
- Paga në masën 6.1 %
- Sigurime shoqërore në masën 1.2 %
- Shpenzime operative në masën 4.8 %
- Transferta tek individë; rimnbusim tarifa të paguara nga studentët, dalje në pension, shpërblim raste fatkeqësie etje në masën 1.3 %
- Transferta me jashtë në masën 0.2 %
- Kërkim shkencor në masën 22.5 %
 - Kërkim shkencor (art. 230) në masën 4.7 %
 - Kërkim shkencor (art. 231) në masën 3.8 %
 - Kërkim shkencor (art. 602) në masën 13.1 %



- Kërkim shkencor (art. 606) në masën 0.2 %

Në krahasim me realizimin e vitit 2021 të ardhurat e planifikuara janë në rritje, ndërsa me parashikimin në P/Buxhetin afatmesëm të vitit 2022 – 2024 të ardhurat janë në ulje me 25.5 % e planifikimit të vitit 2022. Ulja vjen si rezultat:

- ◇ Reduktimi i tarifave të shkollimit ose heqja e pagesës së tyre, nga zbatimi i VKM – ve për këtë qëllim.
- ◇ Ulja e numrit të studentëve në disa programe studimi.
- ◇ Në ciklin parë e të dytë të studimit për vitin e parë nuk janë hapur disa programe studimi, pasi nuk u plotësua numri minimal i parashikuar.

Në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, kostoja e një studenti mbi bazën e të cilës referohet vendosja e tarifave të shkollimit, që duhet të paguajë studenti, rezulton më e lartë se Universitetet e tjera rajonale, ndërkohë që tarifa e shkollimit nuk mund të jetë më e lartë se kufiri maksimal i vendosur me VKM-n nr. 288 datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar.

Me vendime të Bordit të Administrimit dhe VBA nr. 10 datë 06.03.2021 “Për vendosjen e tarifave të shkollimit në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'” janë vendosuar tarifat e shkollimit, tarifat e tjera dhe afatet e pagesës, si më poshtë:

1. *Tarifa konkurrimi është 5,000 lekë për aplikant për konkuruesit në Ciklin e parë të studimeve “Bachelor në edukim fizik e sporte”.*
2. *Tarifë regjistrimi:*
 - a. *Tarifë regjistrimi në ciklin e parë të studimeve – bachelor, programeve me karakter profesional, programeve të integruara të jetë 1,600 lekë. Këtë tarifë e paguan çdo kandidat që del fitues dhe regjistrohet në një program studimi në UE. Tarifa e regjistrimit që paguhet nga kandidatët për student, të cilët regjistrohen në një program studimi në UE, por që çregjistrohen në një fazë të mëvonshme nga ky program studimi, për tu regjistruar në një program tjetër brenda UE – së, të paguhet vetëm njëherë. Për kandidatët për student të regjistruar në një program studimi në UE dhe që çregjistrohen për t’u regjistruar në një Universitet tjetër, do të jetë e pakthyeshme.*
 - b. *Tarifë regjistrimi në ciklin e dytë të studimeve; Master profesional , Master i shkencave të jetë 2,500 lekë. Tarifa e regjistrimit do të paguhet nga kandidatët për student, për secilin program që kandidati regjistrohet për konkurrim në ciklit e dytë – Mp, Msh në UE. Në momentin që del fitues në një program studimi, nuk do të ketë tarifë tjetër regjistrimi – pra kjo tarifë do të përfshij konkurrimin dhe regjistrimin.*
 - c. *Tarifë aplikimi dhe regjistrimi në ciklin e tretë të studimeve “Dokoratë” të jetë 5,000 lekë. Tarifa e regjistrimit do të paguhet nga kandidatët për student, për secilin program që kandidati regjistrohet për konkurrim në ciklin e tretë në UE. Në momentin që del fitues në një program studimi, nuk do të ketë tarifë tjetër regjistrimi – pra kjo tarifë do të përfshij konkurrimin dhe regjistrimin.*
3. *Tarifat e shkollimit për të gjitha programet e studimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të jenë:*
 - a) *Në Ciklin e parë të studimeve tarifa vjetore e shkollimit të jetë:*
 - *Për program të parë studimi – Bachelor dhe programe profesionale dy vjeçare 25,000 lekë.*
 - *Për program të dytë studimi– Bachelor dhe programe profesionale dy vjeçare 60,000 lekë.*
 - *Për vitin akademik 2021-2022 e në vijim, studentët në program të parë studimi, që regjistrohen në vitin e parë akademik të paguajnë tarifën vjetore 12,500 lekë.*



- Për vitin akademik 2021-2022 e në vijim, studentët në program të parë studimi – Bachelor dhe programe profesionale dy vjeçare, që studiojnë në vitin e dytë e të tretë, të cilët kanë notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore 12,500 lekë. Studentët që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) të paguajnë tarifën vjetore 25,000 lekë.
- b) Në program të integruar të studimeve – DIND tarifa vjetore e shkollimit të jetë:
- Për program të parë studimi – DIND 30,000 lekë.
 - Për program të dytë studim – DIND 60,000 lekë.
 - Për vitin akademik 2021-2022 e në vijim, studentët në program të parë studimi – DIND, që regjistrohen në vitin e parë akademik të paguajnë tarifën vjetore 15,000 lekë.
 - Për vitin akademik 2021-2022 e në vijim, studentët në program të parë studimi - DIND, që studiojnë në vitin e dytë, të tretë, të katërt e të pestë, të cilët kanë notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore 15,000 lekë. Studentët që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) të paguajnë tarifën vjetore 30,000 lekë.
- c) Në Ciklin e dytë të studimeve “Master profesional”, tarifa për çdo kredit të jetë:
- Për program të parë studimi 1,000 lekë/kredit.
 - Për program të dytë studimi 1,200 lekë/kredit.
- Tarifa për kredit dhe e përgjithshme e shkollimit për çdo program studimi të jetë sipas tabelës nr. 1.
- d) Në Ciklin e dytë të studimeve “Master i shkencave”, tarifa për çdo kredit të jetë:
- Për program të parë studimi 1,200 lekë/kredit.
 - Për program të dytë studimi 1,400 lekë/kredit.
- Tarifa për kredit dhe e përgjithshme e shkollimit për çdo program studimi të jetë sipas tabelës nr. 2.
- e) Në Ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë”, tarifa e përgjithshme të jetë 450,000 lekë dhe të paguhet me këste të barabartë me nga 150,000 lekë për tre vitet e para të studimeve:
4. Studenti i Ciklit të parë të studimeve, i shpallur sipas rregullores së Universitetit përsëritës në vitin e parë dhe vitin e dytë (nuk ka marrë 20 kredite për të kaluar në vitin pasardhës), të paguajë:
- Për program të parë studimi – Bachelor dhe programe e karakter profesional 25,000 lekë.
 - Për program të dytë studimi – Bachelor dhe programe e karakter profesional 60,000 lekë.
5. Studenti në program të integruar të studimeve – DIND, i shpallur sipas rregullores së Universitetit si përsëritës në vitin e parë, vitin e dytë, vitin e tretë dhe vitin e katërt (nuk ka marrë 20 kredite për të kaluar në vitin pasardhës), të paguajë:
- Për program të parë studimi – DIND 30,000 lekë.
 - Për program të dytë studimi – DIND 60,000 lekë.
6. Studenti që nuk përfundon studimet në fund të vitit të tretë për sistemin Bachelor apo në fund të vitit të dytë në Programin e studimeve me karakter profesional, nuk do të paguajë tarifë shkollimi si student përsëritës në vitin pasardhës, por do të paguajë vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator):
- për program të parë studimi – Bachelor dhe programe studimi me karakter profesional 400 lekë/ kredit,
 - për program të dytë studimi – Bachelor dhe programe studimi me karakter profesional 1,000 lekë/ kredit.

7. *Studenti që nuk përfundon studimet në fund të vitit të pestë për sistemin e programeve të integruara - DIND, nuk do të paguajë tarifë shkollimi si student përsëritës në vitin pasardhës, por do të paguajë vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator):*
 - *për program të parë studimi – DIND 500 lekë/ kredit,*
 - *për program të dytë studimi - DIND 1,000 lekë/ kredit.*
8. *Studenti i Ciklit të dytë të studimeve që nuk përfundon studimet brenda kohëzgjatjes së caktuar, paguan tarifën për kreditet e lëndëve të vlerësuara jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator).*
9. *Vlera e krediteve të mbartura të paguhet për vlerën totale të lëndëve të vlerësuara jo kaluese, menjëherë para fillimit të sezonit të parë të shlyerjes së detyrimeve mësimore. Kreditet e lëndëve të vlerësuara jo kaluese të krijuara në vijim, pas vitit të fundit akademik (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator), i shtohen detyrimeve të prapambetura dhe paguhet para shlyerjes së detyrimeve mësimore, të vitit pasardhës akademik.*
10. *Tarifa vjetore e shkollimit për Ciklin e parë të studimeve dhe për Program të integruar të studimeve – DIND, të paguhet para fillimit të shlyerjes së detyrimeve mësimore të vitit akademik.*
11. *Tarifa vjetore e shkollimit për Ciklin e dytë të studimeve, tarifa e përgjithshme të paguhet me këste para shlyerjes së detyrimeve mësimore të çdo semestri.*
12. *Tarifa vjetore e shkollimit për Ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë”, tarifa e përgjithshme të paguhet me këste të barabartë për tre vitet e para të studimeve në fillim të vitit akademik.*
13. *Studenti i Ciklit të parë dhe për Program të integruar të studimeve – DIND, që ka pezulluar studimet apo kërkon të çregjistrohet (nuk ka vijuar në mësim dhe nuk ka shlyer asnjë detyrim mësimor), të mos paguajë tarifë vjetore shkollimi për këtë periudhë. Ky fakt të vërtetohet me dokument nga fakultetet.*
14. *Studenti i Ciklit të dytë i pajisur me numrin e matrikullimit që kërkon të çregjistrohet nga ky program studimi nuk do paguajë asnjë detyrim financiar, në rast se nuk ka frekuentuar dhe nuk i është shërbyer për shlyerjen e detyrimeve mësimore. Ky fakt të vërtetohet me dokument nga fakultetet*

Në fillim të çdo viti akademik evidentohen kreditet e mbartura të krijuara gjatë vitit akademik paraardhës, të cilat janë të pashlyera në fund të atij viti akademik, duke ja shtuar ato detyrimeve të pashlyera të evidentuara në vitet e mëparshme.

Bazuar në këto interpretime dhe aktet e BA-së për tarifat e shkollimit, Drejtoria ekonomike ka emetuar “Faturë për arkëtim” të tarifave të shkollimit të vitit akademik 2021-2022, sipas të dhënave të fakulteteve të paraqitura në Rektorat në formë shkresore me:

- Listat e studentëve me statusin e tyre; vitin që ndjek studimet normal apo përsëritës.
- Listat e studentëve në Ciklin e parë për program të parë studimi, të vitit të dytë e lart me mesataren e vitit akademik paraardhës mbi 6 (gjashtë), si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore.
- Listat e studentëve në Ciklin e parë, me kreditet e mbartura (vlerësuar me notë negative), të cilët kanë përfunduar vitet akademike të përcaktuar në rregulloren e Universitetit dhe nuk kanë përfunduar programin e studimit e konkretisht; Programe studimi profesionale 2-vjeçare pas përfundimit të vitit të dytë, programet e studimit Bachelor pas përfundimit të vitit të tretë.
- Listat e studentëve në Ciklin e dytë, me kreditet e mbartura (vlerësuar me notë negative), të cilët kanë përfunduar vitet akademike të përcaktuar në rregulloren e Universitetit dhe nuk kanë përfunduar programin e studimit.

Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.02.2020 ka miratuar Rregulloren e re të Universitetit. Në këtë rregullore, ndër të tjera, është vendosur që studenti në vitin pasardhës kalon me 20 kredite,

nga 30 kredite që ishte në rregulloren e mëparshme. Në zbatim të VKM-s nr. 778, datë 26.12.2018, përsa i përket studentëve të Ciklit të parë të studimeve për program të parë, studenti i vitit të dytë e lart duhet të ketë shlyer detyrimet e vitit paraardhës dhe të ketë mesatare mbi 6 që të përfitojë reduktim të tarifës vjetore të shkollimit. Shlyerje detyrimi konsiderohet që studenti të ketë marrë 60 kreditet e vitit paraardhës (kalimi me notë pozitive i të gjitha lëndëve, moduleve, praktikave të vitit paraardhës). Ky stimulim do të rriste cilësinë e diplomës nga pjesa dërmuese e studentëve. *Në vendimarrjen e BA-së për tarifën e shkollimit, studentët që kanë përfunduar vitet e përcaktuara të shkollimit dhe nuk janë diplomuar janë favorizuar, duke paguar vetëm për lëndët e vlerësuara me notë negative dhe jo tarifë vjetore shkollimi, si studentë përsëritës.*

Efektet në ulje e të ardhurave të llogaritura në buxhetin e vitit 2022, nga arkëtimi i pagesës së tarifave të shkollimit, sipas të dhënave për aplikimet e studentëve për reduktim dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të raportuara në BA deri me datë 29.01.2022, në zbatim të VKM-ve dhe akteve të tjera, që rrjedhin prej tyre, të dhënat janë si më poshtë:

Efektet e VKM-ve - Për studentë që përfitojnë përjashtim apo reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2021-2022 000/lekë												
DEGA	I parë			I dytë			I tretë			Total		
	Nr st	Tarifa	Vlera	Nr st	Tarifa	Vlera	Nr st	Tarifa	Vlera	Nr st	Tarifa	Vlera
Reduktim tarife me 50% Viti I-Bach, 2v	1,549	12,500	19,363	0	12,500	0	0	12,500	0	1,549	12,500	19,363
Reduktim tarife me 50% Viti I-DIND	62	15,000	930	0	15,000	0	0	15,000	0	62	15,000	930
Reduktim tarife me 50% me mesatare mbi 6 Viti II + III	0	12,500	0	176	12,500	2,200	130	12,500	1,625	306	12,500	3,825
Përjashtimet nga tarifën e shkollimit me rezultate	42	25,000	1,050	27	25,000	675	64	25,000	1,600	133	25,000	3,325
Përjashtimet nga tarifën e shkollimit me rezultate_DIND	4	30,000	120	4	30,000	120	0	30,000	0	8	30,000	240
Përjashtimet nga tarifën e shkollimit kritere tjera -DIND	19	30,000	570	17	30,000	510	0	30,000	0	36	30,000	1,080
Përjashtimet nga tarifën e shkollimit kritere tjera - Bach+2vj	502	25,000	12,550	414	25,000	10,350	358	25,000	8,950	1,274	25,000	31,850
Cikli parë i studimeve + DIND Totali	2,178		34,583	638		13,855	552		12,175	3,368		60,613
Reduktim tarife me 50% me rezultate	10	30,000	300	15	30,000	450	0	0	0	25	30,000	750
Reduktim tarife me 50% me kritere tjera	86	30,000	2,580	57	30,000	1,710	0	0	0	143	30,000	4,290
Total MP	96		2,880	72		2,160	0	0	0	168	60,000	5,040
Reduktim tarife me 50% me rezultate	6	36,000	216	41	36,000	1,476	0	0	0	47	36,000	1,692
Reduktim tarife me 50% me kritere tjera	69	36,000	2,484	40	36,000	1,440	0	0	0	109	36,000	3,924
Total MSH	75		2,700	81		2,916	0	0	0	156	72,000	5,616
Cikli dytë i studimeve Totali	171		5,580	153		5,076	0		0	324	0	10,656
Total UE	2,349	0	40,163	791	0	18,931	552	0	12,175	3,692		71,269

2.2. Shpenzimet e planifikuara për vitin 2022. Buxheti i shpenzimeve i vitit 2022 mbulohet nga të hyrat e fondeve në universitet: Financimi nga Buxheti i Shtetit: Granti për mësimdhënie e transfertat tek individët (fondi i bursave për studentët e Ciklit të parë të studimeve), Granti konkurrues, Granti për kërkimin shkencor, disbursimet nga projektet me financim të huaj, të ardhurat e vetë institucionit, duke i ndarë sipas zërave të shpenzimeve



buxhetore. Për ndarjen e shpenzimeve, sipas zërave në nivel tre shifrorë (shih tabela Plan Buxheti i Shpenzimeve për vitin 2022), jemi nisur nga:

- Ndarja e tyre në p/buxhetin e vitit 2022 duke reflektuar ndryshimet e ndodhura, pas miratimit.
- Ndryshimet e ndodhura në zbatim të akteve n/ligjore.
- Në numrin e punonjësve e kualifikimin e tyre, ndryshimet në strukturë, aktet ligjore e n/ligjore për pagesat e tyre,
- Numrin e studentëve dhe orët mësimore të pagueshme për mbulimin e procesit mësimor;

<i>Plan Buxheti i Shpenzimeve për vitin 2022</i>						<i>000/Lekë</i>
<i>Nr</i>	<i>Emërtimi shpenzimit</i>	<i>Artik.</i>	<i>Grant</i>	<i>P/huaja</i>	<i>Të ardhura</i>	<i>Total Buxheti</i>
	Paga e shperblime	600	813,901	0	25,078	838,978
-	Pagat	600	715,649	0	25,078	740,726
-	Honorare - oret	600	98,252	0	0	98,252
2	Sig. Shoqërore	601	81,854	0	4,876	86,730
3	Shpenzime operative	602	170,066	0	19,933	189,999
4	<i>Transf. me jashtë</i>	605	0	0	900	900
5	<i>Transf. individet</i>	606	0	0	18,750	18,750
6	<i>Bursa</i>	606	145,075	0	0	145,075
7	Kërkimi shkencor		5,446	0	92,593	98,038
-	<i>Kërkimi shkencor</i>	230	0	0	19,252	19,252
-	<i>Kërkimi shkencor</i>	231	0	0	15,672	15,672
-	<i>Kërkimi shkencor</i>	602	0	0	53,918	53,918
-	<i>Kërkimi shkencor</i>	606	5,446	0	3,751	9,197
8	Investime	230/231	344	0	249,663	250,007
a	Studim projektme, soffte	230	0	0	18,000	18,000
-	<i>Studime e projektme</i>	230	0	0	16,000	16,000
-	<i>Patenta, soffte kompjuterike</i>	230	0	0	2,000	2,000
b	Investime trupëz.	231	344	0	231,663	232,007
-	<i>Ndërtime të reja</i>	231	0	0	152,404	152,404
-	<i>Rikonstruksione</i>	231	0	0	35,259	35,259
-	<i>Instalime rrjete</i>	231	0	0	0	0
-	<i>Makineri teknologjike</i>	231	0	0	0	0
-	<i>Paisje profesionale</i>	231	0	0	20,000	20,000
-	<i>Paisje inventar ekonomik</i>	231	0	0	24,000	24,000
-	<i>Mjete transporti</i>	231	0	0	0	0
9	Projekte të huaja	230-231-602	0	24,060	0	24,060
-	<i>Shpenzime korente</i>	604	0	22,338	0	22,338
-	<i>Shpenzime Investime</i>	231	0	1,722	0	1,722
-	<i>Ridisbursim i projekt huaj</i>	231	0	0	0	0
	Totali		1,216,686	24,060	411,793	1,652,540

➤ **Paga e shpërblime – Artikulli 600**

Universitetit i nevojitet fond page rreth 525,519 mijë lekë, sipas përlloraritjeve në PBA 2022-2024 me ndryshimet në; numrin e punonjësve të miratuar, parashikimin e orëve mësimore për vitin akademik 2021-2022, nivelin e pagave të punonjësve dhe pagesës për orë mësimore, i cili ndahet:

- për paga 429,804 mijë lekë
- për pagesën e orëve mësimore 95,716 mijë lekë.

Fondi i pagave gjithsej i përlloritur në Planbuxhetin e vitit 2022 është në vlerën 838,978 mijë lekë do të mbulojë:



- Fondin e pagave të llogaritur për nevoja të procesit akademik deri në fund të vitit 2022, rreth 740,726 mijë lekë
- Fondin e pagave rreth 98,252 mijë lekë, i cili është llogaritur për pagesën e orëve mësimore të parashikuara për t'u realizuar në vitin akademik 2021-2022 nga personeli akademik.

Fondi i pagave është detajuar të përballohet nga financimi i:

- Grantit për shpenzime korrente për paga në vlerën 813,901 mijë lekë
 - Paga e detyrime të tjera që lidhen me pagat 715,649 mijë lekë
 - Shpërblime për orët e zhvilluara në procesin akademik nga personeli akademik i brendshëm e i jashtëm në vlerën 98,252 mijë lekë
- Të ardhurat e institucionit në vlerën 25,078 mijë lekë. Fondi nga të ardhurat e institucionit do të shpenzohet për:
 - Pagat e punonjësve në vlerën prej 25,078 mijë lekë.
 - Shpërblime për orët e zhvilluara në procesin akademik nga punonjësit e brendshëm e të jashtëm në vlerën prej 0 lekë.

Pagesa e orëve suplementare dhe pedagogë të jashtëm					000/lekë
Nr	Emërtimi i pagesës	Ore	Vlera	Sig. Shoq	Shuma
1	Pagesa e pedagogëve brendshëm	55,432	74,844	12,499	87,343
2	Pagesa e pedagogëve jashtëm	27,236	22,088	3,689	25,777
-	Orë viti 2021-2022 jashtëm	25,736	20,872	3,486	24,357
-	Orë viti 2020-2021 jashtëm	1,500	1,217	203	1,420
3	Pagesa e pedagogëve trajnues	1,200	1,320	22	1,342
	Totali fondi	83,867	98,252	16,210	114,462

Me fondin e pagave të planifikuar do të përballohet paga mujore për punonjësit e planifikuar sipas organikës së miratuar për 389 punonjës. Gjithashtu me këtë fond do të paguhet pagesa e orëve suplementare mbi normën e përcaktuar në Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”. Personelit akademik të punësuar me kohë të plotë mund t'i paguhen deri në 300 orë suplementare të realizuara mbi normën e ngarkesës në auditor, pasi të ketë përmbushur kohën minimale vjetore të punës prej 1,536 orë. Pranë FSHE-së me vendim të Senatit Akademik funksionon sistemi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë për të cilin me VBA nr. 4, datë 21.02.2018 “Për funksionimin e sistemit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, përcaktohen modalitetet financiare të dhe pagesa për kredit të punonjësve arsimor që do të trajnohen. Punonjësit akademikë (trajnuesit) është përlllogaritur të paguhen deri në 100 orë (trajnimi të punonjësve arsimorë), si veprimtari jashtë auditori, pasi të jetë realizuar norma e ngarkesës së përcaktuar në veprimtarinë akademike dhe të jetë përmbushur koha minimale vjetore e punës prej 1,536 orë. Fondi i pagave për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore të personelit të universitetit. Në muajin dhjetor 2021 në Universitet është paraqitur Vendimi nr. 1172, datë 22.10.2021 i Gjykatës së rrethit Gjyqësor, Elbasan me objekt; pushimin e procedimit penal nr. 1874 të vitit 2019 për veprën penale të titulluar “ngacmim seksual”. Me Urdhër të Rektorit të Universitetit nr. 237, datë 30.12.2021, “Për shfuqizimin e urdhërave të Rektorit nr. 237, datë 18.09.2019 për pezullimin nga detyra të punonjësit Denis Himçi” ka dalë urdhëri i Administratorit nr 153 datë 30.12.2021 “Për pagesën e personelit akademik të pezulluar nga puna” është kryer deklarimi i dr. Denis Himçi në sistemin e tatimeve nga data e shkëputjes nga puna 18.09.2019. Bazuar në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë dhe aktet normative të pagave, kontributit të sigurimeve shoqërore, tatimit mbi të ardhurat nga puna për periudhën nga

data 18.09.2019 deri me 31.12.2021 është llogaritur efekti i fondit të pagave e kontributit të sigurimeve shoqërore.

Nr	Emërtimi shpenzimit	Fondi gjithsej
1	Paga e shpërblime	2,644,148
2	Sigurime Shoqërore	441,573
	Totali	3,085,721

Periudha e punës	Paga Gjithësej	Paga për kontribut	Sigurime shoqërore punëmarres 9,5%	Sigurime shëndet punëmarr es 1,7%	Sigurime shëndet punëdhën 1,7%	Sigurime shoqërore punëdhën 15%	Tatime Gjithsej	Neto
18 - 30 Shtator 2019	43,508	43,508	4,133	740	740	6,526	5,656	32,979
01 - 31 Tetor 2019	95,718	95,718	9,093	1,627	1,627	14,358	8,543	76,454
01 - 30 Nëntor 2019	95,718	95,718	9,093	1,627	1,627	14,358	8,543	76,454
01 - 31 Dhjetor 2019	95,718	95,718	9,093	1,627	1,627	14,358	8,543	76,454
01 - 31 Janar 2020	96,170	96,170	9,136	1,635	1,635	14,425	8,602	76,796
01 - 28 Shkurt 2020	96,170	96,170	9,136	1,635	1,635	14,425	8,602	76,796
01 - 31 Mars 2020	96,170	96,170	9,136	1,635	1,635	14,425	8,602	76,796
01 - 30 Prill 2020	96,170	96,170	9,136	1,635	1,635	14,425	8,602	76,796
01 - 31 Maj 2020	96,170	96,170	9,136	1,635	1,635	14,425	8,602	76,796
01 - 30 Qershor 2020	96,170	96,170	9,136	1,635	1,635	14,425	8,602	76,796
01 - 31 Korrik 2020	96,170	96,170	9,136	1,635	1,635	14,425	8,602	76,796
01 - 31 Gusht 2020	96,170	96,170	9,136	1,635	1,635	14,425	8,602	76,796
01 - 30 Shtator 2020	96,170	96,170	9,136	1,635	1,635	14,425	8,602	76,796
01 - 31 Tetor 2020	96,170	96,170	9,136	1,635	1,635	14,425	8,602	76,796
01 - 30 Nëntor 2020	96,170	96,170	9,136	1,635	1,635	14,425	8,602	76,796
01 - 31 Dhjetor 2020	96,170	96,170	9,136	1,635	1,635	14,425	8,602	76,796
01 - 31 Janar 2021	96,621	96,621	9,179	1,643	1,643	14,493	8,661	77,139
01 - 28 Shkurt 2021	96,621	96,621	9,179	1,643	1,643	14,493	8,661	77,139
01 - 31 Mars 2021	96,621	96,621	9,179	1,643	1,643	14,493	8,661	77,139
01 - 30 Prill 2021	96,621	96,621	9,179	1,643	1,643	14,493	8,661	77,139
01 - 31 Maj 2021	96,621	96,621	9,179	1,643	1,643	14,493	8,661	77,139
01 - 30 Qershor 2021	96,621	96,621	9,179	1,643	1,643	14,493	8,661	77,139
01 - 31 Korrik 2021	96,621	96,621	9,179	1,643	1,643	14,493	8,661	77,139
01 - 31 Gusht 2021	96,621	96,621	9,179	1,643	1,643	14,493	8,661	77,139
01 - 30 Shtator 2021	96,621	96,621	9,179	1,643	1,643	14,493	8,661	77,139
01 - 31 Tetor 2021	96,621	96,621	9,179	1,643	1,643	14,493	8,661	77,139
01 - 30 Nëntor 2021	96,621	96,621	9,179	1,643	1,643	14,493	8,661	77,139
01 - 31 Dhjetor 2021	96,621	96,621	9,179	1,643	1,643	14,493	8,661	77,139
Totali	2,644,148	2,644,148	251,194	44,951	44,951	396,622	238,439	2,109,564

➤ **Sigurime shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601.** Fondi i llogaritur për sigurime shoqërore prej 86,730 mijë lekësh përballon nevojat deri në fund të vitit. Krahas efektit nga rritja e pagave, për llogaritjen e këtij fondi është parashikuar edhe mundësia e rritjes së nivelit maksimal të pagës për kontribut. Fondi i sigurimeve shoqërore do të përballohet nga granti 81,854 mijë lekë dhe nga të ardhurat e institucionit 4,876 mijë lekë.

➤ **Shpenzime operative – Artikulli 602.** Shpenzimet operative janë planifikuar sipas parashikimeve në p/buxhetin e vitit 2022 me disa ndryshime, duke reflektuar realizimin e procedurave të prokurimit publik në fund të vitit 2021 dhe kërkesat e paraqitura nga strukturat për vitin 2022. Këto shpenzime janë planifikuar në vlerën 189,999 mijë lekë. Ky shpenzim do të përballohet nga:

- Granti për mësimdhënie janë detajuar shpenzime operative në vlerën 170,066 mijë lekë për përballimin e shpenzimeve të drejtpërdrejta: Ujë, energjin telefon, shërbime ruajtje, pagesa e senatit Akademik, pagesa e Bordit të Administrimit e shpenzime të tjera operative.
- Të ardhurat e vetë institucionit në vlerën 19,933 mijë lekë.

Planifikimi në këto nivele do të mundësojë përballimin e shpenzimeve në rritje në disa zëra, si: energji, ujë, telefon; në shërbimet që dalin të detyruara, si p.sh.: Shpenzimet për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren, shpenzimet për sinjalin e internetit, shpenzimet



për shërbimin e ruajtjes e sigurisë, shpenzime për mirëmbajtje të godinave e pajisjeve etj.. Funksionimi i sistemit të ngrohjes qendrore në tërë godinat paraqet nevojën për shpenzime për lëndë djegëse. Ndarjen për çdo artikull e kemi llogaritur duke u nisur nga fakti i artikujve të vitit të kaluar, si dhe nga kërkesat për disa lloj shpenzimesh.

<i>Shpenzime për mallra dhe shërbime (602- shpenzime operative) viti 2022</i>				
<i>Llog.</i>	<i>Shenime</i>	<i>Grant</i>	<i>Të ardhura</i>	<i>Totali</i>
6020	Materiale zyre dhe të përgjithshme	10,977	360	11,337
6021	Materiale dhe shërbime speciale	14,200	600	14,800
6022	Shërbime nga te trete	82,890	1,720	84,610
6023	Shpenzime transporti + lëndë djegëse për ngrohje	6,000	240	6,240
6024	Shpenzime udhëtimi	13,000	0	13,000
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	24,600	6,240	30,840
6026	Shpenzime për qiramarrje	3,000	480	3,480
6029	Shpenzime të tjera operative	15,399	10,293	25,692
Totali		170,066	19,933	189,999

Grupi “Shpenzime udhëtimi” përfshin pagesën për: udhëtim e dieta brenda vendit, jashtë vendit dhe ekspedita. Udhëtim e dieta brenda vendit zë një peshë specifike shumë të vogël, për shkak të përcaktimeve në VKM për këtë qëllim. Për udhëtim e dieta jashtë vendit është përlogaritur mbulimi i shpenzimeve për pjesëmarrje në zbatimin e marrëveshjeve me universitet e huaja. Peshën kryesore në “shpenzime udhëtimi” e zënë shpenzimet për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren.

- ✓ **Shpenzimet për mbulimin e sinjalit të internetit në godinat e UE-së.** Referuar marrëveshjes ndëruniversitare me MASR-n dhe RASH-in, sinjali i internetit ka katër vjet që ofrohet nga ky e fundit me pretendimin për lidhjen me rrjetin paneuropean për Kërkimin dhe Arsimin GËANT. Për ofrimin e këtij shërbimi RASH-i ka kërkuar pagesa kundrejt numrit faktik të studntëve të matrikulluar, ndërkohë që nuk ka dhënë informacion se sa studentë dhe punonjës të universitetit kanë lidhje faktike me projektin për Kërkimin dhe Arsimin GËANT . Meqenëse RASH në vitin 2021 e ndërpreu sinjalin Universiteti për vitin 2021 parashikoi fonde për prokurimin e shërbimit të internetit me kompani që e ofrojnë këtë shërbim në të gjitha godinat me fibrat optike dhe për rrjedhojë ky sinjal ofrohet nga kontraktor privatë, sipas procedurës së prokurimi, kontratë e cila vijon deri në gusht 2022. Për vitin 2022 është parashikuar me të njëjtën procedurë.
- ✓ **Kancelari në vlerën 6,400 mijë lekë.** Blerja e kancelarive është shpenzim i vazhdueshëm, pasi ato janë marteriale konsumi. Ndër kancelaritë janë tonera e cartrige për printera e fotokopje, që kanë çmim të konsiderueshëm për njësi. Për vitin 2021 janë parashikuar 7,400 mijë lekë për kancelari. Blerja e tyre kryhet e përqëndruar për organizimin ekonomik me financë në Rektorat, që ka ky universitet, sipas kërkesave të fakulteteve për kancelari. Për vitin 2021, si rezultat i zgjatjes së afateve të procedurave të prokurimit, kontrata me subjektin fitues është lidhur me datë 10.12.2021 për vlerën 4,237 mijë lekë dhe nuk është realizuar brenda këtij viti. Kjo kontratë është obliguar në sistemin SIFQ në Degën e Thesarit për tu realizuar në vitin 2022, pavarësisht se furnizimi pjesor me kancelari ka filluar brenda muajit janar 2021. Në këto kushte kemi parashikuar dhe 3,163 mijë lekë për prokurim gjatë vitit 2022 për kërkesat e reja për kancelari dhe për fillimin e vitit 2023.
- ✓ **Shpenzimet për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren.** Referuar VKM – s përkatëse, institucioni mbulon vetëm shpenzimet për transportin dhe fjetjen, duke përjashtuar kështu dhënien e dietës, si për studentët, ashtu dhe për punonjësit akademikë e ndihmës që shoqërojnë studentët. Përcaktimi i këtij fondi është bërë në përputhje me parashikimet në planet mësimore të miratuara në Senatin Akademik, duke marrë në konsideratë kërkesat e departamenteve për kryerjen e ekspeditës së studentëve dhe

praktikave mësimore në terren. Planifikimi i shpenzimeve për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren është në ulje nga parashikimi në PBA 2022-2024 për vitin 2022. Kjo për faktin e uljes së numrit të studentëve në këto programe studimi që zhvillohet ky proces mësimor, por edhe për faktin e situatës pandemike Covid19. Parashikohet kryesisht lëvizje ditore për praktikat në mësimore në terren me numër të kufizuar studentësh.

PLANI EKSPEDITAVE VITI SHKOLLOR 2021 - 2022										
Vitet	Sistemi	Programi	Stud.	Pedag +Lab.	Stude. Pedag +Lab.	Lëvizizja Km	Vlera Udhëtimit 000/lekë	Netë	Vlera Fjetjes 000/lekë	Total 000/lekë
III	Dita	Bio kimi	8	6	14	548	24,920	6	252,000	276,920
I	M_shkenc	Mbrojtje mjedisi	19	7	26	548	41,872	5	390,000	431,872
II	M_shkenc	Mbrojtje mjedisi	11	3	14	266	12,600	5	210,000	222,600
Fakulteti shkencave të natyres			38	16	54	1,910	79,392	16	852,000	931,392
I	Dita	Operator turistik	19	2	21	640	44,100	5	315,000	359,100
I	Dita	Operator turistik Gjermane	25	2	27	640	56,700	5	405,000	461,700
I	Dita	Operator turistik	19	2	21	640	44,100	5	315,000	359,100
II	Dita	H_Gjeog	6	2	8	640	16,800	5	120,000	136,800
III	Dita	Gjuhë shqipe frënge	5	2	7	640	14,700	3	63,000	77,700
III	Dita	Gj_Letersi	15	2	17	640	35,700	3	153,000	188,700
Fakulteti shkencave humane			89	12	101	5,120	212,100	36	1,371,000	1,583,100
I	Dita	Edukim fizik e sporte	85	7	92	444	134,900	10	2,760,000	2,894,900
II	Dita	Edukim fizik e sporte	87	7	94	640	197,400	0	0	197,400
II	Dita	Edukim fizik e sporte	87	4	91	504	149,240	0	0	149,240
III	Dita	Edukim fizik e sporte	83	7	90	640	189,000	0	0	189,000
Fakulteti shkencave edukimit			342	25	367	2,228	670,540	10	2,760,000	3,430,540
I	Dita	Ekonomi Turizëm	11	2	13	504	21,320	3	117,000	138,320
II	Dita	Ekonomi Turizëm	14	2	16	504	26,240	3	144,000	170,240
III	Dita	Ekonomi Turizëm	11	2	13	504	21,320	4	156,000	177,320
Fakulteti ekonomik			36	6	42	1,512	68,880	10	417,000	485,880
Totali			505	59	564	10,770	1,030,912	72	5,400,000	6,430,912

- ✓ **Shpenzimet për shërbimin e ruajtjes e sigurisë.** Shërbimin e ruajtjes e sigurisë, Universiteti e ka të shtrirë në të gjithë territorin e qytetit të Elbasanit, edhe në periferi të tij (Njësia Administrative Bradashesh), sikurse është cituar më lart. Aktualisht ka në administrim 12 godina: Korpusi kryesor, Rektorati, Biblioteka, Shtëpia e pritjes, tre godina në FSHMT dhe trull 1,000 m² për ndërtim, FSHH (ish materniteti), Laboratori kërkimor FSHN (metalurgji) dhe Krasta me një sipërfaqe 21 ha. Për këtë shërbim ka 17 vendroje nga të cilat 10 vëndroje janë me shërbim 24 orë, ndërsa 7 vëndroje janë me shërbim 8 orë, ndërkohë që janë vendosur 7 sisteme alarmi pa pagesë, në objekte të rëndësishme (magazinë, bibliotekë, laboratore etje.). Për këtë shërbim punojnë mesatarisht 62 punonjës shërbimi.

Skema e mbulimit me vendroje dhe punonjës shërbimi për vitin 2022

Nr	Adresa e vendndodhjes	Sisteme alarmi	Orari i shërbimit	Nr Turneve	Nr rojeve
1	Korpusi kryesor/Porta hyrese dhe dalese	-	2 vend/24 orë	I+II+III	9.96
2	Rektorati (Korpusi kryesor) Turni I dhe me sistem alarmi sipas orareve 16 ⁰⁰ -08. ⁰⁰ (e henë - premtë) dhe 24 ore (e shtune,dielë e ditët e festave)	1	1vend/8 orë	I	1.66
3	Biblioteka shërbim me roje,turni I dhe me sistem alarmi sipas orareve 16 ⁰⁰ -08 ⁰⁰ (e henë - premtë) dhe 24 ore (e shtune,dielë e ditët e festave)	1	1vend/8 orë	I	1.66
4	Shtëpia e pritjes shërbim me roje,turni I dhe me sistem alarmi sipas orareve 16 ⁰⁰ -08 ⁰⁰ (e henë - premtë) dhe 24 ore (e shtune,dielë e ditët e festave)	1	1vend/8 orë	I	1.66



Nr	Adresa e vendndodhjes	Sisteme alarmi	Orari i sherbimit	Nr Turneve	Nr rojeve
5	Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Shkencave të Natyres shërbim me roje,turni I dhe me sistem alarmi sipas orareve 16 ⁰⁰ -08 ⁰⁰ (e henë - premte) dhe 24 ore (e shtune,dielë e ditët e festave)	1	1vend/8 orë	I	1.66
6	FSHE/Godina e fakultetit të shkencave të edukimit	-	1vend/24 orë	I+II+III	4.98
7	FSHE/Godina e fakultetit të shkencave të edukimit shërbim me roje,turni I dhe me sistem alarmi sipas orareve 16 ⁰⁰ -08 ⁰⁰ (e henë - premte) dhe 24 ore (e shtune,dielë e ditët e festave)	1	1vend/8 orë	I	1.66
8	FSHE/Godina e laboratorit te departamentit te edukimit fizik dhe sporteve shërbim me roje,turni I dhe me sistem alarmi sipas orareve 16 ⁰⁰ -08 ⁰⁰ (e henë - premte) dhe 24 ore (e shtune,dielë e ditët e festave)	1	1vend/8 orë	I	1.66
9	Fakulteti Ekonomik	-	1 vend/24 orë	I+II+III	4.98
10	Fakulteti Ekonomik shërbim me roje,turni I dhe sistem alarmi sipas orareve 16 ⁰⁰ -08 ⁰⁰ (e henë - premte) dhe 24 ore (e shtune,dielë e ditët e festave)	1	1 vend/8 orë	I	1.66
11	Fakulteti I Shkencave Mjekësore Teknike	-	2 vend/24orë	I+II+III	9.96
12	Laboratori (ish-metalurgjiku)	-	1vend/24 orë	I+II+III	4.98
13	Godina e FSHH (ish-materniteti)	-	1vend/24 orë	I+II+III	4.98
14	Kampusi Universitar (Krastë)	-	2 vend/24 orë	I+II+III	9.96
15	Sistem alarmi për objektet e mësipërme 7 (objekte)	7			
Totali roje					61.42

Universiti e ka të kontraktuar këtë shërbim me subjektin “UEVI-2015” shpk, e cila ka fituar procedurën në bazë të dokumentacionit të ofertës me marrëveshje kuadër deri me datë 24.04.2023 dhe kontratë njëvjeçare deri me datë 20.04.2022

Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total
1.	Shërbimi i Ruajtjes dhe i Sigurisë me roje fizike me koeficient 4.98	10	303,743.54	72,898,449.60
2.	Shërbimi i Ruajtjes dhe i Sigurisë me roje fizike me koeficient 1.66	7	87,174.9	14,645,383.20
3.	Shërbimi i Ruajtjes dhe i Sigurisë me sistem elektronik i objekteve	7	0.0001	0.0168
Çmimi Neto				87,543,833
TVSH (20%)				17,508,767
Çmimi Total për 24 muaj				105,052,600

Meqë marrëveshja kuadër me këtë subjekt përfundon me datë 20.04.2023 për vitin 2022 nuk janë parashikuar fonde për procedurë prokurimi, por fonde për shtesë me amendim të kontratës, nëse ndryshon baza e minimale e pagës për kontribut.

Shpenzime për mallra dhe shërbime (602- shpenzime operative) viti 2022				000/lekë
Artikulli	Emertimi	Grant	Të ardhura	Gjithsej
602.0	Materiale zyre dhe te pergjithshme	10,977	360	11,337
6020100	Kancelari	7,400	0	7,400
6020200	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	2,377	0	2,377
6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyles	0	120	120
6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	0	120	120
6020500	Blerje dokumentacioni	1,200	0	1,200
6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjithshme	0	120	120
602.1	Materiale dhe sherbime speciale	14,200	600	14,800
6021001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	1,200	0	1,200
6021002	Plehra kimike, furnitura veterinare, farera, fidane e te tjera produkte agrokulturore	0	120	120
6021003	Ilaçe, materiale dhe proteza mjekesore	0	120	120
6021007	Libra dhe publikime profesionale	1,200	0	1,200
6021008	Materiale per mbrojtjen e tokes, bimeve dhe kafsheve nga semundjet	0	120	120
6021009	Materiale dhe pajisje labratorike te sherbimit publik	1,160	120	1,280
6021010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	5,200	0	5,200
6021011	Softet informatike me karakter te pergjithshem	1,200	0	1,200
6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	4,240	120	4,360
602.2	Sherbime nga te trete	82,890	1,720	84,610
6022001	Elektricitet	10,000	0	10,000
6022002	Uje	8,000	0	8,000
- Projekti “VALEU-X,-Shkëmbimi Virtual i Universiteteve Evropiane dhe Shqiptare” është në vazhdim me gjendje monetare 52 mijë lekë. Gjatë vitit 2022 janë parashikuar të disbursohen 29,526 euro , ose vlera 3,632 mijë lekë, gjithësej parashikohen të përdoren 3,684 mijë lekë për shpenzime korente.
- Projekti “BKSTONE-Platforma e sipërmarrjeve të Arsimit të lartë për nxitjen, modernizimin dhe rritjen e qëndrueshme në industrinë e gurit natyror në vendet e Ballkanit Perëndimor” është në vazhdim me gjendje monetare 128 mijë lekë. Për vitin 2022 janë parashikuar të disbursohen 23,265 euro , ose vlera 2,862 mijë lekë, gjithësej parashikohen të përdoren 2,990 mijë lekë, për shpenzime korente.
- Projekti “EntrAL - Aftësitë sipërmarrëse për një edukim modern në Shqipëri” ka filluar në fund të vitit 2020 dhe është në vazhdim me gjendje monetare 515 mijë lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë projekt parashikohen të disbursohen 24,659 Euro ose vlera 3,033 mijë lekë. Gjithashtu parashikohen të përdoren për shpenzime 3,548 mijë lekë ;shpenzime për investime në vlerën 1,722 mijë lekë, shpenzime korente 1,826 mijë lekë.Gjithashtu pritet financimi i TVSH për investime nga buxheti i shtetit në vlerën 344 mijë lekë.
- Projekti “EEAABAC - Zgjerimi i BE-së dhe sfidat e përafrimit të legjislacionit, sfidat e Shqipërisë” ka filluar në fund të vitit 2020 dhe është në vazhdim me gjendje monetare 4,000 mijë lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë projekt parashikohen të disbursohen 14,012 Euro ose vlera 1,723 mijë lekë. Gjithashtu parashikohen të përdoren 5,723 mijë lekë për shpenzime korente.
- Projekti “NEET HORIZONS-Horizonte të reja për të rinjtë e papunë, të paarsimuar dhe të patrajnuar” ka filluar në dhjetor të vitit 2021. Për këtë projekt procedurat e hapjes së llogarisë speciale në Bankën e Shqipërisë dhe llogarisë së funksionimit në Bankën e Nivelit të dytë do të realizohen në fillim të vitit 2022. Parashikohet të disbursohet fondi 22,835 Euro ose vlera 2,809 mijë lekë të cilat do të përdoren kryesisht për shpenzime korente
- Gjatë zbatimit të projektit lindin efekte financiare nga kursi i këmbimit, të cilat kalojnë të ardhura për institucionin ose duhet të financojë institucioni aktivitetin e projektit. Bazuar në shkresën e Donatorit datë 06.07.2021 për projektin “T@SK- Drejt ngritjes së ndërgjegjësimit, përgjegjësisë dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale” Universiteti i detyrohet të kthejë shumën financimit prej 23,926.81 EURO ose 2,890,000 lekë me kursin këmbimit të Bankës së Shqipërisë. Ky projekt kishte gjendje 2,530,008.28 lekë. Gjatë muajit qershor u transferua tek donatori financimi prej 21,020 euro. Kërkohej të përballohet nga të ardhurat e universitetit financimi prej 2,906.81 euro ose 360,000 lekë.



3. Realizimi i planbuxhetit të vitit 2022. Për vitin 2022 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën **1,772,346** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2022-Fakti				000/lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2021	Financimi viti 2022	Buxheti viti 2022
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta)	318,137	933,115	1,251,253
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	9,200	3,225	12,425
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	372,373	136,296	508,668
TOTALI		699,710	1,072,636	1,772,346

- Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) **1,251,253** mijë lekë.
- Projekte të huaja **12,425** mijë lekë,
- Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga vitet e mëparëshme) **508,668** mijë lekë.

3.1. Hyrjet e fondeve të realizuara për vitin 2022. Hyrjet e fondeve për Universitetin për vitin 2022 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën **1,772,346** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

Fonde të hyra “Buxheti viti 2022” fakti				000/lekë
Nr	Emërtimi i programit	Buxheti vjetor	Akorduar	në %
1	Grant konkurrues	0	0	0.00
2	Kërkim shkencor infrastruktura AKKSHI	25,000	25,000	100.00
3	Kërkim shkencor AKKSHI	11,513	11,513	100.00
4	Buxhet -TVSH projekte të huaja	344	344	100.00
I	Buxheti i brendshëm	36,857	36,857	100.00
1	Grant mësimdhënie cikli parë	1,069,321	1,069,321	100.00
2	Granti i bursave të studentëve cikli parë	145,075	145,075	100.00
II	Grant	1,214,396	1,214,396	100.00
1	Të ardhurat e trashëguara vitet e mëparëshme	372,373	372,373	100.00
2	Të ardhura jashtë limiti viti 2022	173,000	136,296	78.78
III	Të ardhura	545,373	508,668	93.27
1	Projekti të huaja	30,810	12,425	40.33
IV	Projekti të huaja	30,810	12,425	40.33
	Totali	1,827,436	1,772,346	96.99

- Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) në vlerën **36,857** mijë lekë, ose 100.⁰⁰ %, nga i cili kërkimi shkencor nga Buxheti është çelur 100.⁰⁰ % e fondit të planifikuar nga Bordi i AKKSHI-it, ndërsa TVSH për projekte të huaja 47.⁸⁷ %.
- Grant mësimdhënie e bursat e studentëve në vlerën **1,047,297** mijë lekë, ose 100.⁰⁰ %,
- Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga vitet e mëparëshme) në vlerën **508,668** mijë lekë, ose 93.²⁷ % e planit vjetor.
- Projekte të huaja janë financuar **12,425** mijë lekë, ose 40.³³% e fondit të planifikuar.

Ndarë në artikuj dhe sipas realizimeve përkatëse treguesit e këtij buxheti janë në pasqyrat: “Të Ardhurat për viti 2022 - fakti”, “Realizimi i Buxhetit për vitin 2022 - Fakti”. Fondet e kushtëzuara – të ardhurat e UE - së: Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën



508,668 mijë lekë ose 93.²⁷ % të krahasuara me planin vjetor të tyre, ndërsa realizimi i të ardhurave të vitit 2022 është 136,296 mijë lekë ose 78.78% e planit vjetor të tyre.


Të Ardhurat për viti 2022 - fakti				
Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	%
A	Të ardhura të vitit	173,000,000	136,295,700	78.78
1	Qera	350,000	317,481	90.71
2	Programe profesionale	9,658,000	5,762,990	59.67
3	Bachelor	44,579,000	35,937,938	80.62
4	DIND	2,400,000	813,500	33.90
5	Master profesional	47,394,500	40,383,600	85.21
6	Master i Shkencave	54,117,600	39,165,800	72.37
7	Trajnim Mësues	500,000	146,000	29.20
8	Doktoraturë	1,050,000	0	0.00
9	Libreza Diploma etj.	2,476,000	2,403,850	97.09
10	Lëshim dokumenti	2,144,000	3,932,705	183.43
11	Taksë regjstrimi	4,830,900	4,437,400	91.85
12	Tarifa konkurrimi	500,000	450,000	90.00
13	Tjera - shërbime	2,000,000	1,238,000	61.90
14	Pjesm. konferenca	500,000	318,500	63.70
15	Sponsorizime	500,000	987,936	197.59
B	Të ardhura të trashguara	372,372,567	372,372,567	100.00
1	Trashëguar nga vitet parardh	372,372,567	372,372,567	100.00
Totali		545,372,567	508,668,267	93.27

Realizimi prej 78.⁷⁸ % është rezultat i grumbullimit i një pjese të tarifave të shkollimit të planifikuara për vitin 2022 në tetor–dhjetor 2021. Një pjesë e këtyre të ardhurave janë përdorur për shpenzimet e planifikuara për tu realizuar në vitin 2021. Pjesa e papërdorur ka kaluar e ardhur e trashëguar e viteve të mëparshme për vitin 2022.

Grumbullimi i të ardhurave gjatë periudhës janar – dhjetor 2022 është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria ekonomike dhe strukturat e fakulteteve.

Grupimet më kryesore të të ardhurave janë realizuar:

- Tarifa shkollimi 90.⁴⁰ %
- Tarifa rregjistrimi 3.³⁰ %
- Tarifa konkurrimi 0.³⁰ %
- Të ardhura Qira 0.³⁰ %
- Të tjera 5.⁷⁰ %



Në zërat e të ardhurave peshën kryesore e zënë:

- Tarifat e shkollimit nga programet profesionale në nivelin 4.² % e të ardhurave të realizuara, ose 59.⁶⁷% e planifikimit vjetor të të ardhurave.
- Tarifat e shkollimit nga programet bachelor në nivelin 26.⁴ % e të ardhurave të

realizuara, ose 80.⁶² % e planifikimit vjetor të të ardhurave.


- Tarifat e shkollimit nga programet e integruara – DIND në nivelin 0.⁶ % e të ardhurave të realizuara, ose 33.⁹ % e planifikimit vjetor të të ardhurave.



- Tarifat e shkollimit nga programet master profesionale në nivelin 29.⁶⁰ % e të ardhurave të realizuara, ose 85.²⁷% e planifikimit vjetor të të ardhurave.
- Tarifat e shkollimit nga programet master i shkencave në nivelin 28.⁸⁰ % e të ardhurave të realizuara, ose 72.⁶⁴ % e planifikimit vjetor të të ardhurave.
- Tarifat e shkollimit nga trajnimi i mësuesve në nivelin 0.¹⁰ % e të ardhurave të realizuara, ose 29.²⁰ % e planifikimit vjetor të të ardhurave.
- Tarifat e shkollimit nga doktoratura në nivelin 0.⁰⁰ % e të ardhurave të realizuara, ose 00.⁰⁰ % e planifikimit vjetor të të ardhurave.
- Libreza e diploma në nivelin 1.⁸⁰ % e të të ardhurave të realizuara, ose 97.⁰⁹ % e planifikimit vjetor të të ardhurave,
- Lëshim dokumenti në nivelin 2.⁸⁰ % e të ardhurave të realizuara, ose 175.³¹ % e planifikimit vjetor të të ardhurave, kryesisht

një peshë të rëndësishme zenë programet mësimore.

- Tarifa regjistrimi në nivelin 3.³⁰ % e të ardhurave të realizuara, ose 91.⁸⁵ % e planifikimit vjetor të të ardhurave,
- Tarifa konkurrimi në nivelin 0.³⁰ % e të ardhurave të realizuara, ose 90.⁰⁰ % e planifikimit vjetor të të ardhurave;
- Shërbime të ndryshme ndaj studentëve dhe të tretë-ve në nivelin 0.⁹⁰ % e të ardhurave të realizuara, ose 61.⁹⁰ % e planifikimit vjetor të të ardhurave;
- Pjesmarrje në konferenca në nivelin 0.²⁰ % e të ardhurave të realizuara, ose 63.⁷⁰ % e planifikimit vjetor të të ardhurave,
- Sponsorizime janë trajtuar financimet e Universiteteve të huaja për shpenzime operative në kuadër të bashkëpunimit në nivelin 0.⁷⁰ % e të ardhurave të realizuara, ose 197.⁵⁹ % e planifikimit vjetor të të ardhurave



Në mos realizimin e parashikuar të të ardhurave kanë ndikuar:

- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit për Ciklin e parë të studimeve dhe ulja e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, në zbatim të VKM s dhe Vendimeve të BA – së. Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës të plotë i tarifës së shkollimit.



- Sipas aplikimeve të kryera nga studentët për këtë qëllim përfitimi i tyre është 69,284 mijë lekë sipas tabelës së mëposhtme
- Nuk janë shlyer në kohë e detyrimeve të tarifave të shkollimit nga një pjesë e konsiderueshme e studentëve.
- Nuk janë hapur disa programeve në MP e MSH për vitin e parë si rezultat i mos plotësimit të numrit minimal të regjistrimeve. Për këto programe është planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.
- Nuk janë hapur e disa programeve në Bachelor me kohë të plotë për vitin e parë për shkak të numrit minimal të regjistrimeve.
- Numri i ulët i regjistrimeve në disa programe studimi. Për këto programe ishte planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.
- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit për Ciklin e parë të studimeve dhe ulja e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, në zbatim të VKM – s dhe Vendimeve të BA – së. Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës të plotë i tarifës së shkollimit.

Efektet e VKM-ve - Për studentë që përfitojnë përjashtim apo reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2021-2022 000/lekë									
Nr	DEGA	I parë		I dytë		I tretë		Total	
		Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera
1	Reduktim tarife me 50% - Bach&Prof 2v (Viti I + Messatare >6 Viti II&III)	973	12,163	226	2,825	208	2,600	1,407	17,588
2	Reduktim tarife me 50% - DIND (Viti I + Messatare >6 Viti II&III)	36	540	11	165	0	0	47	705
3	Përjashtimet nga tarifet e shkollimit me rezultate -Bach+2vj	42	1,050	27	675	64	1,600	133	3,325
4	Përjashtimet nga tarifet e shkollimit me rezultate -DIND	4	120	4	120	0	0	8	240
5	Përjashtimet nga tarifet e shkollimit kritere tjera -Bach+2vj	548	13,700	468	11,700	390	9,750	1,406	35,150
6	Përjashtimet nga tarifet e shkollimit kritere tjera -DIND	23	690	19	570	0	0	42	1,260
I	Cikli parë i studimeve + DIND Totali	1,626	28,263	755	16,055	662	13,950	3,043	58,268
1	Reduktim tarife me 50% me rezultate	9	270	24	720	0	0	33	990
2	Reduktim tarife me 50% me kritere tjera	84	2,520	63	1,890	0	0	147	4,410
II.1	Total MP	93	2,790	87	2,610	0	0	180	5,400
1	Reduktim tarife me 50% me rezultate	8	288	40	1,440	0	0	48	1,728
2	Reduktim tarife me 50% me kritere tjera	67	2,412	41	1,476	0	0	108	3,888
II.2	Total MSH	75	2,700	81	2,916	0	0	156	5,616
II	Cikli dytë i studimeve Totali	168	5,490	168	5,526	0	0	336	11,016
	Total UE	1,794	33,753	923	21,581	662	13,950	3,379	69,284


Të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2022 janë 136,341 mijë lekë, nga të cilat i takojnë institucionit 136,296 mijë lekë. Nga këto të ardhura janë çelur për përdorim gjatë këtij viti në vlerën 62,548 mijë lekë. Nga të ardhurat e çelura në vite, që janë transferuar për përdorim për vitin 2022, si dhe ato të çelura gjatë këtij viti janë përdorur në vlerën 90,002 mijë lekë, sipas ndarjeve në tabelë, ose grafikisht:

- Studime e projekte – (230) vlera 13,136 mijë lekë ose 14.⁶⁰ % e të ardhurave të përdorura,
- Investime trupëzuar – (231) vlera 28,041 mijë lekë ose 31.¹⁶ % e të ardhurave të përdorura,
- Paga e shpërblime – (600) vlera 3,036 mijë lekë ose 3.³⁷ % e të ardhurave të përdorura,
- Shpenzime operative – (602) vlera 569 mijë lekë ose 0.⁶³ % e të ardhurave të përdorura,
- Transferta me jashtë – (605) vlera 891 mijë lekë ose 0.⁹⁹ % e të ardhurave të përdorura,
- Transferta tek individë – (606), kryesisht rimbursim i tarifave të shkollimit vlera 7,032 mijë lekë ose 7.⁸¹ % e të ardhurave të përdorura,
- Kërkim shkencor – (230) vlera 19,369 mijë lekë ose 21.⁵⁵ % e të ardhurave të përdorura,



- Kërkim shkencor – (602) vlera 17,618 mijë lekë ose 19.⁵⁷ % e të ardhurave të përdorura,
- Kërkim shkencor – (606) vlera 284 mijë lekë ose 1.⁹⁰ % e të ardhurave të përdorura,

Përdorimi i të ardhurave viti 2022			
Nr.	Emërtimi	000/lekë	%
1	Studime e projekte-230	13,136	14. ⁶⁰ %
2	Investime trupëzuara-231	28,041	31. ¹⁶ %
3	Paga e shperblime-600	3,036	3. ³⁷ %
4	Shpenzime operative-602	569	0. ⁶³ %
5	Transf. me jashtë-605	891	0. ⁹⁹ %
6	Transf. individet-606	7,032	7. ⁸¹ %
7	Kërkimi shkencor-230	19,396	21. ⁵⁵ %
8	Kërkimi shkencor-602	17,618	19. ⁵⁷ %
9	Kërkimi shkencor-606	284	0. ³² %
	Totali	90,002	100.⁰⁰%



Përdorimi i të ardhurave, viti 2022

Të ardhurat e trashëguara në vite, të çelura për përdorim gjatë vitit 2022 e të papërdorura janë në vlerën 344,919 mijë lekë që transferohen, ndërsa të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2022 të paçelura për përdorim janë në vlerën 73,747 mijë lekë, gjithsej në vlerën 418,666 mijë lekë që transferohen për përdorim për vitin 2023.

Derdhen në Buxhet të ardhurat në vlerën 45 mijë lekë (10 % e të ardhurave nga qiratë dhe arkëtime nga debitorë të ndryshëm).

Të ardhurat janë çelur për përdorim sipas ndarjeve në planbuxhetin e vitit 2022 për Universitetin, mbështetur në domosdoshmërinë për shpenzim për çdo artikull dhe kontratave të lidhura e të realizuara në investime e shpenzime operative, si dhe për shpenzime të tjera korente. Të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2022 të paçelura për përdorim gjatë këtij viti janë transferuar për



përdorim për vitin 2023 për investime dhe kërkim shkencor sipas listës së projektëve në PBA-në e viteve 2023-2025.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka arkëtuar të ardhura për periudhën 2016-2022 sipas disa grup zërave të mëposhtme:

Të Ardhurat për vitet 2016-2022 - fakti

Nr	Emërtimi	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A	Të ardhura të vitit	259,533	299,364	268,414	168,461	153,488	147,107	136,296
1	Qera	502	520	486	377	124	123	317
2	Programe profesionale	0	0	0	0	0	0	5,763
3	Bachelor	139,035	164,038	139,822	62,722	66,414	50,289	35,938
4	DIND	0	0	0	0	0	0	814
5	Master profesional	56,922	61,363	57,921	47,953	40,710	47,818	40,414
6	Master i Shkencave	37,281	44,611	46,428	41,349	29,014	34,204	39,310
7	Trajnim Mësues	0	0	0	0	0	49	146
8	Doktoraturë	139	486	347	108	0	625	0
9	Libreza diploma etj.	11,153	14,333	10,849	4,171	2,909	2,639	2,404
10	Lëshim dokumenti	2,718	4,187	4,379	3,714	2,599	3,748	3,759
11	Taksë regjstrimi	7,698	6,888	5,786	5,272	5,155	5,107	4,437
12	Tarifa konkurrimi	511	414	420	415	485	550	450
13	Tjera - shërbime	590	995	744	1,747	1,889	1,424	1,238
14	Pjesm. konferenca	2,984	1,353	948	0	5	130	319
15	Sponsorizime	0	176	285	632	185	386	988
16	Të ndryshme	0	0	0	0	4,000	16	0
B	Të ardhura të trashguara	61,441	81,060	129,604	161,496	217,969	288,585	372,373
1	Trashëguar nga viti paraardhës	61,441	81,060	129,604	161,496	217,969	288,585	372,373
Totali		320,974	380,423	398,018	329,956	371,456	435,692	508,668

Nga njëri vit në tjetrin arkëtimi i tyre nga parashikimi ka pësuar luhatje si rezultat:

- Nuk është realizuar regjistrimi i numrit të studentëve të parashikuar në çdo program studimi
- Efektet financiare në arkëtimin e tarifave të shkollimit në zbatim të VKM –ve sipas të cilëve:

- përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët e ciklit të parë, që plotësojnë kriteret e përcaktuara.
- reduktohet me 50% tarifa vjetore e shkollimit për studentët e ciklit të dytë, që plotësojnë kriteret e përcaktuara

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka arkëtuar të ardhura për periudhën 2016-2022 për shërbime ndaj të tretëve kryesisht; shërbime të analizave të materialeve të ngurta ose të lëngëta të bizneseve ndërtuese ose importuese për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të cilat kryhen në Laboratorin kërkimor eksperimental (i akredituar), Lëshim dokumentacioni për të diplomuarit në vitet e mëparshme në këtë institucion.

Të Ardhurat për vitet 2016-2022 – fakti

000/Lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A	Të ardhura të vitit	3,308	5,182	5,122	5,461	4,487	5,172	4,997
9	Lëshim dokumenti	2,718	4,187	4,379	3,714	2,599	3,748	3,759
12	Tjera - shërbime	590	995	744	1,747	1,889	1,424	1,238
Totali		3,308	5,182	5,122	5,461	4,487	5,172	4,997



3.2. Shpenzimet e realizuara për vitin 2022. Gjatë vitit 2022 shpenzimet gjithsej janë realizuar në nivelin 49.²⁹ % e financimit vjetor. Planbuxheti i çelur për përdorim (Plan Thesari) në vlerën **1,772,346 mijë** lekë është realizuar në vlerën **873,586 mijë** lekë, ose 49.²⁹ % e fondeve.

Nr	Shpenzime të fondeve të çelura (akorduara) viti 2022			000/lekë
	Emërtimi i programit	Çelur për përdorim	fakt	në %
1	Grant konkurrues	0	0	0.00
2	Kërkim shkencor infrastruktura AKKSHI	25,000	25,000	100.00
3	Kërkim shkencor AKKSHI	11,513	6,487	56.34
4	Buxhet -TVSH projekte të huaja	344	338	98.21
I	Buxheti i brendshëm	36,857	31,825	86.35
1	Grant mësimdhënie	1,069,321	623,065	58.27
2	Grant mësimdhënie	145,075	121,325	83.63
II	Grant	1,214,396	744,389	61.30
1	Të ardhura	508,668	90,002	17.69
III	Të ardhura	508,668	90,002	17.69
1	Projekti të huaja	12,425	7,371	59.32
IV	Projekti të huaja	12,425	7,371	59.32
	Totali	1,772,346	873,586	49.29

- Sipas formave të financimit
 - Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues, TVSH projekte, kërkimi shkencor nga buxheti - AKKSHI) është realizuar në vlerën 31,825 mijë lekë , ose 86.³⁵% e fondit të çelur.
 - Granti për mësimdhënie për shpenzime korente dhe bursat e studentëve është realizuar në vlerën 744,389 mijë lekë , ose 61.³⁰% e fondeve të akorduara.
 - Shpenzimet nga të ardhurat e institucionit janë realizuar në vlerën 90,002 mijë lekë , ose 17.⁶⁹% e fondeve të autorizuara.
 - Projekte të huaja janë realizuar në vlerën 7,371 mijë lekë , ose 59.³²% e fondeve të disbursuara.
- Sipas zërave të shpenzimit:
 - Shpenzimet për Paga e shpërblime, janë realizuar në vlerën 432,578 mijë lekë , ose 51.³⁵% e fondeve në dispozicion, nga të cilat:
 - Financimi nga Buxheti është realizuar në vlerën 429,542 mijë lekë , ose 52.⁵⁵% e fondeve,
 - Nga të ardhurat, janë realizuar në vlerën 3,036 mijë lekë , ose 12.¹¹% e fondeve,
 - Shpenzimet për Sigurime shoqërore, janë realizuar në vlerën 63,415 mijë lekë , ose 73.¹²% e fondeve në dispozicion , nga të cilat:
 - Financimi nga Buxheti është realizuar në vlerën 63,415 mijë lekë , ose 77.⁴⁷% e fondeve,
 - Nga të ardhurat nuk janë realizuar,
 - Shpenzimet operative, janë realizuar në vlerën 130,676 mijë lekë , ose 68.⁷⁸% e fondeve në dispozicion, nga të cilat:
 - Financimi nga Buxheti është realizuar në vlerën 130,107 mijë lekë , ose 76.⁵⁰% e fondeve,
 - Të ardhurat, janë realizuar në vlerën 569 mijë lekë , ose 2.⁸⁵% e fondeve në dispozicion.
 - Transferta me jashtë, janë realizuar në vlerën 891 mijë lekë , ose 70.⁷⁵% e fondeve në dispozicion.
 - Transferta tek individët, janë realizuar në vlerën 7,032 mijë lekë , ose 50.²³% e fondeve në dispozicion nga të ardhurat.
 - Bursat për studentët, janë realizuar në vlerën 121,325 mijë lekë , ose 83.⁶³% e fondeve.
 - Shpenzimet për kërkimin shkencor, janë realizuar në vlerën 68,784 mijë lekë , ose 76.¹⁸% e fondeve në dispozicion, nga të cilat:



- Financimi nga – AKKSHI është realizuar në vlerën 31,487 mijë lekë , ose 86.²⁴% e fondeve,
 - Të ardhurat, janë realizuar në vlerën 37,297 mijë lekë , ose 69.³⁵% e fondeve.
 - Shpenzimet për investimet, janë realizuar në vlerën 41,515 mijë lekë , ose 17.³⁴% e fondeve në dispozicion, nga të cilat:
 - Shpenzimet e financuara nga Buxheti janë realizuar në vlerën 338 mijë lekë , ose 98.21% e fondeve në dispozicion – TVSh për projekte me financim të huaj.
 - Shpenzimet e financuara nga të ardhurat, janë realizuar në vlerën 41,177 mijë lekë , ose 14.24% e fondeve.
 - Projektet e huaja janë realizuar në vlerën 7,371 mijë lekë , ose 23.⁹²% e fondeve për disbursim.
- Realizimi i buxhetit më i detajuar, sipas formave të financimit dhe ndarjes së zërave të shpenzimeve paraqitet në tabelën “Realizimi i planbuxhetit për vitin 2022”

➤ **Paga e shpërblime – Artikulli 600.** Pagat për vitin 2022 janë mbuluar kryesisht me fondet nga Granti për shpenzime korente në masën 52.⁵ % të planit vjetor, ose 78.¹ % të parashikimit duke përfshirë dhe të ardhurat. Plani vjetor i pagave përfshin edhe mbulimin nga të ardhurat të çelura për përdorim në vlerën 25,078 mijë lekë.

Me fondin e pagave janë përbulluar ndryshimet e pagës sipas kualifikimit të personelit akademik, pagesa për orët mësimore të personelit akademik efektiv dhe të ftuar, pagesa nga rritja me 7% sa kufiri minimal i fondit të pagave për personelin akademik, sipas VKM-s nr. 647, datë 05.10.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 ‘Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë’, i ndryshuar”, nga rritja me 8% sa kufiri maksimal i fondit të pagave për personelin akademik sipas VBA nr . 14, datë 04.11.2022 “Për miratimin në kufirin maksimal të pagave të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për secilin pozicion pune” në zbatim të VKM-s nr. 647, datë 05.10.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 ‘Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë’, i ndryshuar” me një efekt dymujor prej 3,370 mijë lekë, që u përballua nga të ardhurat e vetë institucionit.

Pjesën më të madhe në zërin paga e shpërblime e zënë pagat mujore me vlerë 348,232 mijë lekë në masën 48.⁴²% të realizimit të fondit të pagave. Me zërin e shpenzimit paga honorare përfshihet pagesa për orët mësimore të zhvilluara në vitin 2021 – 2022, e cila përbëhet:

Pagesa e orëve mësimore për vitin 2021 - 2022								000/ lekë
Nr	Lloji shpenzimit	Plan		Realizuar		Paguar		
		Orë	Lekë	Orë	Lekë	Orë	Lekë	
1	Orë mësimore për punonjës të brendshëm	55,432	74,844	63,391	60,857	56,019	53,780	
2	Orë mësimore për punonjës të jashtëm	27,236	22,088	36,363	32,339	33,846	30,100	
3	Pagesa e pedagoqeve trajnues	1,200	1,320	162	164	162	0	
	Fondi gjithsej	83,867	98,252	99,916	93,360	90,027	83,880	

- Pagesa për orët mbi normë të personelit akademik efektiv të cilët kanë realizuar 63,391 orë të pagueshme me fond 60,857 mijë lekë dhe janë paguar brenda limitit të lejuar për 56,019 orë mësimore të pagueshme me vlerë 53,780 mijë lekë. Pagesa e personelit akademik i ftuar (pedagogë të jashtëm) të cilët kanë realizuar 36363 orë të pagueshme me fond 32,339 mijë lekë dhe janë paguar brenda limitit të lejuar për 33,886 orë mësimore të pagueshme me vlerë 30,100 mijë lekë, ndërkohë që një pjesë e këtyre orëve nuk janë kryer pagesat për arsye të raportimit të tyre në fund të vitit 2022.
- Pagesa e pedagoqeve trajnues, të cilët kanë realizuar 162 orë mësimore për 9 module të realizuara dhe pagesa nuk është kryer pasi raportimi i tyre është në fund të dhjetorit 2022.



- **Fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601.** Fondi për sigurime shoqërore është shpenzuar për likuidimin e detyrimeve që institucioni ka ndaj Degës së Sigurimeve Shoqërore, si kontribut për punonjësit e vet. Ky zë është realizuar në masën 63,415 mijë lekë e shprehur me 77.47% e fondit të planifikuar nga Granti i mësimdhënies, ose 67.78 % për fondin e planifikuar vjetor. Niveli i realizimit të fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore të lidhura me pagat është rezultat i mosrealizimit të numrit mesatar të punonjësve akademikë gjatë vitit 2022. Ky fenomen ka sjellë mbulimin e procesit mësimor akademik me mbingarkesë të personelit akademik efektiv (ngarkesë e cila nuk mund të paguhet në masën 100% të realizimit), mbulimin e procesit mësimor akademik me personel akademik të ftuar mbi parashikimin në fillim të vitit, e për pasojë me një efikasitet akademik të mbingarkuar.
- **Shpenzime operative – Artikulli 602.** Për vitin 2022 shpenzimet operative janë parashikuar të përballohen nga granti për shpenzime korente dhe nga të ardhurat. Këto shpenzime janë realizuar në vlerën 130,676 mijë lekë, ose 68.78 % e fondit të çelur për këtë qëllim:

- nga granti është realizuar në vlerën 130,107 mijë lekë, ose 76.50 % e fondit të çelur ,
- nga të ardhurat është realizuar në vlerën 569,020 mijë lekë, ose 2.85 % e fondit të çelur.

Shpenzimet operative për vitin 2022, janë realizuar kryesisht për: ujë, energji, telefon, karburant, buletini shkencor, kancelari, furnizime të ndryshme materiale, rojet e godinave, riparime të ndryshme pajisjesh, udhëtim e hotel për ekspeditat etje. Rritje të ndjeshme në shpenzimet operative kanë disa zëra të domosdoshëm që i shërbejnë procesit mësimor. Krahas kësaj, rritje të ndjeshme kanë pagesat për rojet (ruajtjen e sigurimit e objekteve), uji, energjia elektrike, karburanti për ngrohje etje. Në formë të përmbledhur jepen në tabelën “Shpenzime për mallra dhe shërbime (602) viti 2022”, më të detajuara “Tabela 2/1 Shpenzime për mallra dhe shërbime analitike Fakt 2022”

Shpenzime për mallra dhe shërbime (602) Realizimi viti 2022										
Kodi llog	Grup shpenzimi	Grant			Të ardhura			Totali		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
6020	Materiale zyre dhe te pergjithshme	10,977	6,078	55.4	360	0	0.0	11,337	6,078	53.6
6021	Materiale dhe shërbime speciale	14,200	2,919	20.6	600	13	2.2	14,800	2,932	19.8
6022	Shërbime nga te trete	82,890	70,742	85.3	1,720	48	2.8	84,610	70,791	83.7
6023	Shpenzime transporti + lëndë djegese	6,000	3,080	51.3	240	0	0.0	6,240	3,080	49.4
6024	Shpenzime udhëtimi	13,000	7,860	60.5	0	431	0.0	13,000	8,291	63.8
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	24,600	17,156	69.7	240	0	0.0	24,840	17,156	69.1
6026	Shpenzime per qiramarrje	3,000	3,316	110.5	480	0	0.0	3,480	3,316	95.3
6029	Shpenzime te tjera operative	15,399	18,956	123.1	16,293	76	0.5	31,692	19,032	60.1
	Totali	170,066	130,107	76.5	19,933	569	2.9	189,999	130,676	68.8

Mos realizimi i shpenzimeve operative të planifikuara ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të disa prokurimeve për shkak të anulimit të procedurave, ndërkohë që procedurat e prokurimit janë filluar në afatet e kërkuara, por nuk janë përfunduar në afat.

Vlen të theksojmë mosrealizimin e procedurës së prokurimit për objektin “Mirëmbajtje objekte ndërtimore dhe mjedise të jashtme” gjatë vitit 2021, e cila është anuluar nga KPP në fund të dhjetorit 2021 dhe që zë 8.2 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative. Për këtë procedurë është rillogaritur preventivi duke vendosur dhe shërbimet e mirëmbajtjes së vitit 2022 duke e prokuruar me fond limit 24,999,424 lekë (me TVSH), për të cilin është lidhur kontrata nr. 1464/14, datë 14.09.2022 me vlerë 17,708,934 lekë shërbim i cili është në proces.

Të përmbledhura sipas grupzërave të shpenzimeve operative realizimi paraqitet si më poshtë: Në shpenzimet për ekspeditat mësimore në terren viti shkollor 2021 - 2022 reflektohet ulje e tyre. Për periudhën e analizuar ky zë është realizuar 54.76 % e vlerës së planifikuar, ose 62.77% e numrit të studentëve të planifikuar.

Ekspeditat mësimore në terren viti shkollor 2021 - 2022 - Realizimi										
	Cikli	Prog rami	Stud.	Pedag +Lab.	Stude. Pedag	Lëvizizja Km	Udhëtimet lekë	Netë	Vlera Fjetjes lekë	Total lekë
Totali Plan	I+II	16	505	59	564	8,942	1,030,912	72	5,400,000	6,430,912
Totali Fakt	I+II	9	317	43	360	8,197	830,338	21	2,691,000	3,521,338
Përqindja e realiz			62.77%	72.88%	63.83%	91.67%	80.54%	29.17%	49.83%	54.76%

➤ **Shpenzime operative për transferta me jashtë – Artikulli 605.** Transferta me jashtë është realizuar 70.⁷⁵ % e fondit vjetor të planifikuar. Ky shpenzim është planifikuar për pagesën e pjesëmarrjes në institucione apo organizata ndërkombëtar. Është kryer vetëm një pagesë për Laboratorin kërkimor të FSHN për kryerjen e testeve të analizave në Institucione të akredituara ndërkombëtare, për procesin e akreditimit të këtij laborator

➤ **Transferta tek individët bursat e studentëve – Artikulli 606. Bursat e studentëve.** Për vitin 2022 fondi i bursave të studentëve është realizuar 83.⁶³ % e fondit vjetor të planifikuar. Në këtë artikull përfshihen bursat financiare të studentëve (transferta tek individët) për Ciklin e parë të studimeve. Fondi është akorduar në Grantin për bursat e studentëve në fillim të vitit gjithsej **145,075 mijë** lekë. Sipas procedurës së përcaktuar nga BA në zbatim të VKM-ve për këtë qëllim, kanë paraqitur kërkesat për bursë financiare e përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 1,641 studentë, nga të cilët për bursë financiare e përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit janë paraqitur kërkesa nga 1,448 studentë, ndërsa vetëm për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit janë 193 kërkesa.

Nga kërkesat e paraqitura janë miratuar me vendim të BA-së të trajtohen me bursë financiare për 1,382 studentë me fond 124,380 mijë lekë

Miratuar me Vendim Bordi Administrimi për vitin akademik 2021-2022								
Emërtimi	Viti parë		Viti dytë		Viti tretë		Totali	
	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera
Trajtohen me rezultate	46	4,140	31	2,790	64	5,760	141	12,690
Trajtohen kritere tjera	496	44,640	411	36,990	334	30,060	1,241	111,690
Shuma	542	48,780	442	39,780	398	35,820	1,382	124,380

Në zbatim të vendimeve për bursat, nga kërkesat e miratuara, janë kaluar në bankë në llogaritë e studentëve mesatarisht për 1,378 studentëve vlera 121,325 mijë lekë nga fondet e vitit 2022.

Bursa të paguar në bankë për vitin akademik 2021-2022								
Emertimi	Viti parë		Viti dytë		Viti tretë		Totali	
	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera
Transferuar studentëve me rezultate	44	3,950	31	2,790	64	5,760	139	12,500
Transferuar studentëve kritere tjera	494	43,100	411	36,190	334	29,535	1,239	108,825
Shuma	538	47,050	442	38,980	398	35,295	1,378	121,325

Studentët që përfitojnë bursë vitet 2016-2022													
000/lekë													
Nr	Kriteri	2016-2017		2017-2018		2018-2019		2019-2020		2020-2021		2020-2021	
		Nr.st	Fonde	Nr.st	Fonde	Nr.st	Fonde	Nr.st	Fonde	Nr.st	Fonde	Nr.st	Fonde
1	Rezultate	0	0	3	220	95	7,236	103	8,831	123	11,070	141	12,690
2	Në nevojë	1,102	51,081	1,196	52,399	1,471	92,988	1,390	114,772	1,296	112,140	1,241	111,690
	Total	1,102	51,081	1,199	52,619	1,566	100,224	1,493	123,603	1,419	123,210	1,382	124,380

Transfertat e tjera tek individët . Për vitin 2022 janë planifikuar rimbursimi i tarifave vjetore të shkollimit, raste fatkeqësie familjare, dalje në pension të punonjësve. Fondi i transfertave i çelur plan thesari është 14,000 mijë lekë. Ky zë shpenzimi është realizuar 50.²³ %. Janë paguar kryesisht: Rimbursim tarifa shkollimi që i kanë paguar studentët, ndërkohë që përfitojnë sipas



vendimarrjes së Bordit të Administrimit në zbatim të VKM-s për këtë qëllim, raste fatkeqësie familjare, dalje në pension të punonjësve, sëmundje të rënda, pagesa të komisioneve add-hoc, rimbursim telefoni për titullarët (Rektor dhe Administrator), sipas VBA nr. 05, datë 21.02.2018 “Për shpenzimet e telefonisë celulare” .

➤ **Shpenzime për investime - artikulli 230/231.** Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen në formën e:

- Grantit konkurrues që janë fondet të cilat përballohen nga Buxheti i Shtetit. Nga Universiteti janë dërguar për konkurrim 2 objekte me vlerë **1,664,558** mijë lekë, të cilat janë me bashkëfinancim nga:
 - Buxheti i Shtetit në vlerën 998,663 mijë lekë,
 - Të ardhurat e Universitetit në vlerën 665,894 mijë lekë.

Transferta tek individët realizimi viti 2022			000 lekë
Nr.	Lloji i transfertës	Nr rasteve	Fondi
1	Rimbursim tarifa shkollimi	17	190
2	Fatkeqësi familjare	3	90
3	Sëmundje të rënda	0	0
4	Dalje në pension	9	710
5	Tjera transferta	29	2,057
6	Rimbursim tel titullar	2	275
7	Mbeshtetje financiare VKM	321	3,710
	Mbeshtetje financiare VKM	381	7,032

Investime me bashkëfinancim - UE+Buxhet						
Nr	Emërtimi projektit	Fondi 000 lekë				
		Total	2022	2023	2024	2025
a)	Financim nga të ardhurat e Universitetit	455,894	247,388	141,737	66,769	0
b)	Financim nga Buxheti i Shtetit	509,208	0	101,842	152,763	254,604
1	"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjekësore teknike - FSHMT"	965,103	247,388	243,578	219,532	254,604
a)	Financim nga të ardhurat e Universitetit	210,000	0	30,000	23,673	156,327
b)	Financim nga Buxheti i Shtetit	489,455	0	100,000	189,455	200,000
2	"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti"	699,455	0	130,000	213,128	356,327
a)	Total Financim nga të ardhurat e Universitetit	665,894	247,388	171,737	90,442	156,327
b)	Total Financim nga Buxheti i Shtetit	998,663	0	201,842	342,218	454,604
	Totali i bashkëfinancimit	1,664,558	247,388	373,578	432,660	610,932

Raportet e financimit janë Buxheti i Shtetit 60% ndërsa Universiteti 40% e objekteve të marra së bashku. Nga KZHR gajtë vitit 2022 është miratuar për financim objekti me vlerë 965,103 mijë lekë. Për këtë objekt gjatë vitit 2022 nga buxheti nuk janë çelur fonde në degën e thesarit, ndërsa Universiteti ka kryer investime nga të ardhurat për vlerën 1,971 mijë lekë. Investimet e realizuara për vitin 2022 nga Buxheti i Shtetit është TVSH për projekte të huaja në vlerën 338 mijë lekë ose 98.²¹% të fondeve të parashikuara për financim (çelura në Degën e Thesarit)

- Investimeve nga të ardhurat e vetë institucionit janë parashikuar në plan buxhetin e vitit 2022 me fond 381,267 mijë lekë dhe të çelura planthesari 289,252 mijë lekë. Këto investime janë realizuar në vlerën 41,177 mijë lekë, ose 10.⁸⁰% dhe ndahen në:

- **Studime e projektme, patenta, liçenca, soffte kompjuterike – artikulli 230**

- Në studime e projektme për vitin 2022 janë parashikuar 4 objekt me vlerë 14,384 mijë lekë. Për periudhën e analizuar është realizuar procedura e prokurimit lidhja e kontratës dhe likuidimi i faturave për 3 projekte me vlerë 13,136 mijë lekë, ose 80.18% e fondit të planifikuar, sipas objekteve në “Tabela 2 - Investime viti 2022 - të ardhurat e institucionit”;



- ✓ Projekt + preventiv "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjekësore teknike - FSHMT" në vlerën 11,640 mijë lekë, ose 97.⁰⁰ % e vlerës së planifikuar. Sipas preventivit të realizuar nga preventivuesi objekti "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjekësore teknike - FSHMT" parashikohet të ndërtohet në vlerën 925,833,442 lekë;
- ✓ Projekt + preventiv "Rikonstruksion salla e konferencave 111 - FSHE" në vlerën 498 mijë lekë, ose 99.⁶⁰ % e vlerës së planifikuar. Sipas preventivit të realizuar nga preventivuesi objekti " Rikonstruksion salla e konferencave 111 - FSHE" parashikohet të ndërtohet në vlerën 19,793,177 lekë;
- ✓ Projekt + preventiv "Sistem WiFi në godinat e UE" në vlerën 998 mijë lekë, ose 99.⁸⁴ % e vlerës së planifikuar. Sipas preventivit të realizuar nga preventivuesi objekti " Sistem WiFi në godinat e UE" parashikohet të ndërtohet në vlerën 17,500,000 lekë;
- Në patenta, liçenca, softte kompjuterike për vitin 2022 është parashikuar fondi me vlerë 2,000 mijë lekë për pajisjet e parashikuara në laboratorë. Ky fond nuk është realizuar, pasi dhe objekti i investimit "Pajisje profesionale (laboratorike) nuk është realizuar.

Realizimi Investimeve nga të ardhurat e UE - viti 2022				
Nr.	Emërtimi i projektit	Fondi 000/ lekë		
		Plani	Fakti	%
I	Studime e projekte, patenta, liçenca, softte kompjuterike	16,384	13,136	80.18%
II	Ndërtime të reja	285,623	9,048	3.17%
III	Rikonstruksione	35,260	17	0.05%
IV	Pajisje inventar ekonomik	20,000	18,976	94.88%
V	Pajisje profesionale	24,000	0	0.00%
VII	Projekte të huaja	0	0	0.00%
	Shuma	381,267	41,177	10.80%

- Investimet - Artikulli 231: Ndërtime të reja, rikonstruksion objekte ndërtimore, pajisje të ndryshme

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për investime për: ndërtime e rikonstruksione objekte, blerje pajisje për auditorët e zyrat, blerje pajisje laboratorike për laboratorët mësimorë e shkencorë, krijim i fondit të librit në bibliotekë etje.

Projektet e investimeve të financuara paraqiten në tabelën "Tabela 2 - Investime viti 2022 - të ardhurat e institucionit" dhe janë realizuar në vlerën 28,041 mijë lekë, ose 7.⁶⁸ % e planit të buxhetit vjetor ose 10.¹⁶% e planit të çelur për përdorim në degën e Thesarit.

Treguesit e realizimit të investimeve janë në nivele të ulëta pasi në investimet e planifikuara vetëm, projekti "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjekësore teknike - FSHMT" zë 64.⁸⁹ % të investimeve, për të cilin janë kryer disa procese paraprake dhe është aplikuar për nxjerrjen e lejes së ndërtimit. Investimet e projekteve të planifikuara për vitin 2022 janë realizuar:

- Ndërtimet e reja janë realizuar në vlerën 9,048 mijë lekë, ose 3.¹⁷ % e fondeve të planifikuara;
 - ✓ Projekti "Kolaudim - Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT" është realizuar për vlerën 2 mijë lekë, i cili është realizuar në vitin 2021, por subjekti "DEA-N CONSULTING STUDIO" ka prerë faturën 1/2022 datë 21.04.2022 me vlerë 1,920 lekë e cila është likuiduar në maj 2022;
 - ✓ Projekti " Ndërtim - "Shkallë emergjence godinat e UE" është realizuar për vlerën 7,075 mijë lekë, i cili ka filluar punimet lidhjen e kontratës 16.08.2021 me subjektin

“NIKA” shpk ka prerë faturën 1/2022 datë 21.04.2022. ky projekt ka përfunduar më 20.12.2022, është marrë në dorëzim. Subjekti është likuiduar për 95% të kontratës, ndërsa garancia e punimeve në masën 5% është depozituar në Degën e Thesarit, sipas procedurave ndërtimore.

- ✓ Projekti “Efienca e energjisë në godina –‘Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjekësore teknike – FSHMT”” është realizuar për vlerën 1,796 mijë lekë, ose 99.⁷⁸% e fondeve të planifikuara.
- ✓ Projekti “Rilevim topografik–‘Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjekësore teknike – FSHMT”” është realizuar për vlerën 175 mijë lekë, ose 87.⁵⁰% e fondeve të planifikuara.
- ✓ Objektet e tjera:
- ✓ Projekti "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti i planifikuar me bashkëfinancim nuk është realizuar, pasi nuk është miratuar financimi nga Buxheti i Shtetit.
- ✓ Leje ndërtimi - "Ndërtim - "Shkallë emergjence godinat e UE" nuk është realizuar gjatë vitit 2022, pasi është përpunuar dokumentacioni i nevojshëm dhe është dërguar për miratim në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT).
- Rikonstruksionet janë realizuar në vlerën 17 mijë lekë, ose 0.⁰⁵ % e fondeve të planifikuara;
 - ✓ Projekti "Kolaudim – ‘Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT’” është realizuar për vlerën 17 mijë lekë, i cili është realizuar në vitin 2021, por subjekti “DEA-N CONSULTING STUDIO” ka prerë faturën 2/2022 datë 21.04.2022 me vlerë 16,780 lekë e cila është likuiduar në maj 2022;

Projektet e tjera të rikonstruksioneve nuk janë realizuar, pasi nuk janë mundësuar realizimi i procedurave paraprake të dokumentacionit të tyre.

- Pajisjet profesionale (laboratorike) u planifikuan me vlerë 24 milion lekë dhe nuk janë realizuar, pasi për këta laboratorë është paraqitur kërkesa paraprake në periudhën e përgatitjes së buxhetit dhe nuk janë sjellë nga njësitë bazë projektet e konsoliduara të tyre.
- Pajisjet (inventar ekonomik) janë realizuar në vlerën 18,976 mijë lekë, ose 94.⁸⁸% e fondeve të planifikuara. Në grupin e pajisjeve (inventar ekonomik) janë;
 - ✓ Pajisje kompjuterike e fotokopje janë për vlerën 14,635 mijë lekë, ose 97.⁵⁷% e vlerës së planifikuar,
 - ✓ Pajisje e orendi për auditore laboratore e zyra janë për vlerën 2,466 mijë lekë, ose 85.⁶³% e vlerës së planifikuar,
 - ✓ Fond libri për bibliotekën është realizuar për vlerën 1,755 mijë lekë, ose 87.⁷⁷% e vlerës së planifikuar,
 - ✓ Pajisje e vegla pune dore për sektorin e shërbimeve është realizuar për vlerën 119 mijë lekë, ose 99.¹⁶% e vlerës së planifikuar.

➤ **Shpenzimet për kërkimin shkencor**

Në Buxhetin e Universitetit për kërkimin shkencor për vitin 2022 janë parashikuar në Planbuxhetin e ndryshuar 130,720 mijë lekë dhe është çelur për përdorim në degën e Thesarit fondi prej 90,293 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 68,874 mijë lekë, ose 76.²% e fondit nga i cili ndahet;

- Kërkim shkencor nga Buxheti i Shtetit është financuar në vlerën 36,513 mijë lekë.
- Fondet për kërkimin shkencor nga të ardhurat e institucionit është financuar në vlerën 53,780 mijë lekë.



Realizimi i kërimit shkencor për vitin 2022 - AKKSHI										
Art	Emërtimi	AKKSHI			Të ardhura			Total Buxheti		
		Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%
1	Infrastruktura - PIKSH (230)	0	0	0.0	19,396	19,396	100.0	19,396	19,396	100.0
2	Infrastruktura - PIKSH (231)	25,000	25,000	100.0	0	0	0.0	25,000	25,000	100.0
3	Kërkim zhvillim - PKKZH (602)	11,513	6,487	56.3	30,633	17,618	57.5	42,146	24,104	57.2
4	Kërkim zhvillim - PKKZH (606)	0	0	0.0	3,751	284	7.6	3,751	284	7.6
	Kërkim shkencor	36,513	31,487	86.2	53,780	37,297	69.4	90,293	68,784	76.2

- **Granti konkurrues për kërkim shkencor nga Buxheti i Shtetit.** AKKSHI në procedurën e aplikimeve për financimin e projekteve të kërimit shkencor paraqiti “Thirrje për aplikim për projektet Kombëtare të Kërimit dhe të Zhvillimit (PKKZH) për vitin 2022”, në të cilën afati i fundit i aplikimit ishte data 07.03.2022. Në përgjigje të kësaj thirrje njësitë bazë kanë paraqitur për aplikim dhe u dërguan në AKKSHI nga UE me shkresë nr 584 prot datë 07.03.2022 gjithsej me 12 projekte me vlerë 15,646 mijë lekë e cila:

- Financim nga AKKSHI vlera 13,775 lekë.
- Financim nga të ardhurat e universitetit 1,871 mijë lekë

Nga AKKSHI është çelur fondi në vlerën 36,513 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 31,487 mijë lekë, ose 86.2% e fondit. Fondet e kërimit shkencor të akorduara nga AKKSHI paraqiten të detajuara për çdo projekt në “Tabela 3 - Projekte Kërkimi shkencor – Financim AKKSHI Fakti viti 2022” dhe janë;

- ✓ **Projekte të Infrastrukturës së Kërimit Shkencor – PIKSH** janë realizuar në vlerën 25,000 mijë lekë, ose 100.00% e fondit. Nga AKKSHI me Vendim të Bordit të tij në vitin 2021 është miratuar projekti “Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe i çelur në Degën e Thesarit për vitin 2021 në kapitullin 1. Për arsye të procedurave të prokurimit nuk u realizua deri në 31.12.2021 lidhja e kontratës. *Universiteti i Elbasanit “Aleksander Xhuvani” më datë 16.11.2021 ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik për të realizuar projektin me objekt: “Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare ne Universiteti e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.* Për arsye të moslidhjes së kontratës me asnjë operator ekonomik pjesëmarrës në tender pasi nuk rezultuan fitues, Universiteti i Elbasanit bëri anulimin e procedurës së prokurimit me datë 26.11.2021. Rishpallja e procedurës për prokurim nga Universiteti, bazuar në procedurat e prokurimit publik kërkon afat ligjor nga 45 deri në 60 ditë për zhvillimin dhe realizimin e saj. Gjithashtu Dega e Thesarit nuk konfirmonte hedhjen e procedurës gjatë kësaj periudhe. Për këtë shkak të moslidhjes së kontratës me asnjë operator ekonomik ky projekt nuk mund të zhvillohej dhe realizohej brenda viti 2021. Bazuar në aktet e zbatimit të buxhetit ky fond nuk trashëgohej për vitin pasardhës, ndërkohë që u ri-kërkua financimi i tij në zbatim të Vendimit të Bordit të AKKSHI. Ky projekt u hartua me bashkëfinancim dhe u realizua në vlerën 45,840 mijë lekë me financim nga AKKSHI në vlerën 25,000 mijë lekë dhe nga Universiteti në vlerën 20,840 mijë lekë.
- ✓ **Projekte Kombëtare të Kërimit dhe Zhvillimit – PKKZH.** Nga AKKSHI me Vendim të Bordit të tij në vitin 2021 janë miratuar 4 projekte dhe për vitin 2022 janë miratuar 5 projekte, shtrirja kohore e të cilëve ishte në dy vite buxhetore dhe janë çelur në Degën e Thesarit për çdo vit në kapitullin 8. Bazuar në aktet e zbatimit të buxhetit fondi i papërdorur i vitit 2021 është trashëguar në vitin pasardhës, i cili me financimin e fondit të vitit aktual përbën planin në vlerën 11,513 mijë lekë. Këto projekte për dy vite nga

AKKSHI janë financuar për 12,039 mijë lekë janë realizuar në vlerën 7,013 mijë lekë, ose 58.²⁵% e fondit. Duke llogaritur dhe bashkëfinancimin nga UE vlera e këtyre projekteve është 13,413 mijë lekë. Për vitin 2022 këto projekte janë realizuar në vlerën 6,487 mijë lekë ose 56.³⁴ % e planit vjetor.

- **Fondet për kërkimin shkencor nga të ardhurat e institucionit** janë çelur në vlerën 53,780 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 37,297 mijë lekë, ose 69.4% e fondit. Në planbuxhetin e vitit 2022 u paraqitën për miratim 58 draftprojekte kërkimore e konferenca, nga të cilat 16 prej tyre u miratuan për financim, ndërsa 42 projete e konferenca ishin në pritje për rishikim të tyre, për tu financuar në momentin e rialokimit të planbuxhetit. Nga projektet e miratuara për financim gjatë kësaj periudhe u realizuan 12 prej tyre, të cilët janë përfunduar ose janë në vijimësi për vitin 2023. Projekti "Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"" - Prof. as. Dr. Peçi Naqellari për vlerën 20,840 mijë lekë u realizua bashkëfinancim me projektin PIKSH të AKKSHI-it.. Më të detajuara projektet kërkimore paraqiten “Tabela 4 – Projekte Kërkimi shkencor viti 2022 Realizimi nga të ardhurat UE”



- **Investimet e kryera në laboratore, mjete didaktike, fond libri për bibliotekën e pajisje të tjera.** Në procesin e zhvillimit të infrastrukturës akademike përveç mjediseve të auditoreve në UE janë kryer investime në; laboratore, mjete didaktike, fond libri për bibliotekën e pajisje të tjera të cilat u kemi paraqitur në dy periudha; para krijimit të BA-s dhe pas krijimit të Bordi Administrimit. Të dhënat paraqiten në “Tabela nr.6 Investimet e kryera në laboratore, mjete didaktike, fond libri për bibliotekën e pajisje të tjera- Fakti”

<i>Tabela 1</i>		<i>Realizimi i Buxhetit për vitin 2022- Realizimi</i>											<i>000/Lekë</i>		
<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Artikulli</i>	<i>Financim i brendshëm (kapitulli 1)</i>			<i>Granti (kapitulli 8)</i>			<i>Të ardhura - kap 6</i>				<i>Total Buxheti</i>		
			<i>Plani</i>	<i>Fakt</i>	<i>%</i>	<i>Plani</i>	<i>Fakt</i>	<i>%</i>	<i>Plani</i>	<i>Plani</i>	<i>Fakt</i>	<i>%</i>	<i>Plani</i>	<i>Fakt</i>	<i>%</i>
1	Paga e shperblime	600	0	0	0.0	817,401	429,542	52.5	25,078	25,078	3,036	12.1	842,478	432,578	51.3
-	Pagat	600	0	0	0.0	719,149	348,232	48.4	24,578	24,578	2,551	10.4	743,726	350,783	47.2
-	Honorare - oret	600	0	0	0.0	98,252	81,310	82.8	500	500	485	96.9	98,752	81,795	82.8
2	Sig. Shoqërore	601	0	0	0.0	81,854	63,415	77.5	4,876	4,876	0	0.0	86,730	63,415	73.1
3	Shpenzime operative	602	0	0	0.0	170,066	130,107	76.5	19,933	19,933	569	2.9	189,999	130,676	68.8
4	Transf. me jashtë	605	0	0	0.0	0	0	0.0	1,260	1,260	891	70.8	1,260	891	70.8
5	Transf. individet	606	0	0	0.0	0	0	0.0	18,750	14,000	7,032	50.2	14,000	7,032	50.2
6	Bursa	606	0	0	0.0	145,075	121,325	83.6	0	0	0	0.0	145,075	121,325	83.6
7	Kërkimi shkencor	0	36,513	31,487	86.2	0	0	0.0	94,208	53,780	37,297	69.4	90,293	68,784	76.2
-	<i>Infrastruktura - PIKSH</i>	230	0	0	0.0	0	0	0.0	19,396	19,396	19,396	100.0	19,396	19,396	100.0
-	<i>Infrastruktura - PIKSH</i>	231	25,000	25,000	100.0	0	0	0.0	15,672	0	0	0.0	25,000	25,000	100.0
-	<i>Kërkim zhvillim - PKKZH</i>	602	11,513	6,487	56.3	0	0	0.0	55,389	30,633	17,618	57.5	42,146	24,104	57.2
-	<i>Kërkim zhvillim - PKKZH</i>	606	0	0	0.0	0	0	0.0	3,751	3,751	284	7.6	3,751	284	7.6
